

Shtator 2019
Numri: 138
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

Ata ishin djelmosha
që i besuan Allahut
dhe Ne i forcuam në rrugën e drejtë.

(Kehf, 13)





revistaetika



progresibotime

TË
RINJ

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 2 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*




Çdo popull, çdo familje dhe ndoshta çdo individ diskuton ose duhet të diskutojë mbi çështjen e rinisë. Secili shpreh botëkuptimin dhe pritshmëritë e veta mbi periudhën e rinisë. Kjo është një ndjenjë e bukur. Pasi rinia është një thesar aq i madh, sa nuk u duhet lënë vetëm të rinjve. Rinia është pasuria më e rëndësishme e prindërve dhe e të gjithë atyre që kanë një kauzë; e atyre që kanë diçka për të thënë dhe që kanë synime lidhur me të ardhmen; e shtetit dhe e popujve.

Periudha e rinisë njihet si pranvera e kalendarit të jetës. Gjithçka është e gjallë dhe dinamike. Trupi është dinamik, perceptimi dhe kuptimi është i shpejtë, është e vështirë t'i limitosh ndjenjat dhe ëndërrimet, sjelljet janë me gjithë zigzaget e veta. Gjatë rrugëtimit të njohjes së vetes në këtë periudhë, nganjëherë shfaqen kryengritjet e brendshme, mburrjet e llojit "e di unë!", pretendimet, këmbënguljet dhe trimëritë. Ndaj dhe kjo periudhë duhet analizuar siç duhet, duhet organizuar dhe udhëhequr në mënyrë të shëndetshme.

Thuhet se njeriu është fëmija i mjedisit që e rrethon. Vallë, a ia kemi arritur t'u ofrojmë një atmosferë dhe mjedis të volitshëm të rinjve tanë?


Për shembull, atmosfera e familjes sonë a është e përshtatshme për një gjë të tillë? A kemi ndonjë përpjekje për ta njohur saktë të riun, me temperamentin e ndjenjave që e karakterizon atë? A e respektojmë atë? Mesazhin "Mirë që je!" dhe "Ti je një djalosh shumë me vlerë!", a e japin njëkohësisht si me fjalë ashtu edhe me gjuhën e trupit, si dhe me qëndrimet tona? A kemi arritur të duam ta shohim brenda botës së sotme a së nesërme që do të jetojë ai, apo po përpiqemi ta tërheqim brenda botës sonë të djeshme? Si duhet t'i pajisim ata, sipas periudhës që jetojnë ata, apo sipas asaj që kemi jetuar ne? Kur duket se nevojitet sakrificë materiale dhe shpirtërore, deri ku e kemi limitin? Nëse dëshirojmë që ai të jetë një hap më përpara se shokët e brezit të tij, a kemi ndonjë plan zhvillimor mbi të cilin bazohemi? Pyetjet mund të shtohen edhe më shumë se kaq. Këto pyetje dhe përgjigje, në një farë forme duhet të bëhen brenda në familje. Pasi vendi ku brumoset personaliteti i një njeriu është atmosfera e familjes.

Përmbajtja



16

Djelmoshat që i besuan Allahut
Rykije Tekgyl



Udhëtimi i përjetësisë
Osman Nuri Topbash

34



18



20

Rinia sipas Islamit
Mehmet Emin Aj

5 Rinia, raporti mes rrethit shoqëror dhe atmosferës

Doç. dr. Adem Ergyl

11 Rinia jonë dhe rinia e medreseve

Adem Tahir Jëllmaz

14 Të analizosh periudhën e rinisë

Prof. dr. Sulejman Derin

18 Urtësitë nga jeta e Jusufit a.s.

Ma. Behrim Jusufi

22 Kultura populiste dhe rinia

Prof. dr. Mehmet Gërmez

24 Problemet e rinisë dhe zgjidhja e tyre


Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

26 Vëllazëria që na mësoi i Dërguari i Allahut (a.s.)

Xhafer Durrush

28 Rinia dhe xhamia

Prof. dr. Mehmet Gërmez



48

Pasuria që vlen sa dy gota ujë

Ferudun Özdemir

Të kuptosh Kuranin, natyrën dhe historinë

Një Ajet

Mbështetja tek Zotit... si zogjtë!

Një Hadith

Të harrojmë? Gjë që s'bëhet

Idris Arpat

Projekti që pret bota:

Rinia e dedikuar ndaj Zotit

Mehmet Lutfi Arslan

Rinia e sahabëve fisnikë

Dr. Murat Kaja

Përgatitja e disa ushqimeve themelore


Betyl Nefise Inall

Jetimi im, i mjeri im, i vetmi im

Aishenur Vurall


Lumturia në familje

Zahide Topçu



44

Komandanti i shigjetarëve në Uhud
Abdullah ibn Xhubejr
Mustafa Erish



Gjuha është pasqyra e zemrës së njeriut
Naim Driçaj

50



RINIA

Raporti mes rrethit shoqëror dhe atmosferës

— Doç. dr. Adem Ergyl —

Çdo popull, çdo familje dhe ndoshta çdo individ diskuton ose duhet të diskutojë mbi çështjen e rinisë. Secili shpreh botëkuptimin dhe pritshmëritë e veta mbi periudhën e rinisë. Kjo është një ndjenjë e bukur. Pasi rinia është një thesar aq i madh, sa nuk u duhet lënë vetëm të rinjve. Rinia është pasuria më e rëndësishme e prindërve dhe e të gjithë atyre që kanë një kauzë; e atyre që kanë diçka për të thënë dhe që kanë synime lidhur me të ardhmen; e shtetit dhe e popujve.

Periudha e rinisë njihet si pranvera e kalendarit të jetës. Gjithçka është e gjallë dhe dinamike. Trupi është dinamik, perceptimi dhe kuptimi është i shpejtë, është e vështirë t'i limitosh ndjenjat dhe ëndërrimet, sjelljet janë me gjithë zigzaget e veta.

Gjatë rrugëtimit të njohjes së vetes në këtë periudhë, nganjëherë shfaqen kryengritjet e brendshme, mburrjet e llojit “e di unë!”, pretendimet, këmbënguljet dhe trimëritë. Ndaj dhe kjo periudhë duhet analizuar siç duhet, duhet organizuar dhe udhëhequr në mënyrë të shëndetshme.

Thuhet se njeriu është fëmija i mjedisit që e rrethon. Vallë, a ia kemi arritur t’u ofrojmë një atmosferë dhe mjedis të volitshëm të rinjve tanë?

Për shembull, atmosfera e familjes sonë a është e përshtatshme për një gjë të tillë? A kemi ndonjë përpjekje për ta njohur saktë të riun, me temperamentin e ndjenjave që e karakterizon atë? A e respektojmë atë? Mesazhin “Mirë që je!” dhe

“Ti je një djalosh shumë me vlerë!”, a e japin njëkohësisht si me fjalë ashtu edhe me gjuhën e trupit, si dhe me qëndrimet tona? A kemi arritur të duam ta shohim brenda botës së sotme a së nesërme që do të jetojë ai, apo po përpigemi ta tërheqim brenda botës sonë të djeshme? Si duhet t’i pajisim ata, sipas periudhës që jetojnë ata, apo sipas asaj që kemi jetuar ne? Kur duket se nevojitet sakrificë materiale dhe shpirtërore, deri ku e kemi limitin? Nëse dëshirojmë që ai të jetë një hap më përpara se shokët e brezit të tij, a kemi ndonjë plan zhvillimor mbi të cilin bazohemi? Pyetjet mund të shtohen edhe më shumë se kaq. Këto pyetje dhe përgjigje, në një farë forme duhet të bëhen brenda në familje. Pasi vendi ku brumset personaliteti i një njeriu është atmosfera e familjes.

Natyrisht, nuk mbaron gjithçka me klimën familjare.

Në krye të mjediseve më të rëndësishme për rininë janë rrethet shoqërore dhe rrugët ku mund të jetohej. Në fakt tashmë rrugët janë zmadhuar dhe zgjeruar. Bota virtuale thuhet ka shkatërruar të gjithë muret dhe tashmë të gjitha rrugët janë kthyer në vende ku mund të shëtisnin lehtësisht të gjithë. Edhe shoqëria është virtualizuar. Tashmë kemi ardhur në një kohë shumë më të vështirë. Mirëpo, nuk mund të mohohet rëndësia dhe ndikimi i rrugëve ku jetohej dhe shoqërisë, pjesë e së cilës është individ. Kështu, neve na duhet të zgjedhim rrugën në të cilën do të jetojnë shëndetshëm brezat. Tashmë me sa duket, hixhretet moderne në metropole do të realizohen si zgjedhje për lagjet. Pasi nuk janë të njëjtë të rinjtë që rriten në një lagje pa ezan me të rinjtë që rriten në një lagje ku përjetohej vlerat shpirtërore.

Qendra më e rëndësishme e lidhjes (network) ku rinia rritet është mjedisi shoqëror. Për të krijuar këtë mjedis të përshtatshëm, duhet hyrë në një kërkim serioz dhe duhet ndihmuar rinia. Pata dëgjuar një kujtim të një njeriu të ngritur. Le ta ndaj me ju:

“Njeriu nuk arrin dot ta menaxhojë siç duhet fëmijën e vet, veçanërisht në periudhën e rini-

së. Pashë që edhe tek fëmijët tanë nisi të dukej një mangësi interesimi shpirtëror dhe emocional ndaj fesë. Një ditë i bëra një vizitë profesorit të shkollës së mesme, ku studioja, me të cilin mendoja se ndaja gjithçka. “Profesor, i thashë, ecuria e fëmijëve tanë nuk është në atë formë siç më do zemra. Ju i keni parasysh nxënësit që i japin përparësi jetës shpirtërore fetare. Sikur të planifikonit t’i bëni shokë me njëri – tjetrin këtë kategori djemsh... Madje, mund t’ju mbështes edhe ekonomikisht për këto lloj iniciativash. Për shembull, sikur t’u blejmë dhuratat që të shkëmbejnë mes njëri – tjetrit, me qëllim që të afrohen me njëri – tjetrin. Mirëpo, mos të na e marrin vesh ata këtë strategji. Le të mbesë mes nesh kjo gjë, si një sekret.” Elhamdulillah-lah, pas pak

javësh u vërejtë dobia e kësaj iniciative. Të rinjtë filluan t’i shikonin me një sy tjetër namazet dhe veprat e tjera adhurimore.”

Ky është një shembull... Ajo çfarë dua të them është që marrëdhënia në të cilën gjendet i riu i sotëm, veçanërisht në botën e sotme është bërë mjaft e rëndësishme. Ndihma që u duhet dhënë atyre është një detyrë që bie përsipër fillimisht mbi prindërit e vet, pastaj mbi vëllezërit dhe motrat më të mëdha, mbi mësuesit dhe mbi organizatat vullnetare përkatëse.

Sot shkolla zë thuhet 1/3 e jetës së një njeriu. Pra, haurzet rimore tashmë janë shkollat. Ndaj dhe duhet t’u kushtojmë vëmendje këtyre foleve, që shërbejnë për t’i dhënë formë rinisë. Një nga çështjet që si shtet dhe popull duhet t’i kushtojmë më shumë kujdes është edukimi dhe shkolla.

Shkolla/universiteti nuk është thjesht ndërtesa. Është një institucion që duhet vlerësuar si i tërë, me mësime, personelin në përgjithësi, ambientin dhe situatën e studentëve brenda. Kështu që, mësuesi të cilit ia dorëzojmë të riun është mjaft i rëndësishëm, ambienti i shkollës është shumë i rëndësishëm, cilësia e studentit është po ashtu shumë e rëndësishme. Duhet që t’i zgjedhim ata dhe të ndjekim ecurinë e edukimit të tyre. Pasi cilësia e jetës përbëhet nga cilësia e zgjedhjeve.

*Marrëdhënia
në të cilën gjendet i riu i sotëm,
veçanërisht në botën e sotme
është bërë mjaft e rëndësishme.
Ndihma që u duhet dhënë atyre
është një detyrë që bie përsipër
fillimisht mbi prindërit e vet,
pastaj mbi vëllezërit dhe motrat
më të mëdha, mbi mësuesit
dhe mbi organizatat vullnetare
përkatëse.*

Gjatë periudhës së rinisë roli-modeli për ta është shumë i rëndësishëm. Në kulturën tonë ekziston një element mjaft i rëndësishëm që lehtëson rritjen e shëndetshme të të rinjve, një pikë reference për sjelljet dhe shprehjet e tyre, që është vëllai i madh dhe motra e madhe. Kjo, gjithashtu është një nga suportet më të bukura që mund të bëjnë organizatat vullnetare për rininë. Mundet që të jetë shumë më e rëndësishme sesa prindërit, mësuesit apo personeli i punës sociale, psikologët.

Njëri nga njerëzit e mëdhenj thoshte: “Përpiqu që të angazhosh neftin me të vërtetën. Nëse nuk e bën këtë, atëherë vjen e shëmtuara dhe vendoset këmbëkryq në zemrën tënde.” Gjatë periudhës së rinisë cytjet e neftit dhe të shejtanit janë më evidente dhe më dinamike. Ndaj dhe i riu duhet impenjuar me gjëra të duhura dhe duhet ruajtur që të mos bëhet lodër në dorën e neftit dhe shejtanit. Në këtë kuptim, mënyra më e zgjuar është që të rinjtë t’i angazhojmë me role dhe detyra në këto projekte të vullnetarizmit.

Vetmia është dobësi. Shejtani dhe nefti njeriun e vetëm, njeriun e vetmuar, e nxjerr më lehtë nga rruga. Shumica e gjynaheve bëhen kur njeriu është vetëm. Ndaj dhe, duke u nisur nga qëllimi për të përfutur nga fuqia udhëheqëse dhe tërheqëse e psikologjisë së turmës, vendosja e të rinjve në grupe të singerta dhe besnike dhe bërja e tyre anëtarë të këtyre organizimeve është një strategji edukative mjaft e rëndësishme.

Gjatë periudhës së rinisë, njohja me vlerat fetare, madje dhe unifikimi me këto vlera, është një domosdoshmëri që njeriu të arrijë deri në një pikë që të fitojë pëlqimin e Allahut. Veçanërisht një besim i shëndoshë përbën themelin e të gjitha vlerave. Duhet vendosur në zemër aq fort besimi në Allah, në profeci dhe në Botën Tjetër, sa të mos krijojë asnjë pikë dyshimi. Pasi të gjitha domosdoshmëritë e të qenit rob i Zotit, vendosen mbi këto themele.

Marrëdhënia me fenë nuk është thjesht një aksesori, por raporti me fenë duhet parashtuar si një sistem që përfshin të gjithë jetën. Veçanërisht

vetëdija e namazit duhet vendosur mirë në zemër gjatë kësaj periudhe dhe duhet bërë pjesë e pandashme e jetës për të rinjtë. Veçoria e faljes së pesë kohëve të namazit tek një i ri, është një tregues i rëndësishëm i vetëdijes islame. Në këtë kontekst, namazi është një shenjë e një shkalle të lartë.

Rinia sot duhet të marrë masa për të mbrojtur qëndrimin e saj dhe nderin e saj me dinjitet. Kjo gjë varet nga zhvillimi i personalitetit që ai përpiqet të bëjë. Kjo gjë varet po ashtu edhe nga profesioni, karriera dhe profesionalizmi që përpiqet të krijojë tek vetja e tij, me qëllim për të zënë vendin e merituar në shoqëri. Prandaj dhe

ne duhet të bëjmë përpjekjen maksimale që të rinjtë e sotëm të pajisen me ato nevoja dhe pritshmëri të kohës që ata jetojnë. Disa prej tyre janë: diplomat, certifikimet, gjuhët e huaja, patenta, dëshmi aftësimi dhe njohjeje të teknologjisë dhe informatikës etj. Nuk duhet synuar një rini që ecën me bastun, si i ati apo farefisi, por duhet të bëjmë qëllim që të rrisim breza që ecin me këmbët e tyre, madje edhe që vrapojnë drejt së ardhmes.

Njeriun e ri nuk duhet ta rrisim dhe edukojmë duke e mbyllur brenda, duke e mërzuar apo duke i treguar pushtetin që kemi mbi të, por përmes aktivizimeve cilësore, përmes udhëheqjeve të ndryshme, duke i ngarkuar punë e shërbime vullnetare, duke i dhënë detyra e përgjegjësi. Rinia që do ta sistemojë botën në linjën e vullnetit të Zotit dhe që të përfaqësojë dinjitetin e ymetit islam, është e detyruar të jetë një rini me kokën lart, që t’i besojë vetes, e kujdesshme dhe e suksesshme. Nuk ka nevojë për një rini që s’ka aftësi, që s’ka ambicie, që ka humbur vetëbesimin, që është bërë pjesë e rëndomtë e turmës, gjoja e edukuar, pasive, por nevojitet një rini me liderë që do t’i japin drejtim kohës që jetojnë. Për t’u rritur një rini e tillë, detyra që bie mbi të gjithë ata që janë në postet përgjegjëse është që të krijojnë dhe të zhvillojnë ambiente, atmosfera dhe mundësi të mira që mund t’u shërbejnë atyre.

*Njeriun e ri
nuk duhet ta rrisim dhe
edukojmë duke e mbyllur
brenda, duke e mërzuar apo
duke i treguar pushtetin që kemi
mbi të, por përmes aktivizimeve
cilësore, përmes udhëheqjeve të
ndryshme, duke i ngarkuar punë
e shërbime vullnetare,
duke i dhënë detyra
e përgjegjësi.*



Shtatë njerëz të mirë

— Dr. Murat Kaja —

1. Kryetari i shtetit i cili punon me drejtësi.

2. I riu që edukohet me dashuri dhe respekt ndaj adhurimit të Allahut.

3. Njeriu, zemra e të cilit është e lidhur mbas xhamisë.

4. Ata që e duan njëri-tjetrin për hir të Allahut.

5. Ai që ruan nderin dhe namusin.

6. Mirëbërësi, i cili atë që jep me dorën e djathtë nuk ia di e majta.

7. Ai që e përmend Allahun kur është i vetmuar.

Profeti (a.s.), ka ndjekur metoda të shumta për t'ia mësuar njerëzve këtë fe. Përveç urdhrave dhe ndalesave, ndonjëherë ka rregulluar gabimin ose ka miratuar edhe punën e mirë të ndokujt. Ndonjëherë u ka drejtuar pyetje shokëve të tij dhe përgjigjen përsëri e ka dhënë vetë. Pyetjeve që i bëheshin, ndonjëherë u përgjigjej ashtu sikur ishte, por ndonjëherë duke dhënë edhe më tepër detaje nga ç'kërkohej.

Ka qëlluar t'i mësonte edhe duke e vepruar, ose duke u larguar vetë nga një vepër. Ndonjëherë ka folur pak dhe saktë, arsye për të cilën e kanë quajtur edhe “**xhevamiu'l-kelim**”, që do të thotë, “tregon shumë, me pak fjalë”. Këto fjalë ai i ka gdhendur në mendjen e njerëzve, duke i përmendur nga tri herë. Ndonjëherë, çështjen e ka shpjeguar gjerë e gjatë, ka treguar ndodhi dhe ka portretizuar çështje

të ndryshme. Dhe ndonjëherë, i shpjegonte të ndara në kategori...

Është e mundur që këto t'i japim një nga një, me shembuj, sepse librat e haditheve janë të mbushur me mijëra nga këto shembuj. Mirëpo, këtu duam të marrim në dorë një hadith që na tregon se si i Dërguari i Allahut u ka mësuar njerëzve fenë, moralin e lartë, urtësinë dhe vlerat, duke ua dhënë diturinë të ndarë në kategori dhe grupe.

I Dërguari i Allahut na e përkujton shpesh botën tjetër dhe i portretizon në një mënyrë të gjallë ato që do të ndodhin atje, gjendjen dhe veprimet e njerëzve. Ja pra, hadithi ynë fillon duke treguar gjendjen e njerëzve në botën tjetër: **“Atë ditë Allahu do të marrë nën hijen e (arshit të) vet shtatë persona. Atë ditë nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes së**



(arshit të **Tij.**” (Buhari, Xhemaat dhe Imamet, 8; Muslim, Zekat, 91) Me këtë, Profeti ynë (a.s.) na sjell para syve edhe gjëndjen e asaj dite në botën tjetër, por na bën edhe kureshtar për të ditur se cilët janë këta persona. Cilët janë këta shtatë persona fatlumë? Ç’është ajo që i bën ata të përgëzohen me këtë mirësi?

Në fillim Resulullahu (a.s.) tregon për kryetarin e shtetit që punon me drejtësi. Pra këtu na jepet një stimulim drejt fushës materiale të kësaj bote. Që në fillim, ai sikur na jep mesazhin se në këtë fe materialja dhe shpirtërorja janë të lidhura si mishi me thoin. Resulullahu (a.s.) i jep shumë rëndësi sigurisë dhe mirëqenies ekonomike të njerëzve dhe dëshiron që populli të jetojë i qetë dhe i sigurtë. Për këtë arsye, nuk e lë bosh këtë fushë. Ai vë në dukje një vlerë universale: Drejtësinë. Ky është edhe një princip i cili theksohet shumë në Kur’anin Famëlartë. (Nisa 4/58; Maide 5/8; Nahl 16/90) Madje Kur’ani na tregon për Davudin (a.s.), i cili gjendet në kulmin e fuqisë shpirtërore dhe materiale. Allahu e urdhëron edhe atë, që të prijë me drejtësi dhe me barazi. (Sad 38/26). Në një farë mënyre, edhe Omeri (r.a) halifja i dytë i Profetit (a.s.) e përforcon këtë princip. Me veprimtaritë që zhvilloi, me institucionet që formoi dhe me vendimet që mori, ai u bë njeriu i parë që përfitoi nga ky përgëzim që solli Profeti ynë (a.s.). Ai përbën shembullin konkret të këtij principi që stabilizoi Islami. Për këtë arsye, ai është quajtur “Umeru adlun”, që do të thotë, “Omeri (r.a) është vetë drejtësia”.

Së dyti, Profeti (a.s.) bën fjalë për të riun që edukohet me dashuri dhe respekt ndaj adhurimit. Këta janë kategoria e dytë e njerëzve që do të strehohen nën hijen e arshit të Allahut. Të rinjtë që edukohen

prej vegjëlisë me vetëdijen e besimit, të cilët ecin me kokën lart dhe pa u ndarë nga rruga e drejtë, në kohën kur iu zjen gjaku dhe kur mjedisi përreth tyre është mbushur përplot me qendra joshëse. Të rinjtë që përkushtohen me kujdes, me dashuri, me energji dhe dinamizmin në këtë rrugë...

Në Kuranin Famëlartë kemi shembullin e “Shokëve të shpellës”. Allahu shprehet me lëvdata për këta të rinj sakrifikues! Që në fillim, përreth Resulullahut ka patur gjithmonë të rinj. Çështja e shenjtë e Islamit është lartësuar mbi supet e këtyre të rinjve të devotshëm. Janë ata që mundohen dhe punojnë për t’ia mësuar vetes dhe të tjerëve Kuranin në Mekke. Janë përsëri ata që qëndrojnë në krye të luftës në Medine dhe në përhapjen e Islamit në vende të ndryshme. Aliu (r.a) është shembulli më i mirë i atyre që e kanë kushtuar jetën e tyre në rrugën e Allahut. I pari që besoi, i pari që rrezikoi jetën në kohën e hixhretit, Luani i Allahut në Bedir dhe Uhud, Aliu (r.a).

Së treti, vjen ai zemra e të cilit është e lidhur me xhaminë. Pra, besimtari në zemrën e të cilit ndodhet një dashuri e pashoqe për xhaminë. Një vakt namaz e ka falur dhe pret me padurim të vijë vakti tjetër. Një njeri shumë i përkushtuar në faljen e namazit në xhami dhe në ripërtëritjen e synetit. Xhamia ujë dhe besimtarët peshq! Si mos ta dojë xhaminë besimtari? Në kohën kur Resulullahu (a.s.) emigroi për në Medine, puna e parë që bëri ishte ndërtimi i një xhamie dhe ai vetë mbajti gurë në supet e tij. Zemra e myslimanëve dhe pulsi i bashkësisë Islame rreh gjithmonë nëpër xhamia. Bashkimi, vëllazëria është aty. Ndihma dhe solidariteti janë aty. Libri i Allahut lexohet aty, emri i Tij përmendet aty dhe njerëzit po prej aty thirren për në shpëtim. Xhamitë

janë projektimi i mëshirës që zbret nga Qabja. Mëshira gurgullon në xhami, qetësia zbret në xhami. Ja pra, për këtë arsye besimtarët që kanë dashuri për xhaminë dhe xhematin dhe që ndjejnë dëshirën për shërbim ndaj xhamisë, do të jenë nën hijen e arshit në Ditën e Kiametit.

Së katërti, Profeti (a.s.) na tregon për **ata që e duan njëri-tjetrin për hir të Allahut**. Midis tyre nuk ka ndonjë interes të kësaj bote por ka vetëm një miqësi të pastër dhe pa pretendime. Kur bashkohen, bashkohen për hir të Allahut duke shpresuar kënaqësinë e Tij. Madje, edhe kur ndahen, ndahen për hir të Tij dhe shpresojnë kënaqësinë e Tij. Dhe kjo dashuri midis tyre vazhdon deri në fund të jetës. Çfarë ka më me vlerë në jetë se sa një mik i singertë? Të dimë që kemi një mik të singertë dhe besnik, që e duam dhe e duan, na jep një qetësi të madhe shpirtërore. Një pjesë e bukurisë së jetës përbëhet nga miqësia e ngrohtë, nga ajo miqësi që nuk bazohet në interesa...

Në Kuranin Famëlartë flitet për miq që do të jenë armiq në ditën e kiametit. Mirëpo, miqtë e vërtetë do të jenë larg kësaj. (Zuhuf 43/67) Në një vend tjetër tregohet për dikë që meriton dënimin dhe ky me një pendim të thellë thotë: **“Ah sikur të mos isha mik i filanit!”** (Furkan 25/28) Sa miqësi e bukur është ajo e të Dërguarit të Allahut (a.s.) me sahabët e Tij si Ebu Bekri dhe Omeri (r.a)! Përfytyroni për pak çaste tabllon e singertë që ekspozojnë këta miq të ngrohtë, të cilët bisedojnë të ulur pranë një pusi!

I pesti është ai që i jep një rëndësi të veçantë, nderit dhe namusit. **Një grua me pushtet i propozon këtij marrëdhënie të pamoralshme dhe ky e refuzon atë duke thënë, “unë i frikësohem Allahut”**. Sa virtyt i madh është nderi! Për çfarë virtytesh mund të bëhet fjalë, nëse në një popull ka humbur ndjenjat e nderit dhe namusit!? Ja pra, ajo që na e siguron këtë ndjenjë është devotshmëria. Pra të jesh i vetëdijshëm kundrejt përgjegjësive që ke ndaj Allahut.

Ato që ka jetuar Jusufi (a.s) janë të njëjta me ato që na ka treguar Resulullahu (a.s.). Të gjithë e dimë ndodhinë. Në suren Jusuf ajo jepet me detaje. Mirëpo, përgjigja e atij njeriu të lartë ndaj një propozimi të pamoralshëm është shumë ndikuese: **“Allahu më ruajtë nga kjo gjë. Si mund të bëj këtë pasi që Allahu më ka dhuruar këto mirësi.”** (Jusuf 12/23) Në rrethin që jetonte Jusufi (a.s), edhe burrat edhe gratë ishin zhytur nga koka tek këmbët në imoralitet. Jusufi (a.s) e pa më të arsyeshme të qëndronte në burg, se sa të jetonte pa ndjenja në një rreth të tillë: **“Ai (Jusufi) tha: “O Zoti im, burgu është më i dashur për mua, se sa ajo që ma ofrojnë ato mua...”** (Jusuf 12/33) Lutja e Profetit tonë (a.s.) do të na ndihmojë në këto raste : “ Allahu im, dëshiroj prej teje që të jem në rrugë të drejtë, të përqafohem

me devotshmërinë dhe të jetoj me nder.” Gjithash-tu, edhe zotëruesi i dy dritave në kohën e Profetit, Osmani (r.a), na ndriçon rrugën me ndjesinë e tij të veçantë ndaj nderit dhe turpit!

Për sa i përket të gjashtit, Profeti ynë (a.s.), me këtë nënvizon një pikë të rëndësishme. Pra, **dora e majtë e atij që bën mirë nuk duhet të dijë se ç’bën dora e djathtë**. Kështu që, ai njeri mirësinë e bën në mënyrë të fshehtë. Sepse qëllimi i tij është vetëm kënaqësia e Allahut. Ai nuk e bën këtë për sy e faqe. Në ajetin e ndershëm shprehet se të japësh haptas është mirë, por të japësh fshehtas është edhe më mirë, (Bakara 2/271). Profeti ynë i dashur, çështjen e fshehtësisë e ka shprehur në një mënyrë shumë interesante, për arsye që ai i cili merr lëmoshë të mos turpërohet midis të tjerëve. Atë që jep dora e djathtë të mos e dijë e majta! Sigurisht, edhe njerëzit që marrin lëmoshë kanë një ndjenjë nderi dhe krenarie. Prandaj, kur të jepet, duhet të jepet pa i cënuar ndjenjat e tyre. Ja pra, edhe ata që e kanë këtë ndjesi, do të jenë nën hijen e arshit.

I shtati dhe i fundit është **ai që e përmend Allahun dhe të Dërguarin e Tij kur gjëndet i vetmuar**. Ky njeri është aq i mbushur me dashuri ndaj Allahut, sa që nga sytë e tij rrjedhin lot. Dashuria hyjnore ia djeg zemrën. Zemra e shuan zjarrin dhe shpirti e ujit tokën me lotët e tij. Kur e përmend Allahun dhe e lexon librin e Tij, zemra i rrënqethet dhe i mbushet me devotshmëri dhe mëshirë. Shpirti i tij fiton butësi dhe pastërti! Edhe Profeti ynë (a.s.) i ka kaluar disa nga netët e Tij i mbytur në lot. Kryen adhurim, lexon Kuran dhe derdh lot i Dërguari i Allahut (a.s.). Edhe shoku i Tij më i ngushtë Ebu Bekri (r.a) kishte një zemër të tillë. Në mesxhidin që ndërtoi përpara shtëpisë së tij në Mekke, lexonte Kuran duke qarë. Vajza e tij Aishe (r.a) na e tregon atë si “një njeri me zemër të butë dhe sylagur”. Mirëpo këtë nuk mund ta shpjegosh dot me fjalë, nëse nuk e jeton, nuk e kupton.

Hadithi ynë fillon me materialen dhe mbaron me shpirtëroren. Në këtë fe, rëndësia që i jepet rregullimit të jetës së kësaj bote është po aq e madhe sa edhe rëndësia që i jepet forcimit dhe pasurimit të botës shpirtërore të njeriut. Me këtë hadith, i Dërguari i Allahut (a.s.) na ka paraqitur një manifestim të principeve universale të Islamit. Ky hadith është si një ylber që pasqyron shtatë ngjyrat themelore të diellit Islam. Ai nxjerr në pah ngjyrat që i jep Islami këtyre vlerave, që nga principi i lidhur me shtetin, marrëdhëniet shoqërore, kujdesi që duhet treguar në punë të mira dhe deri tek rëndësia që kanë marrëdhëniet e njeriut me Allahun. Nëse e marrim numrin shtatë si një kuptim figurativ të shumicës, pra simbolin që tregon një sasi të madhe, do të shikojmë se këto pika janë dimensione që zgjaten për tek principet e tjera.



RINIA JONË DHE RINIA E MEDRESEVE

— Adem Tahir Jëllmaz —

RINIA DHE ARSIMI

Rinia zë një vend të veçantë në popullsinë tonë. Rinia është një urë lidhëse mes së shkuarës dhe së ardhmes. Të rriturit dhe të moshuarit janë në përpjekje të vazhdueshme për t'u dhënë formë të rinjve. Kurse të rinjtë dhe të rejat po mundohen që me çdo kusht të realizojnë dëshirat e tyre. Çdo i rritur dhe i moshuar përpiqet për të rritur të rinj dhe të reja sipas rinisë së kohës së vet, sipas atij mentaliteti dhe botëkuptimi. Dhe pikërisht këtu nis ajo përplasja e heshtur apo edhe ndonjëherë e zhurmshme. E ardhmja që përpiqet të përgatitet për këta të rinj është në fakt ajo çfarë imagjinojnë të rriturit për ta. Ky brez është ajo gjeneratë që, ndërkohë që marrin këtë formë që u ofrohet, përpiqen gjithashtu të qëndrojnë drejt përballë mendimeve dhe veprimeve që janë në kundërshtim me atë çfarë ndjejnë ata se duhet të realizojnë.

Kur i hedhim një sy sures Kehf, se si e përshkruan psikologjinë e të rinjve, vërejmë se bëhet fjalë për një lloj rezistence dhe kundërveprimi: “...Ata ishin **djelmossa që besonin në Zotin e tyre dhe Ne i forcuam në rrugën e drejtë. Ne i forcuam zemrat e tyre, kur u ngritën e thanë: “Zoti ynë është Zoti i**

qiejve dhe i Tokës. Ne nuk do t'i lutemi asnjë zoti tjetër, përveç Tij, sepse atëherë do të thoshim një gënjeshtër të madhe.” (Kehf, 13-14) Pra, bëhet fjalë për një lloj qëndrimi të patundshëm të të rinjve me tërë vetëdijen e tyre drejt së vërtetës. Të rinjtë janë një brez që mbrojnë të drejtat duke marrë përsipër çfarëdolloj sakrifice që u kërkohet atyre. Ndonëse duket i vështirë edukimi nga ky aspekt, por është një brez që mund të merren rezultate në varësi të sakrificës që bëjnë ata për veten e tyre. Kur bëhet fjalë për arsimimin e të rinjve tanë, kurrë nuk duhet të harrojmë këtë anë të tyre. Nëse duhet t'i hedhim një shikim me sy kritik kësaj çështjeje, atëherë problemet themelore lidhur me arsimimin e të rinjve mund të trajtohen në disa kategori:

- Familjet që nuk e kuptojnë ose që nuk mund ta kuptojnë botën e të rinjve;

- Veprimet negative të individëve dhe qarqeve që përpiqen të shtojnë fuqinë ekonomike nëpërmjet tyre dhe që përpiqen të përdorin të rinjtë për qëllimet e tyre;

- Një mjedis edukativ dhe stafi mësimor që vohet në përditësimin e vetes dhe që nuk u flet pritshmërisë së të rinjve;

- Një mjedis akademik që nuk bën përpjekje të thellohet më tej në fushën e edukimit të të rinjve dhe që nuk zhvillon politika mbi të rinjtë;

- Mungesa e veprimtarive dhe mjediseve artistike, letrare, mediatike dhe botuese, gjëra të cilat formësojnë jetën e të riut mbi vlerat e besimit dhe qytetërimit islam;

- Hedhja në plan të dytë e edukimit të personalitetit dhe karakterit dhe përparësia e planifikimit të karrierës;

- Dhe më e rëndësishmja, mungesa e njerëzve sakrifikues, njerëzve shpirtërorë dhe organizatave civile, që mund të organizojnë të rinjtë rreth një ideali, që mund t'i nxisin ata dhe që mund t'i përsosin ata...

MEDRESETË, INSTITUCIONET EDUKATIVE TË TË RINJVE

Medresetë¹ janë shkolla që janë hapur për arsye të kërkesave të popullit. Populli ynë dëshironte që të jepet arsim fetar nën kontrollin e shtetit, ndaj dhe që kur u hapën pati një lloj frekuentimi të gjerë. Që kur arsimi i detyruar u bë 12 vite në shtetin tonë, iu shtua shkollimi i ciklit të mesëm dhe kjo rritje e natyrshme ashtu sikurse në të gjitha ciklet e mesme, po ashtu ra në sy edhe në medrese. Rritja e numrit të nxënësve në medrese vazhdoi në mënyrë të natyrshme deri në vitin 1997 – 1998. Me mbylljen e ciklit 8-vjeçar në vitin 1997 dhe me zbritjen që i bëri qeveria e atëhershme numrit të maturantëve të medreseve për të hyrë në universitete, nisi një frenim i nxënësve, madje pati një pakësim të tyre në regjistrimin në medrese. Kjo ndalesë dhe pakësim i nxënësve në medrese vazhdoi derisa në vendin tonë u hoqën pengesat dhe u vendos drejtësia. Veçanërisht me heqjen e koeficientit pengues dhe me hapjen e shkollave 8-vjeçare të medreseve nisi sërisht një rritje e numrit të nxënësve të medreseve, pas afro 10 viteve ndalimi dhe pengimi të rritjes së

medreseve.

Prej vitesh pritej prej popullit tonë të hapeshin 8-vjeçarët e medreseve dhe pas këtij interesimi u hapën një sërë medresesh të ciklit 8-vjeçar. Rritja e numrit të nxënësve të medreseve ishte pasoja e natyrshme e hapjes së pengesës së një uji që rridhte. Kjo dyndje lindi nevojën e ndërtesave të reja dhe të stafit të ri. Krahës kësaj, në shkollat 8-vjeçare, që më pas u bënë 9-vjeçare dhe në ciklin e mesëm bëri që të shtoheshin nevojat e mësuesve të lëndëve të Kuranit Famëllartë dhe të Njohurive Themelore të

Lëndës së Besimit, të cilat ishin si lëndë me zgjedhje. Mospasja e studentëve të diplomuar nga Fakultetet Teologjike Islame, si pasojë e mospasjes së kontingjentit të studentëve të vetëdijësuar për një periudhë të caktuar, veçanërisht ka sjellë në aktualitet nevojën imediate të një stafi të aftë mësëmdhënës veçanërisht të lëndëve fetare. Ndaj dhe në vitin 2014 fakulteteve teologjike islame u është dhënë kontingjent mbi dhjetë mijë dhe po merren masa për të plotësuar hapësirën e krijuar të mësuesve të lëndëve fetare.

Një tjetër çështje e arsimit të sotëm është edhe cilësia e arsimit. Ky problem pikësepari zgjidhet duke nxjerrë mësëmdhënës cilësorë. Fakultetet e edukimit dhe institucionet që nxjerrin mësues nuk i kanë të përditësuar programet sipas brezit të ri, ndaj dhe nuk arrijnë dot të nxjerrin mësëmdhënës që mund të edukojnë njerëzit e së ardhmes. Raporti mes kurrikulës apo metodologjisë së arsimit që jepet apo

duhet dhënë në shkolla me ato të universiteteve nuk është në nivelin e duhur. Duke e parë këtë çështje në këndvështrimin e edukimit fetar, në fakultetet teologjike islame është dobësuar ndjeshëm mundësia e nxjerrjes së mësuesve kandidatë idealistë. Rritja e studentëve me vetëdijen “njeriu i kauzës”, siç thoshin të vjetrit, që duhet të kishin studentët e mësuesive si mision, është kaluar në plan të dytë dhe tashmë u jepet përparësi pritshmërisë akademike. Pasi, dituria është vetëdije, gjendje, edukatë e mirë dhe veprim.

*Nxënësit tanë që mësojnë
në medrese, duhet të
qëndrojnë besnikë ndaj
emrit që bart shkolla e tyre
dhe ndaj sinjeritetit të atyre
që kontribuan për medrese.*



1. Autori i shkrimit i referohet gjithmonë sistemit arsimor të medreseve (Imam Hatip Okullari/Liseleri) në Turqi. (përkthyesi).

MISIONI I MEDRESEVE DHE PËRGJEGJËSITË QË U BIEN PËRSIPËR BARTËSVE DHE SHËRBYESVE TË KËTJ MISIONI

Medresetë janë institucione origjinale në vendin tonë, që praktikojnë programe përgatitore për profesion të caktuar dhe për shkollë të lartë. Që në ditën kur janë krijuar deri në ditët e sotme, këto shkolla, të cilat janë një manifestim i tërësisë popull-shtet është dhënë një edukim i shëndetshëm fetar dhe janë praktikuar programe që synojnë t'u mësojnë fëmijëve besimin e duhur, diturinë e duhur dhe sjelljet e duhura. Si përfundim i këtij procesi, duke marrë si referencë dy burimet themelore të fesë islame, Kuranin dhe Sunetin, kanë dalë breza të tërë të kujdesshëm ndaj ekstremizmave, që kanë përbrendësuar vlerat etike dhe shpirtërore, që kanë vënë në plan të parë idealin e të qenit të dobishëm për njerëzimin, që u japin përparësi kritereve njerëzore dhe islame dhe që kanë një mendim original. Nga këto shkolla kanë dalë sa e sa liderë dhe breza shembullorë, që i kanë shërbyer vendit tonë dhe njerëzimit. Nga mesi i tyre kanë dalë njerëz që kanë kryesuar që të kuptohen dhe komentohen shken-cat islame sipas nevojave të kohës sonë, dijetarë që kanë koncept mbi qytetërimin, hoxhallarë, që me fjalët e profesor Hajredin Kahramanit, njerëz që kanë vetëdijen e “ringjalljes dhe rindërtimit të qytetërimin tonë”; liderë të popullit tonë, biznesmenë, drejtues të të gjitha sferave dhe falë Zotit edhe kryeministri dhe presidenti i vendit kanë dalë po ashtu nga sistemi i medreseve të Turqisë.

Sot përballemi me një tjetër gjendje të edukimit fetar dhe të medreseve në vendin tonë. Sipas analizës që qeveria aktuale i ka bërë kërkesës së popullit tonë, jemi dëshmitarë të gjithë që populli ynë po i kthehet edukimit fetar, gjë e cila perceptohet si e drejtë e tyre, e parashikuar edhe në kushtetutë. Interesimi i jashtëzakonshëm i popullit tonë ndaj cikleve 8/9-vjeçare dhe cikleve të mesme të medreseve, si dhe ndaj lëndëve me zgjedhje lidhur me Religjionin, Etikën dhe Vlerat Islame të shkollave të tjera të përgjithshme, ka treguar se sa nevojë ndjejnë njerëzit tanë dhe se sa të interesuar janë ata ndaj një edukimi fetar të shëndetshëm. Tashmë, në vend që të flasim mbi kujtimet dhe problemet e së shkuarës, kemi arritur në një pikë që të bëjmë plane dhe projekte mbi edukimin e shëndetshëm fetar që duhet të marrin fëmijët. Ajo që bie si detyrë mbi prindërit e nxënësve është që të çojnë në medrese fëmijët e tyre që kanë vullnet për të mësuar, që këto shkolla të kenë përparësi për ta.

Sot medresetë nuk shikohen si fëmijë të njerikut.

Por ato po ndërtohen sikurse shkollat e tjera, përmes mundësive shtetërore. Tashmë të njëjtat përpjekje të mundimshme që janë bërë në të shkuarën për ndërtimin e këtyre shkollave, duhen bërë gjithashtu mbi realizimin e projekteve origjinale për të rritur kualitetin, duhet rinovuar planet dhe programet mësimore dhe politikat arsimore, duhen planifikuar veprimtari që rrisin njerëz që janë të dobishëm, aktivë, dinamikë dhe të drejtpërdrejtë dhe nuk duhet harxhuar energji dhe kohë me programe sallonesh të padobishme, si dhe duhet punuar në mënyrë intensive për të bartur me përgjegjshmëri amanetin e bartjes së emrit “medrese”.

Detyra më delikate bie mbi stafin mësimdhënës të medreseve, pasi atyre u janë lënë amanet breza të tërë. Një edukues që njeh periudhën në të cilën jeton, që njeh pritshmëritë e nxënësve, që vazhdimisht zhvillon veten për të rritur fëmijë duke i pajisur me ato çfarë kanë nevojë për kohën që fëmijët po rriten, ashtu siç e shpreh edhe sociologu i ndjerë Nuredin Topçu: “Rini! Dera që hyhet duke e menduar është vetëm dera e klasës. Besomëni që asnjë çlirim (fetih) në këtë botë nuk të jep më shumë nder sesa të hapësh derën e klasës”, kësisoj, “ai që hyn në klasë është sikurse të hyjë në derën e tempullit...”

SHPRESA E SË ARDHMES: NXËNËSIT E MEDRESEVE

Nxënësit tanë që mësojnë në medrese, duhet të qëndrojnë besnikë ndaj emrit që bart shkolla e tyre dhe ndaj sinjeritetit të atyre që kontribuan për medrese. Nxënësit e medreseve duhet të mos jenë indiferentë ndaj botës që jetojnë, por të ftojnë në mirësi dhe mbarësi, të përpiqen t'i japin tërë botës zërin e fuqishëm të Islamit, me vetëdijen e të qenit lider, të bëjnë qëllim që të përcjellin mesazhin e paqes në zemrat e të gjithëve dhe të tregojnë që janë të rinj që përpiqen të edukohen si të rinjtë e së ardhmes. Pasi këta shpirtra të pastër e të çmuar, përfaqësojnë ata njerëz që do të shpien më tutje kauzën e pejgamberëve.

Nxënësit e medreseve, krahas suksesit profesional dhe akademik nën dritën e Kuranit dhe Sunetit, janë nxënës që zhvillojnë veten e tyre edhe në fushat sociale, kulturore dhe artistike. Ata zhvillojnë karakterin e tyre bashkë me planifikimin e karrierës, pjekjen e personalitetit, me fjalët e të ndjerit profesor Sabahaddin Zaim-it: “ata janë të rinj në përpjekje për t'u bërë njerëz të mirë”.

Të analizosh periudhën e rinisë

— Prof. dr. Sulejman Derin —

Allahu i Madhëruar në Librin e Shenjtë ka thënë: **“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë e mbikëqyrin engjëj të fuqishëm e të ashpër, të cilët kurrë nuk i kundërshtojnë urdhrat e Allahut, por i zbatojnë menjëherë ato.”**

(Tahrim, 6) Zoti kërkon nga ne që të ruajmë veten, pastaj bashkëshorten, pastaj fëmijët tanë nga sprovat e kohës. Ky synim kaq sublim realizohet vetëm atëherë kur mësohet siç duhet feja jonë, atëherë kur ka një edukim cilësor fetar. Detyra jonë primare është që të pajisim të rinjtë tanë me dijet e nevojshme përmes institucioneve të specializuara të edukimit fetar. Për të arritur këtë qëllim duhet që medoemos të hapen institucione që mësojnë Librin tonë të shenjtë dhe fenë tonë të bukur. Imam Rabbani, si një nga sufitet që kupton rëndësinë e çështjes në fjalë, tregon se mirësitë që bëhen në shërbim të njohjes dhe përhapjes së çështjeve islame (sher'i) janë më të rëndësishme se gjithçka tjetër. Ai e sqaron në këtë mënyrë:

Të shpenzosh me miliona florinj (para) në rrugën e Allahut nuk është e njëjtë me mbështetjen dhe përhapjen e njërës prej çështjeve islame. Pasi këtu bëhet fjalë që të mbështetësh dhe të bësh bashkëpunim me pejgamberët, që janë më të vërtetshmit e gjithësisë. Ajo çfarë dihet me siguri është që, megjithëse shpenzimi prej miliona florinjsh u ka takuar njerëzve të tjerë, jo pejgamberëve, sepasvet më të mëdha i kanë marrë pejgamberët. (Letra e 48-të)

Megjithatë, nuk është aspak e lehtë ta kryesh me sukses këtë punë. Pasi mësimi dhe përhapja e sheriatit është diçka që nuk e dëshiron nefs:

Të kryesh urdhrat e sheriatit bie ndesh plotësisht

me nefs. Pasi sheriat ka ardhur në kundërshtim me nefs. Nganjëherë nefs mund të pëlqejë shpenzimin e pasurisë. Të harxhosh pasuri me qëllim që të mbështetësh sheriatin dhe të përhapësh fenë është tregues i një shkalle të lartë shpirtërore. Të shpenzosh një argjend me këtë qëllim është njësoj sikurse të shpenzosh me mijëra florinj për qëllime të tjera. (Letra e 48-të)

Veçanërisht në kohën kur myslimanët dhe Islami ndodhen nën tryzni, këto lloj institucioneve edukative pësojnë goditjen e parë dhe mbështetja që u duhet dhënë këtyre institucioneve në kohë të vështira është detyrë e secilit prej nesh. Miqtë e Zotit dhe njerëzit e tasavvufit, ngaqë kuptojnë rëndësinë e këtyre institucioneve, i kushtojnë vëmendjen e duhur edukimit fetar dhe bëjnë sakrificat të mëdha për të hapur institucione fetare ku mësohet Islami.



Nuk mund të ketë tasavvuf pa dituri, siç pandehin disa. Në krye të të gjitha gjendjeve shpirtërore është njohja. Ndaj dhe Imam Rabbani motivon të gjithë besimtarët me në krye të rinjtë të mësojnë dituri:

Dituritë e këtij grupi (sufive) janë dituritë e gjendjes. Gjendjet janë përfundimi i veprave. Gjendja që është tek një njeri, është rezultati i diturive, është kryerja siç duhet dhe me meritë e veprave. Të kryesh detyrat siç duhet realizohet atëherë kur një veprat dhe kur di çdo veçori të veprave; kur një namazin, agjërimin dhe farzet e tjera, muamelat-in (marrëdhëniet mes njerëzve), nikahun, divorcin, dituritë e marrëdhënieve etj. Këto dituri arrihen duke u përpjekur dhe mësuar dhe askush nuk duhet të qëndrojë indiferent duke mos i mësuar ato. Edhe dituria ndodhet mes dy përpjekjeve: e para, përpjekja për të mësuar, para se të mësosh dituri. E dyta: përpjekja për të përdorur (vepruar) diturinë, pasi ta kesh mësuar. (Letra e 29-të.)

Ndonëse qëllimi i edukimit sufist është më shumë aplikimi i diturisë, por kjo gjë pikësisht është e varur nga njohja e urdhrave dhe ndalesave. Allahu i Madhëruar kërkon që kryefamiljarët të jenë të durueshëm gjatë procesit të kryerjes së urdhrave fetare dhe gjatë kohës së mësimin të tyre. Pasi kjo punë është një proces i gjatë që kërkon të jesh i durueshëm.

Fatkeqësisht sot shumica e kryefamiljarëve i kanë harruar këto përgjegjësi dhe mendojnë sikur janë përgjegjës vetëm për ushqyerjen e familjes. Ndërkohë furnizimi i njerëzve është një dhuratë pa shpërblyerje që u ka dhënë atyre Allahu i Madhëruar. Zoti i Madhëruar këtë çështje na e kujton në këtë mënyrë: **“Urdhëroje familjen tënde, që të falë namazin dhe këmbëngul për këtë! Ne nuk të kërkojmë ty ndonjë ushqim: jemi Ne që të ushqejmë! Përfundimi i lumtur qëndron në frikën ndaj Allahut.”** (Taha, 132)

Ashtu siç janë duke u sprovuar prindërit lidhur me orientimin e fëmijëve drejt edukimit fetar, po ashtu

edhe vetë të rinjtë janë duke u sprovuar në këtë pikë. Rinisë së sotme i është tërhequr mjaftueshëm vëmendja nga edukimi, pasi që në moshë të re ata fillojnë të përballen me lloj-lloj vështirësish duke u përgatitur për universitet, për të gjetur vendin e tyre të punës, për të ardhmen. Ndërkaq, edukimi fetar është konsideruar si humbje kohe. Nefsi dhe shejtani urrejnë çdo lloj edukimi që njeriun e bën të afrohet më pranë Allahut:


Nefsi dhe shejtani, që janë kryearmiqtë e njeriut, gjatë periudhës së rinisë vijnë tek njeriu dhe merren me të. Në rini pak adhurim është i mjaftueshëm për t'u dalë në ballë me sukses atyre. Ndërkohë që ibadetet e bëra disa fish më tepër në pleqëri, ngaqë nuk ekziston një rrezikim i tillë nga nefsi dhe shejtani, është më pak i dobishëm se ai pak adhurim që bëhet në rini. Sipas rregullores së luftës, atëherë kur armiku sulmon dhe të rrethon, një lëvizje apo përpjekje sado e vogël e ushtarit është shumë e rëndësishme. Por një gjë e tillë nuk është aq e vlefshme në kohë paqeje apo atëherë kur është siguruar se nuk ka rrezik nga armiku.

Biri im! Njeriu, si esenca dhe thelbi i të gjitha krijesave, nuk është krijuar për argëtim, për lojëra, për të ngrënë e për të pirë apo për të fjetur. Por është krijuar për të kryer detyrën si rob i Zotit, duke adhuruar Zotin, duke treguar thjeshtësi, duke rrëfyer paaftësinë, duke u mbështetur tek Ai dhe duke iu përgjyruar Atij... (Letra e 73-të, v. I)

Në këtë kohë kur argëtimi dhe lojërat ndikojnë në jetën e të rinjve, të respektosh këtë thirrje, me sa duket është më e vështirë sesa dikur. Porse, ashtu siç shprehet edhe Imam Rabbani, shpërblimi që merret për shërbim ndaj Islamit në kohë të vështira është shumë më i madh sesa çdo herë tjetër.

Si përfundim, nuk janë vetëm të mëdhenjtë ata që kalojnë këtë provë, njëkohësisht janë të gjithë të rinjtë që kanë hyrë në periudhën e pjekurisë që përballen me sprovat të ndryshme. Në këtë kontekst, përgjigja që i jep Aliu Muhamedit (a.s.), duke i besuar, duhet të na hapë sytë e veshët që të gjithëve. Pejgamberi i nderuar (a.s.), kishte ftuar në Islam djalin e vogël të xhaxhait, Aliun dhe i kishte rekomanduar që të konsultohet me të atin, Ebu Talibin për këtë çështje. Aliu, duke qenë aq i vogël në moshë, i pati kthyer këtë përgjigje kaq të urtë: “Kur Allahu më krijoi mua, mos vallë u konsultua me të?! Atëherë pse vallë të konsultohem unë me babain për t'i besuar apo mos i besuar Zotit?!”

Allahu i Madhëruar u dhëntë suksese në këtë provë të madhe, si të rinjve, ashtu edhe të rriturve. Ndërkohë që marrim përsipër sprovat kaq të mundimshme në këtë botë të shkurtër, Zoti na ruajtë nga përtesa dhe ngadalësia për t'u përgatitur për botën tjetër të përjetshme. Amin!



Djelmoshat që i besuan **ALLAHUT**

— Raziye Tekgyl —

Djelmoshat që sfiduan kohën, duke u rebeluar kundër paganizmit, shkatërrues të vlerave hyjnore, njihen në terminologjinë fetare si “Ashabul-Kehf”. Në Kuranin e shenjtë, ata përshkruhen me nderime dhe kosiderata të larta **“Ata ishin djelmosha që besonin në Zotin e tyre dhe Ne i forcua në rrugën e drejtë.”** Përsa i përket numrit, kohës dhe vendit ku kanë jetuar, ekzistojnë pikëpamje të ndryshme. Qëllimi i tregimit nuk është dhënia e informacionit historik, por paraqitja e qëndrimit fisnik dhe të palëkundur që mbajtën këta djelmosha përballë presionit të fortë të gjithë shoqërisë politeiste. Një reagim i tillë plot krenari mund të burojë vetëm nga një iman i singertë e i rrënjësor thellë në zemër. Një zemër e nënshtruar plotësisht ndaj Allahut qëndron e palëkundur përballë çdo lloj vështirësie apo joshjeje tokësore e të përkohshme. Pyetjes së mbretit të asaj kohe Dakjanusit: “Kush është Zoti juaj?”, këta djelmosha besimplotë iu përgjigjën në mënyrë të prerë dhe të sigurt: **“Zoti ynë është Zoti i qiejve dhe i Tokës.”** Në këtë mënyrë shprehën bindshëm dhe qartë identitetin e tyre, duke shpallur distancimin e plotë të tyre nga idhujtaria politeiste dhe çdo gjë që ka lidhje me të.

Të sfidosh realitetin, në një kohë kur idhujtaria mbisundon çdo pjesë të shoqërisë, duke u ndjekur dhe mbrojtur me një fanatizëm të verbëruar nga çdo anëtar i saj...

Kurani, i cili ka zbritur për të ndarë të vërtetën nga gënjeshtra, përmend me detaje personalitete shembullore, si Ibrahim (a.s.), me qëndrimin krenar përballë mbretit mizor apo si Jusufi (a.s.), i cili triumfoi me dinjitet mbi tundimin e imoralitetit.

Jeta kuptimplote e këtyre djemve guximtarë, të cilët nuk ishin pejgamberë, është mësim dhe udhërrëfyes i çmueshëm për të gjithë brezat pasardhës në çdo periudhë historike. Jeta e tyre është më tepër se një pishtar që ndriçon ambientin përreth. Ata u përpoqën me ç’mundën për të përhapur dritën jetëdhënëse të tevhidit. Kjo përpjekje e tyre është shumë domethënëse për ata

që mendojnë për botën tjetër, siç mendojnë për jetën tokësore.

Dihet tashtëm se si e harxhojnë të rinjtë periudhën më të bukur dhe aktive të jetës së tyre dhe nën udhëheqjen e kujt prijësi e kanë dorëzuar jetën. Sot gjendemi përballë një turme të rinjsh melankolikë që nuk njeh historinë, kulturën dhe vlerat njerëzore, madje i mohon me forcë këto vlera. Ky grup të rinjsh, me kalimin e kohës ka arritur përmasat e një rreziku potencial për shoqërinë. Ankimi i të gjithë prindërve për fëmijët e tyre, ndërsa janë shkaktarët kryesorë për gjendjen e tyre të mjerueshme, është një paradoks mjaft interesant.

Sot jemi ballë për ballë me prindër që bëjnë përpjekje titanike, gjoja për të garantuar të ardhmen e fëmijëve, por me keqardhje mund të themi se po e shkatërrojnë të ardhmen e tyre, pa filluar akoma. Me pretendimin se po i shpëtojnë fëmijët, po i hedhin me duart e veta në zjarrin përvëlues të materializmit, duke shkatërruar lumturinë e përgjeshme të tyre. Për të rritur prestigjin e vet, përdorin fëmijët e tyre. Ngaqë në jetën e tyre nuk kanë realizuar asgjë, mburren me aftësitë e fëmijëve dhe përpiqen të ekzistojnë nën hijen e tyre.

Është e dhembshme kur shikon pasionin e tepëruar të myslimanëve ndaj kësaj bote. Pyes veten: kjo gjendje buron nga që myslimanët nuk i lexojnë urdhrat e Kuranit apo, megjithëse i kuptojnë, kanë rënë pre e dëshirave dhe epsheve. Fëmijët për të cilët po flasim, janë fëmijë të prindërve myslimanë. Ku është gabimi që po sjell shtimin e prindërve, të cilët po bëhen vrasës të fëmijëve të tyre? Si është e mundur që fëmijët, të lindur me natyrshmëri të pastër, braktisen nga prindërit e tyre në kopenë e ujqërve? A nuk duhej të ishte manteli i devotshmërisë një mburojë për ta? Përse fëmijët që rrjedhin prej familjeve besimtare po manifestojnë gjithnjë e më tepër sjellje të papëlqyeshme? Përse nuk nxirret mësim prej disa përvojave të hidhura? Si i lënë fëmijët me kaq dëshirë në dorën e një sistemi arsimor që synon shpëlarjen e trurit të të rinjve, nëpërmjet rrënimit të trashëgimisë së vlerave shpirtërore.

Me ndryshimin e madh që ka pësuar në mendësi dhe ndjesi kjo gjeneratë, mendoj se nuk e ekzagjeroj po të them se ka marrë një rrugë pa krye. Si Neroni që dogji Romën për hobi edhe në mesin tonë po rriten adoleshentë që, ku ta di për çfarë dokrine

apo ideali, fitojnë cilësinë “vrasës”. Këta të rinj, që nuk janë pajisur me dije dhe nuk veprojnë sipas arsyes së shëndoshë, janë si Donkishoti, aventurierë, ëndërrimtarë të ekzaltuar që nuk i njohin ligjësitë e vërteta të jetës, duke këmbëngulur në veprime që bien ndesh me logjikën më të thjeshtë. Kësaj rinië pasive dhe të përhumbur i duhen ndriçuar zemrat me dritën e islamit. Kjo rini duhet ta ndjejë rrënqethjen hyjnore. Çfarë dallimi kemi ne nga Hamleti, nëse mendojmë se zgjidhja e vetme është kthimi nga Kurani dhe, nga ana tjetër, nuk vihem në lëvizje për ta jetësuar. Nëse nuk i përvetësojmë siç duhet ajetet kuranore që na drejtohen pikërisht neve dhe t'i pasqyrojmë në sjelljet tona të përditshme, atëherë është me vend fjala e mendimtarit të shquar pakistanez Muhamed Ikbali, i cili thotë: “Është marrëzi të lexosh tefsiret e komentatorëve të famshëm të Kuranit.” Myslimani nuk duhet ta pranojë këtë gjendje, i zhytur në indiferentizëm. Prindi mysliman duhet ta informojë fëmijën për personalitetet shembullore islame, sepse islami synon formimin e një njeriu model. A po edukohen sot personalitete shembullore, si Ibrahim (a.s.), që të thyejnë normat johyjnore që njeriu i sotëm i konsideron të shenjta apo si Jusfi (a.s.), që përballë tundimeve imorale të thotë: “Allahu më ruajtë!” (Jusuf/23.) ose si Musai (a.s.), i cili, përballë padrejtësive pa fund nuk u dorëzua, por punoi pa u lodhur për të mbajtur drejtësinë në këmbë.

Sot përballemi me turma njerëzish, të cilët u ngjajnë statujave që nuk reagojnë ndaj asnjë lloji ngacmimi.

Këto profile njerëzish që janë bërë një lëmsh i madh në shoqërinë tonë, përmenden me admirim nga ana e shoqërisë. Kjo tregon se kanë humbur aftësitë opozitare dhe gjithkush shikon interesin e vet. Në asnjë kohë dhe në asnjë mënyrë imani nuk i ka pranuar sjelljet dhe veprimet e kufrit, ndërsa sot besimtarët bashkëjetojnë me të. Si munden myslimanët ta anashkalojnë këtë realitet të hidhur, duke u treguar kaq indiferentë. Ne si myslimanë duhet të jemi të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë që kemi për të kontribuar në ndryshimin e përmirësimit e gjendjes së mjerueshme në të cilën ndodhet shoqëria dhe jo të mburremi me atë që kanë bërë të parët tanë. Më së paku, ne si besimtarë duhet të jemi të vetëdijshëm që ky sistem jete nuk përputhet fare me parimet e islamit.

Urtësitë nga jeta e Jusufit a.s.

— Ma. Behrim Jusufi —

‘Në Jusufin dhe vëllezërit e tij, gjenden mësimet për të gjithë që gjurmojnë (pyesin).’ (12:7)

Prej ajkës kuranore janë nxjerrë mësimet e urtësi të panumërta, por megjithatë, duke pasur parasysh se Kurani është det i pashtershëm, gjithmonë mund të thellohen dhe nxirren mësimet plotësuese mbi ato që tanimë janë të njohura. Janë urtësi të shumta që mund të nxirren nga jeta e Jusufit a.s. por në vazhdim do të veçohen: mbështetja në Zotin; mos shpërfillja vëllazërore; unikja përballë sfidave; kodi moral dhe kujdesi ndaj ndershmërisë.

MBËSHTETJA NË ZOTIN

Pa dyshim se parimi esencial mbi të cilin sendërtohet besimi islam është mbështetja në Zotin. Me mbështetje në Zot nënkuptohet që e gjithë çështja t’i besohet Mëshiruesit, tërë qenia njerëzore të jetë e nënshtruar vullnetit të Tij, dhe se të kihet bindje se çfarëdo që i ndodh njeriut, e mirë apo e keqe në sytë e tij nuk mund t’i ndodhë pa caktimin e Tij. Me një fjalë, që në mënyrë paralele edhe ana fizike edhe ajo shpirtërore të jenë njëkohësisht në pajtueshmëri të plotë, në besim, nënshtrim dhe bindje ndaj Krijuesit Fuqiplotë.



Nga jeta e Jusufit a.s. hasim në urtësi të dyfishtë në këtë pikë. Fillimisht e gjejmë Jusufin a.s. si një rob të singertë, dhe që gjithmonë mbështetet tek i Lartësuar, por, kemi një rast kur këtë rregull paksa nuk e 'përfilli', dhe kjo padyshim se ishte urtësia Hyjnore, në rastin kur ai u mbështet fillimisht në të burgosurin, të cilit i tha përkujtomë tek mbreti, kështu i Gjithëdijsmi bëri që ta harrojë ky i burgosur, për dhjetë vite të plota, dhe kjo vetëm e vetëm pse në çast e 'harroji' Zotin dhe nuk tha: *'më përmend me lejen e Zotit tek mbreti.'*

MOS SHPËRFILLJA VËLLAZËRORE

Jeta e të dërguarit Jusuf a.s. bart plotë urtësi se si duhen të jenë raportet vëllazërore. Atë e gjejmë shumë bujar dhe të mëshirshëm ndaj vëllezërve të vetë, përkundër asaj se atë deshën ta vrisnin vetëm e vetëm se dëgjuan për ëndrrën të cilën ai ia tregoi babait të vetë, dhe për dashurinë që Jakubi a.s., tregonte ndaj të birit të tij Jusufit a.s.

Kështu, përkundër asaj që vëllezërit ia bënë Jusufit a.s. nga zilia, ai sigurisht nuk ua ktheu në të njëjtën mënyrë sikurse vepruan ata ndaj tij. Por, ai u tregua shumë bujar, i mëshirshëm dhe u doli në ndihmë në çastin kur ata më së shumti patën nevojë. Nga ky gjest mund të nxirret urtësia *se përkundër asaj se çfarë vepron dikush ndaj tjetrit vendimi i Zotit do të çohet në vend*, sepse përkundër zilisë vëllazërore e lajkave, për ta përbuzur Jusufin a.s. është Krijuesi Ai që, kë do e ngit lartë dhe kë do e poshtëron.

Jusufi a.s. prapëseprapë u bë ministër i financave në Misir, edhe përkundër zilisë që kishin ndaj tij, përsëri erdhi koha kur do të vërtetohej ëndrra e kamotshme e tij, por edhe vëllezërit e tij të bëhen nevojtar për të. Prandaj, këtu ka edhe një urtësi se nuk duhet shpërfillur vëllazërinë, sepse përsëri një ditë dëshira e Zotit do t'na dërgojë që të bëhemi nevojtarë për ta, dhe se i huaji nuk mund të ndjejë kurrë më shumë dhembshuri për dikë se ai që e ka nga po i njëjti bark. Jusufi a.s. u tregua i mëshirshëm, i fali u ndihmoi dhe përsëri i pranoi në gjirin e vetë në Misir, që t'i ketë pranë.

UNIKJA PËRBALLË SFIDAVE

Nga jeta e bujshme e këtij pejgamberi, shohim se si njeriu duhet të jetë unik përballë sfidave jetësore, edhe atëherë kur ai është në vështirësi edhe atëherë kur është në mirësi, lehtësi e begati. Këtu Jusufin a.s. e gjejmë si njeriun universal,

të gjithanshëm por edhe unik ndaj çdo situete jetësore.

Universal e gjejmë në të gjitha raste, sepse përkundër asaj se ishte i dërguar ai punon si shërbëtor, si rob i cili punon të gjitha punët gjatë viteve të burgut. Jeta e tij në burg ishte mësim për të burgosurit se si duhen të sillen, se si duhet të mbajnë qetësi e higjenë në hapësirat ku qëndronin të burgosur, dhe të gjitha këto ai u tregoi përmes veprës dhe jo vetëm fjalës, sepse ai bëri që burgu të dukej ndryshe, që të ketë rend, pastërti, kuptim dhe dashuri vëllazërore mes të burgosurve.

Unik e gjejmë si të lirë si të burgosur, si fisnik si varfanjak. Në pozitë si ministër apo i burgosur në burg ai vepron njëjtë, kujdeset për të varfëritë, e ndihmon nevojtarin, dhe për më tepër nuk ngopet shumë dhe agjëron, edhe atëherë kur ai pati kohën e lulëzimit të tij, respektit më të madh, në periudhën e begatisë së tij jetësore kur mund të zgjidhte ushqimet e llojllojshme. Por një gjë të tillë, e bënte nga dhimbja ndaj nevojtarëve dhe atyre që nuk kishin, dëshironte të *'shijonte si është gjendja e atij që nuk ka për ta ngopur barkun, në çastet kur ai ka me bollëk zgjidhje.'*

KODI MORAL DHE KUJDESI NDJË NDRERSHMËRISË

Në Jusufin a.s. gjejmë shembullin më të mirë për moral, dhe mënyrën se si njeriu duhet t'i qaset në jetë tematikës së intimitetit, dhe asaj se si duhet të kujdeset edhe për nderin e tjetrit. Nga kjo pikë mund të nxjerrim urtësi, se njeriu përkundër lakmisë ndaj gjinisë së kundërt, ai doemos duhet të kujdeset për moralin dhe parimet e ndershmërisë, sepse shtylla esenciale e një shoqërie njerëzore, e veçanërisht asaj islame është morali i mirë.

Zaten kjo fe është e sendërtuar mbi parimet e moralit, sjelljes, etikës, respektimit ndaj tjetrit dhe konsideratës se po qese u bën keq fqinjit, ti veç se i bërë dëm vetes. Aq larg islami i çmon parimet etike e morale sa që në fjalët kuranore hasim: *'Ty me të vërtet o, Muhamed (a.s.), të dërguam që t'ua përsosësh moralin atyre.'*

Pastaj, sa i përket asaj se nuk duhet cenuar sovranitetin e gjithanshëm individual të tjetrit dhe atë moral, hasim në thëniet autentike profetike qortime për ata prej të cilëve nuk janë të qetë dhe rahat të tjerët: *'Nuk është besimtar i mirë ai që prej dorës dhe gjuhës së tij, nuk janë të qetë besimtarë tjerë.'*



Rinia

SIPAS ISLAMIT

— Mehmet Emin Aj —

Sipas Organizatës së Kombeve të Bashkuara, rinia përkufizohet si periudha midis moshës 15-25 vjeç. Kurse sipas referencave psikologjike rinia fillon me shfaqjen e pubertetit dhe vazhdon deri në moshën 20-25 vjeç. Sipas këtyre përkufizimeve, rinia përbën një periudhë totale 10-13 vjet.

Në këtë periudhë përjetojnë ndryshime të mëdha fiziologjike dhe psikologjike. Rinia është periudha e lëkundjeve dhe transformimeve të mëdha. Periudha e rinisë është periudha më e përshtatshme për t'i dhënë formë jetës së njeriut.

Ndikimi është shumë i fuqishëm në këtë periudhë të jetës së njeriut. Rinia i ngjason pemës, e cila mugullon nga filizat dhe lulet për të dhënë frutat në fund të procesit.

Në epokën e teknologjisë dhe shkencës rinia është

grupi i synuar, sepse rinia është më e gatshme për të pranuar risitë. Por mundësitë e mëdha nuk po e bëjnë rinë më të lumtur dhe të suksesshme. Fatkeqësisht varësia ndaj cigares, alkoolit dhe drogës është shumë e përhapur midis të rinjve. Sot më tepër se kurrë rinia është e përfshirë nga sindroma e vetmisë. Të gjitha këto tregojnë që rinia kërkon më tepër interesim dhe ndihmë.

Islami me mesazhin e tij universal dhe përtej kohor i ka zgjatur duart e ndihmës në çdo periudhë njerëzimit. Në këtë kontekst nuk ka përjashtuar as rininë.

Kurani në shumë ajete na jep shembuj të personazheve historike, për shembull ngjarjen tragjike të djemve të Ademit, udhëkryqin e Nuhut (a.s.), si baba, luftën e Tevhidit të Ibrahimit (a.s.), bindjen e Ismailit (a.s.), nderin dhe durimin e Jusufit etj. Të

gjithë shembujt e Kuranit shërbejnë si udhërrëfyes për të riun mysliman.

Edhe në jetën dhe fjalët e Pejgamberit (a.s.), rinia zë një vend shumë të rëndësishëm. *“Kur të mos-huarit më përgënjeshtroan, të rinjtë më besuan”*, thotë Pejgamberi (a.s.), në një hadith.

Si Kurani ashtu edhe tradita profetike përmes shembujve ofron një sërë zgjidhjesh për problemet e rinisë.

Cilësitë që duhet të ketë i riu mysliman mund të grupohen në katër grupe.

1- BESIMI I PASTËR DHE I FORTË

Islami synon që ndjenjën e besimit, e cila ekziston tek të rinjtë ta shndërrojë në një besim të shëndoshë dhe të pastër vetëm për Allahun. Shembulli tipik i një besimit të tillë, pra qysh në rini, është Ibrahim (a.s.). Por ka pasur edhe të rinj të tjerë të cilët, megjithëse jo pejgamberë, janë lëvduar në Kuran siç është shembulli i të rinjve të shpellës.

Refuzimin e Pejgamberit (a.s.), për t'u betuar në emër të Latit dhe Uzzasë (dy idhujt kryesor të arabëve) dhe urrejtjen që ushqente ndaj tyre, historianët e tregojnë si argument për mosndotjen e besimit të Tij me idhujtarinë.

Dobësia më e madhe e rinisë së sotme është mungesa e një besimi të pastër dhe të shëndoshë. Rinia e sotme është e rrethuar nga fryma hedoniste, qëllimi i vetëm i së cilës është plotësimi i kënaqësive dhe dëshirave. E vetmja mënyrë për të qenë në paqe me Zotin është besimi i pastër dhe i shëndetshëm tek Ai. Në mënyrë që të jenë në gjendje të përballojnë krizat dhe vështirësitë gjatë jetës së tyre, duhet që rinia të pajiset me një edukim fetar të shëndetshëm qysh në fëmijëri.

2- RESPEKTIMI I PRINDËRVE

Islami, menjëherë pas besimit në një Zot të vetëm, urdhëron mirësjelljen ndaj prindërve. Në shembujt të ndryshëm tregon se kjo është një vlerë që duhet të karakterizojë rininë. Ibrahim (a.s.), babait të tij, megjithëse ishte idhujtar, gjithmonë i drejtohej me fjalë të ëmbla dhe gjithë respekt. Dialogu i Ibrahimit (a.s.), me djalin e tij të vogël Ismailin (a.s.), gjithashtu është një shembull i komunikimit prind-fëmijë. Sulejmani (a.s.), i cili ishte edhe mbret edhe pejgamber, në lutjen e tij nuk harronte asnjëherë prindërit. Jahjaja (a.s.), në Kuran përmendet si një bamirës dhe mirënjohës ndaj prindërve të vet edhe Isai (a.s.), prezantohet në Kuran si një person që sillej mirë dhe respektonte nënën e tij. Pejgamberi (a.s.), sa herë që vizitonte varrin e nënës së tij përloje.

Përloja e Pejgamberit (a.s.), kur vizitonte varrin e nënës së tij, kujdesi dhe respekti i veçantë që tregonte për nënën e qumështit, janë shembuj të cilët tregojnë rëndësinë e dashurisë dhe respektimit të prindërve.

3- MIRËSIA NDAJ VËLLEZËRVE

Të afërmit e tjerë në familje me të cilët personi është në kontakt dhe komunikim të vazhdueshëm janë vëllezërit. Vëllezërit shpesh janë sprovë për njëri-tjetrin. Kurani në rrëfimin e ngjarjes së djemve të Ademit, Habilit dhe Kabilit dhe hedhjen e Jusufit nga vëllezërit e tij në pus thekson pikërisht faktin e sprovës vëllazërore. Smira dhe zilia e detyroi Kabilin të vriste vëllain e tij. Edhe vëllezërit e Jusufit, të pushtuar nga e njëjta ndjenjë e hodhën atë në pus. Kurani përmes këtyre dy shembujve thekson rolin shkatërrimtar të smirës dhe zilisë. Përballë shembullit të keq qëndron Jusufi (a.s.), i cili i fali vëllezërit për veprimin e tyre. Shembull i mirësisë së treguar ndaj vëllait është Musai (a.s.), i cili iu lut Zotit ta bënte vëllain, Harunin, pejgamber si ai. Allahu, duke ia pranuar lutjen, e bëri edhe atë pejgamber.

Por Islami nuk urdhëron për mirësi vetëm ndaj vëllezërve të një gjaku, por ndaj gjithë vëllezërve të tjerë të fe.

4- FITIMI HALLALL DHE I PASTËR

Një pikë tjetër e rëndësisë së veçantë në pikëpamjen islame është edhe ushqimi hallall dhe i pastër. Nga Kurani mësojmë që të gjithë pejgamberët kanë pasur një profesion përmes të cilit siguronin jetën. Hadithet tregojnë që edhe pejgamberët kanë qenë ushqyer nga puna e tyre. Të gjitha këto tregojnë për rëndësinë e ushqimit hallall dhe të pastër. Kurse sot media i nxit të rinjtë të fitojnë përmes rrugëve të shkurtra. Sot të gjithë kërkojnë të fitojnë sa më shumë pa marrë parasysh faktin nëse puna është e ndershme apo jo. Sepse të gjithë besojnë se fitimi siguron dhe jep lumturi, por realiteti tregon se pasuria nuk jep lumturi.

Një tjetër çështje shumë e rëndësishme është pastërtia e ushqimit që konsumojmë. Sot ushqimet që konsumojmë lënë shumë për të dëshiruar për sa i përket pastërtisë. Ushqimi është shumë i rëndësishëm, sepse prej tij ndikohet edhe trupi edhe shpirti. Shumë ushqime dhe pije të cilat i serviren rinisë sot janë të dëmshme jo vetëm për shëndetin fizik, por edhe për shëndetin shpirtëror. Për ta mbyllur me një hadith, i cili është udhërrëfyes edhe për temën tonë, por për çdo çështje në jetën e përditshme: *“Braktise të dyshimtën dhe kapu pas të sigurtës”*.

KULTURA POPULI

— Prof. dr. Mehmet Gërmez —

Me përpahjen e gjerë të mjeteve të komunikimit masiv në periudhën moderne, kultura populiste e cila ka përfshirë nën ndikimin e saj pothuajse çdo anë të jetës sonë, po zaptton gjithnjë e më tepër mendimin, shpirtin dhe personalitetin tonë. Kultura populiste nuk po mjaftohet vetëm me pushtimin, por po i shndërron vlerat tona materiale dhe shpirtërore në një e nga një në material konsumi. Duke u bërë tërheqëse për masën, kultura populiste ka filluar të krijojë hartën e vet të shenjtë. Sot mund të flasim për një degjenerim serioz të përfutur nga ndikimi i popularizmit, duke filluar nga mënyra e ngrënies, pirjes, veshjes, përshendetjes, urimeve, fejesës, martesës, komunikimit, muzikës, artit etj.

Individi i mbetur nën ndikimin e kulturës populiste, për të vazhduar ekzistencën ose për të fituar status në shoqëri është i detyruar të shndërrohet në objekt të kësaj kulture ose për të mos u përjashtuar nga shoqëria, është i detyruar të jetë i informuar rreth elementeve të kësaj kulture.

Kultura populiste, e cila zotëron aftësinë për të ndikuar në një kohë mjaft të shkurtër mbi shoqërinë, fatkeqësisht është shndërruar sot në mjetin më të rëndësishëm të ekspansionit kulturor. Kjo kulturë po përdoret si mënyra më e shkurtër dhe e shpejtë për ta zhveshur shoqërinë nga vlerat dhe kultura e vet tradicionale. Kjo kulturë shfaqet duke krijuar dëshira të përkohshme, që tërheqin interesin e shoqërisë, pastaj zhduket duke u konsumuar në

mënyrë të pavetëdijshme nga populli. Megjithatë kultura populiste shfaqet si një dukuri e preferuar nga populli, ajo nuk mbështet në asnjë vlerë.

Kultura populiste është e fokusuar kryesisht te rinia, sepse ajo është më e gatshme për t'u përshtatur me gjendjet e reja dhe përvetësuar vlerat e kulturave të ndryshme. Duke qenë e mbushur me ndjenja, energji, dëshira, pasione dhe emocione të larta, rinia bëhet shpejt pre e rrjetës së kulturës populiste.

Të gjitha identitetet e rreme, heronjtë e rremë, bota dhe imazhet shumëngjyreshe që u serviren si modele të rinjve, të cilët janë akoma në periudhën e njohjes së vetvetes, inkurajojnë kulturën populiste. Në ndikimin e kulturës populiste, rinia alienizohet nga shoqëria ku jeton, duke u përballur kështu me kriza identiteti dhe brezash. Si përfundim, na shfaqet një rini e shkëputur nga familja dhe vlerat fetaro-shpirtërore, e privuar nga qëllimet dhe idealët e larta dhe e zhytur pas pasioneve, dëshirave dhe epsheve. Edhe pse mund të shpëtojnë në planin material, në planin shpirtëror dëmet janë bërë pothuajse të pandreqshme. Prandaj është detyrë e çdo myslimani t'i ofrojë rinisë një jetë konform vlerave fetare.

Rinia duhet të edukohet me vlerat e dashurisë, respektit, dinjitetit, punës, sakrificës, nderit, diturisë dhe guximit. Ata nuk duhet të jenë pararojë në shkatërrimin e vlerave, por në ruajtjen dhe mbajtjen



LISTE DHE RINIA

gjallë të tyre. Të rinjtë duhet të jenë ushtarët para-
rendës të kauzës islame në gjithë botën. Vetëm në
këtë mënyrë mund të dalin personalitete të mëdha të
përmasave botërore. Kjo kulturë mund të prodhojë
profesionistë, por nuk mund të prodhojë personalite
që të marrin përsipër problemet e shoqërisë.

Rinia duhet t'i marrë vlerat nga Kurani dhe jeta
model e Pejgamberit (a.s.). Ata duhet të
zënë një vend shumë të rëndësishëm
në botën e Pejgamberit tonë të dashur.
Pejgamberi (a.s.), gjithmonë ka
krijuar një lidhje të sinqertë dhe
të veçantë me të rinjtë. Ai është
interesuar në mënyrë të večan-
të për edukimin e rinisë dhe
shkolla ku u edukuan këtë të
rinj nxori njerëz që udhëhoqën
botën drejt dritës hyjnore. Ata
morën përgjegjësi të mëdha në
administratë, ushtri, arsim, tregti
etj.

Personalitete të tilla, si: Ebu Hurejra,
Abdullah ibn Omer, Adullah ibn Mesur,
Abdullah ibn Abbas, Muadh ibn Xhebel, Enes ibn
Malik (r.anhuma), e shumë të tjerë që u edukuan
nën kujdesin e Pejgamberit (a.s.), janë shembuj
model të kontributit në ndërtimin e qytetërimit dhe
kulturës islame në botë.

Natyrisht që rinia ka problemet e veta karakteris-

tike për periudhën e saj. Periudha e rinisë është një
periudhë ku fuqia dhe entuziazmi janë në kulmin
e tyre. Po t'u shtosh këtyre dy elementeve edhe
mungesën e përvojës, atëherë rreziku për të hyrë
në qorrsokake është shumë i madh. Përgjegjësia
për t'i ndihmuar ata të shikojnë gabimet, është e
të rriturve, e prindërve, e mësuesve, e hoxhallarë-
ve etj. Në të njëjtën kohë, është shumë e

rëndësishme që rinia në këtë periudhë
të orientohej në respektimin e ur-
dhëresave dhe ndalesave fetare.

Pejgamberi (a.s.), i ka siguruar
të riut që ruhet nga harami hije
nën arshin e Allahut në Ditën e
Gjykmit. Prezantimi i ibadetit
si një nga shkaqet kryesore në
përfshirjen e rinisë në grupin
që do të jetë nën hijen e arshit
të Allahut, tregon rolin e ibade-
tit në ruajtjen e rinisë nga dënimi
hyjnor dhe rëndësinë e një rinie të
pastër, që qëndron larg haramëve, për
të ndërtuar një shoqëri të pastër dhe të
shëndoshë.

Dëshira jonë më e madhe është edukimi i një ri-
nie të vetëdijshme dhe të gatshme për të marrë mbi
supe përgjegjësitë e së ardhmes dhe për të ndërtuar
botën sipas vlerave hyjnore. Një rini që do të jetë
model për botën islame në veçanti dhe për të gjithë
botën në përgjithësi...

Rinia duhet të edukohet
me vlerat e dashurisë, respektit,
dinjitetit, punës, sakrificës,
nderit, diturisë dhe guximit.
Ata nuk duhet të jenë pararojë
në shkatërrimin e vlerave,
por në ruajtjen dhe mbajtjen
gjallë të tyre.





PROBLEMET E RINISË

dhe zgjidhja e tyre

— Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz —

Në periudhën moderne, delikatesa ndaj materiales ka sjellë shfaqjen e vrazhdësisë ndaj njerëzores. Zhvillimi dhe përparimi teknologjik, nga njëra anë e ka bërë jetën më të lehtë, kurse nga ana tjetër, më të vështirë. Problemet më të mëdha të teknologjisë më së shumti rëndojnë mbi rininë. Të jepet përshtypja se problemet e rinisë shtohen në përpjesëtim të drejtë me zhvillimin teknologjik.

Deri në gjysmën e dytë të shekullit XX, personaliteti i të riut zhvillohej dhe merrte formë në familje, shkollë dhe në mjedisin shoqëror. Një pjesë e mirë e personalitetit të rinisë mbruhej në familje, pastaj në shkollë dhe diçka më pak në mjedisin shoqëror. Zhvillimi teknologjik u shtoi këtyre tre elementëve edhe një të katërt, median. Megjithëse televizioni, radioja, kompjuteri dhe interneti hynë vonë në procesin e formimit të personalitetit të rinisë, ata shumë shpejt u radhitën të parët përse i përket rëndësisë dhe peshës në formimin e personalitetit të rinisë. Media me një shpejtësi marramendëse ndikoi në marrëdhëniet njerëzore. Prandaj në themel të problemeve të rinisë ndikimi i medias është i madh.

Rinia është një periudhë kur trupi dhe shpirti i njeriut është i gjallë dhe dinamik, zemra është altruiste dhe pritshmëritë nga jeta janë të larta. Moshë e rinisë karakterizohet nga gjallëria, dinamizmi, entuziazmi, ndjenja e sipërmarrjes dhe iniciativës. Prandaj ekziston shprehja: “Njerëzit në përgjithësi deri në moshën njëzet vjeç janë idealistë, nga moshë njëzet e pesë deri në tridhjetë janë socialistë, mbas moshës tridhjetë janë realistë dhe mbas moshës dyzet vjeç kanë prirjen të jenë kapitalistë.” Kurse Pejgamberi (a.s.), në një porosi të Tij thotë: “Me kalimin e moshës, tek njeriu zhvillohen dy ndjenja:

dashuria për pasuri dhe dëshira për të jetuar gjatë.” Rinia udhëhiqet më shumë nga ndjenjat sesa nga arsyeja.

Rinia është e ardhmja e një kombi. Kurani flet për të rinj si Ibrahim, Musai, Jusufi (a.s.), që ia kanë dedikuar jetën e tyre Tevhidit. Ibrahim (a.s.), pati luftuar kundër Nemrudit, Musai (a.s.), kundër Faronit, Jusufi (a.s.), që përballur me probleme serioze në rininë e tij.

Pejgamberi (a.s.), i ka dhënë një rëndësi dhe vlerë të madhe rinisë. Pjesa më e madhe e individëve që Pejgamberi (a.s.), u kishte dhënë përgjegjësi përbëhej prej të rinjve. Në qytetërimin islam kanë ekzistuar institucione të veçanta që shërbenin për edukimin fizik, shpirtëror dhe profesional të të rinjve.

Zhvillimi i teknologjisë dhe komunikimit e ka shndërruar botën në një fshat të madh. Rrjetet e komunikimit informativ po rrisin gjithnjë e më tepër ndikimin mbi marrëdhëniet njerëzore dhe po sjellin me vete ndotjen kulturore të njerëzve, por veçanërisht të rinisë. Ndotja kulturore e ka gjetur ambientin më të përshtatshëm për t’u zhvilluar te rinia. Media vizive dhe e shkruar është duke ndikuar shumë negativisht tek rinia, sidomos përmes programeve me përmbajtje seksuale. Media është duke e orientuar rininë drejt vlerave materiale dhe hedoniste. Është si pasojë e kësaj propagande përhapja e imoralitetit, shthurja dhe prishja e ekuilibrave në familje, vonimi i martesës dhe refuzimi i të rinjve për t’u bërë prindër. Telenovelat, gazetat dhe revistat e mbushura me thashetheme po ulin në minimum produktivitetin e rinisë dhe po e largojnë nga jeta reale.

Problemet e rinisë mund t'i radhisim në këtë mënyrë:

1. Problemet e personalitetit,
2. Problemet me shoqërinë dhe shkollën,
3. Problemet me mjedisin shoqëror,
4. Problemet e krijuara nga media dhe rrjetet sociale,
5. Problemet e besimit.

1. PROBLEMET E PERSONALITETIT

Problemi më i rëndësishëm i rinisë në çdo periudhë ka qenë problemi i personalitetit. Janë të njohura problemet e vetëbesimit dhe dëshirës për promovim, që përjetojnë të rinjtë gjatë procesit të kalimit nga fëmijëria në pjekuri. Tek të rinjtë, ndaj të cilëve nuk tregohet respekti dhe dashuria e duhur, procesi i përshtatjes është problematik dhe më i gjatë. Të rinj që krijojnë probleme shoqërore, në përgjithësi u përkasin familjeve jo të shëndosha ose janë rritur në ambiente ku ka munguar dashuria. Problemi më i madh i të rinjve që shkelin ligjin, kryejnë vjedhje dhe krime, është mungesa e dashurisë dhe interesimit për ta. Problemet e personalitetit janë lehtësisht të kapërcyeshme, kur fëmijët rriten në një ambient të sigurt dhe të mbushur me dashuri.

2. PROBLEMET ME SHOQËRINË DHE SHKOLLËN

Në adoleshencë të rinjtë fillojnë të krijojnë marrëdhënie intensive shoqërore dhe miqësore. Në këtë periudhë është shumë i rëndësishëm orinetimi i tyre drejt krijimit të shoqërisë me të rinj të sjellshëm, ndjekja e sjelljeve të tyre pa u vënë re dhe mbështetja pa ushtruar presion në zgjidhjen e problemeve. Prindërit që përpiqen t'i rregullojnë dhe përmirësojnë sjelljet e fëmijëve në mënyrë autoritare, në fakt dëmtojnë në mënyrë të pavetëdijshme personalitetin e tyre, duke i bërë ose të pabindur, ose të ndrojtur. Prindërit ndaj të rinjve duhet të sillen si shokë dhe problemet e tyre duhet të përpiqen t'i zgjidhin qetësisht. Ashpërsia dhe sjellja autoritare i çon ata në fshehjen e disa veprimeve, madje kur janë në vështirësi i çon në gënjeshtëri. Kjo është periudha kur të rinjtë përmes shoqërisë së keqe fitojnë sjellje të këqija dhe mënyra më e mirë për të shpëtuar nga sjelljet e këqija është qëndrimi larg tyre.

3. PROBLEMET ME MJEDISIN SHOQËROR

Mjedisi shoqëror luan një rol mjaft të rëndësishëm në ndërtimin e personalitetit të njeriut. Rritja dhe zhvillimi i fëmijëve në një mjedis steril dhe larg ndikimeve negative të mjedisit shoqëror, është e pamundur, por për të minimizuar ndikimin negativ

të rrugës fëmijët duhen angazhuar me aktivitete sportive dhe kulturore.

4. PROBLEMET E KRIJUARA NGA MEDIA DHE RRJETET SOCIALE

Ndikimi i medias mbi sjelljet e njeriut është i padiskutueshëm. Për të kuptuar ndikimin e medias mbi njerëzit, mjafton t'i hedhim një sy kohës që zë televizioni, kompjuteri dhe interneti në jetën tonë. Njerëzit e kalojnë një pjesë të madhe të kohës përpara televizorit, kompjuterit dhe internetit. Përderisa media është bërë pjesë e jetës sonë të përditshme, ne duhet t'i mësojmë rinisë t'i përdorë këto mjete teknologjike për gjëra të dobishme. Natyrisht që kjo arrihet me durim dhe duke vlerësuar mendimet dhe dëshirat e tyre.

5. PROBLEMET E BESIMIT

Një problem tjetër i të rinjve, që kanë probleme personaliteti dhe që janë të pambrojtur nga ndotja kulturore, është edhe problemi që buron nga mungesa e njohurive fetare dhe mosnjohja saktë dhe drejt e fesë. Mbrojta e rinisë nga ideologjitë dhe sektet e devijuara dhe të shthurura është e mundur vetëm përmes mësimi dhe ngulitjes në zemrat e tyre të Tevhidit të pastër.

Rinia është përballë rrezikut të madh të ateizmit, satanizmit, jehovaizmit dhe sekteve të tjera orientale, si budizmi, konfucianizmi etj.

Sugjerimet tona për zgjidhjen e problemeve të besimit janë:

1. Pajisja e të rinjve me njohuritë dhe diturinë e duhur dhe të dobishme.

2. Mbrujtja e botës shpirtërore me dashuri, virtyte, moral të bukur dhe ndërgjegjësimi i tyre për ibadetin ndaj Allahut.

3. Kalimi i tyre përmes një edukimi shpirtëror rigoro, i cili mund t'u sigurojë atyre një personalitet solid dhe t'i ruajë nga kurthet e egos.

4. Inkurajimi i tyre për kryerjen e ibadeteve dhe tregimi i shembullit vetjak.

5. Krijimi i kushteve të përshtatshme për zhvillimin e një personaliteti që ka vetëbesim, vetësiguri dhe që nuk bie ndesh me vlerat e shoqërisë.

6. Duke u nisur nga pasioni dhe dëshira e madhe e të rinjve për të ndjekur një model dhe për t'u njohur me të, ne duhet t'u prezantojmë dhe t'i njohim me modele shembullore me të cilat historia jonë është e mbushur plot. Duhet t'i inkurajojmë fëmijët të lexojnë historitë e pejgamberëve, sahabëve dhe heronjve islamë. Përveç figurave historike, fëmijët duhen njohur dhe prezantuar me modele të gjalla prej të cilave mund të përfitojnë shumë.



Vëllazëria që na mësoi *i Dërguarit të Allahut (a.s.).*

— Xhafer Durmush —

Në suren Huxhurat, urdhërohet:

“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që të mëshiroheni.” (Huxhurat, 10)

Siç theksohet edhe në ajetin e mësipërm, besimi është lidhja më e rëndësishme që i bën vëllezër të gjithë besimtarët. “Kuadri i vëllazërisë” që përmendet këtu, është i çliruar nga çdo lloj kufizimi që mund të vijë në mend. Vëllazëria fetare është më superiore se vëllazëria e gjakut. Kjo, sepse nëse vëllazëria e gjakut zbehet prej dallimeve fetare, vëllazëria fetare nuk zbehet prej dallimeve të gjakut. Nisur nga kjo, kur dy individë apo dy grupe besimtarësh prishen, është urdhëruar që ata të pajtohen menjëherë.

Kornizën e përgjithshme që është përcaktuar në ajetin fisnik, e shpjegon Profeti (a.s.). Ai na bën të ditur se cilat sjellje dhe në ç’masë i japin formë vëllazërisë fetare, na mëson se çfarë duhet të kemi kujdes për ruajtjen dhe zhvillimin e atmosferës së vëllazërisë dhe po ashtu, na tërheq vërejtjen edhe ndaj gjërave që e cenojnë vëllazërinë, duke thënë:

“Besimtarët i ngajnë trupit në dashurinë, në dhembshurinë dhe në mbrojtjen ndaj njëri-tjetrit. Kur sëmuret një organ i trupit, edhe pjesët e tjera të trupit mbeten pa gjumë dhe i kap temperatura.” (Buhari, Edeb, 27.)

“Myslimani është vëllai i myslimanit. Ai nuk i bën padrejtësi atij dhe nuk e dorëzon tek armiku. Plotësojini nevojat e vëllait të fesë, që edhe Allahu t’ju largojë juve nevojën. Largojeni një vështirësi nga myslimani, që edhe Allahu t’ju largojë një prej vështirësive në Ditën e Kiametit. Mbuloni të metën e një myslimani, që edhe Allahu t’ju mbulojë të metat tuaja në Ditën e Kiametit.” (Buhari, Mezalim, 3)

“Mos e smironi njëri-tjetrin. Mos i shkaktoni dëm njëri-tjetrit nga tregtia e pandershme. Mos e urreni njëri-tjetrin. Mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit. Mos u fusni në pazar ndërkohë që dikush tjetër është duke bërë pazar (për të njëjtin mall). O robërit e Allahut, bëhuni vëllezër! Myslimani është vëllai i myslimanit, nuk i bën padrejtësi atij, nuk e lë pa ndihmë dhe nuk e përçmon. (Duke bërë tri herë me shenjë kraharorin, tha): ‘Devotshmëria është këtu. Njeriut i mjafton si vepër e keqe përçmimi i vëllait të tij mysliman. Çdo mysliman e ka haram gjakun, pasurinë dhe nderin e myslimanit tjetër.’” (Muslim, Birr, 32)

Ndërsa Imam Gazaliu i ndan në tetë pika të drejtat vëllazërore dhe thotë:

E drejta e parë është në pasuri. Dy vëllezër duhet të jenë si dy duart që lajnë njëra-tjetrën kur bëhet fjalë për plotësimin e nevojave të njëri-tjetrit. Vetëm nëse bashkohen me këtë qëllim, vëllazëria e besimtarëve mund të jetë e plotë. Dhe kjo e bën

të domosdoshme që të bëhen ortakë në kamje dhe në skamje, në vështirësi dhe rehati. Madje, vëllai i fesë duhet të vendoset para vetvetes.

E drejta e dytë është kur e sheh vëllain që ka nevojë për ndihmë, t'i shkojë në ndihmë pa pritur që ta kërkojë ai, duke shtyrë edhe punët e veta për më vonë.

E drejta e tretë është në gjuhë. Ndonjëherë, vëllai duhet të heshtë në lidhje me vëllain e vet e ndonjëherë duhet të flasë. Kjo nënkupton që ai të bëjë sikur nuk i sheh të metat e tij, si në prani ashtu edhe në mungesë të tij dhe të mos flasë fare për to. Të ruhet nga kërkimi i nënkuptimeve gjatë një debati. Kur ta shohë në rrugë, të mos e pyesë se nga vjen e ku po shkon, sepse mbase nuk dëshiron të flasë dhe detyrohet të gënjejë. Të mos nxjerrë sekretet e askujt.

E drejta e katërt është në lidhje me të folurën. Vëllazëria kërkon përdorimin e fjalëve të mira, ashtu siç nuk i pranon fjalët e këqija. Të flasësh fjalë që e shtojnë dashurinë, është një nga veçoritë e vëllazërisë. Kuptimi i vëllazërisë, është të ndash gëzimin dhe harenë, dhimbjen dhe hidhërimin.

E drejta e pestë është në lidhje me faljen e disa gabimeve të vëllait. Gabimet e mikut, bëhen ose kundrejt fesë, ose kundrejt vëllazërisë. Nëse vëllai këmbëngul në gabime dhe gjynahe, ai duhet këshilluar në atë mënyrë që t'ia drejtojë të shtrembërën dhe t'ia korrigjojë gabimin.

E drejta e gjashtë është lutja e mirë për vëllain dhe familjen e tij, si gjatë jetës ashtu edhe pas saj. Ai nuk duhet të bëjë dallim midis vetes dhe atij, sepse lutja e myslimanit për vëllain e tij, në të vërtetë është si lutje për vetveten.

E drejta e shtatë është besnikëria dhe sinqeriteti. Besnikëria kërkon vazhdimin e dashurisë dhe miqësisë derisa të vijë vdekja dhe pas vdekjes të vizitohet shpesh familja e tij. Në fakt, dashuria duhet të zgjatë edhe në botën tjetër. Nëse miqësia mbaron pa ardhur vdekja, përpjekjet e bëra do të shkojnë dëm. Për rrjedhojë, edhe Profeti ynë (a.s.), kur po numëronte shtatë grupet që do të strehohen në hijen e arshit të Allahut, përmendi edhe "ata që e duan njëri-tjetrin për hir të Allahut dhe që bashkohen e ndahen po për hir të Tij".

E drejta e tetë është të mos i bëhesh barrë vëllait dhe të mos i bësh kërkesa të panevojshme. Madje, me aq sa është mundësia, t'i fshehësh nevojat personale prej tij. Të mos kërkosësh prej tij pasuri dhe pozitë. (Ihja Ulumi'd-Din, V. 2, fq. 431-467.)

Si përfundim, mund të themi se kemi shumë nevojë për ringjalljen e të vërtetës që theksohet në Kuran, se **"të gjithë besimtarët janë vëllezër"**. Kemi nevojë t'i vëmë në jetë përsëri të drejtat e vëllazërisë që theksohen në hadithet e Profetit (a.s.). Kemi nevojë të flasim përsëri për edukatën vëllazërore që kanë formuluar dijetarët, të cilët janë edhe trashëguesit e profetëve. Bota ka nevojë për Islamin dhe Islami ka nevojë për besimtarë "prej dorës dhe gjuhës së të cilëve janë të sigurt myslimanët"¹

1. -shih. Buhari, Iman, 4-5.

ÇELËSI I TË GJITHA MIRËSIVE

Në suren Dharijat, gjendet një lajm që përçon shpresë në zemrat besimtare: **"Pa dyshim, ata që i frikësohen Allahut do të jenë në kopshte dhe burime, duke marrë atë që ua ka dhuruar Zoti i tyre..."** (Dharijat, 15-16.) Ndërsa në ajetet në vijim, jepen veçoritë e atyre që e meritojnë këtë sihariq të madh: **"...(të cilët) më parë kanë qenë punëmbarrë, flinin pak natën, ndër-sa në agim kërkonin falje (nga Allahu)."** (Dharijat, 16-18.) Gjithashtu edhe në ajete të tjera si këto, Zoti ynë i Madhëruar i fton besimtarët në adhurimin e natës dhe në kërkimin e faljes. (shih. Sexhde, 16; Isra, 79.)

Ndërsa Profeti (a.s.), ftesën për adhurimin e natës, e përforcon me fjalët e tij: **"O njerëz! Jepini selam njëri-tjetrit, ushqeni të tjerët dhe falni namaz natën kur të tjerët flenë! Nëse veproni kështu, do të hyni në Xhenet."** (Tirmidhi, Et'ime, 45.) Po ashtu, atyre që e pyesnin se përse bënte adhurime derisa i enjteshin këmbët, megjithëse i ishin falur gjynahet e shkuara dhe të ardhme, Profeti ynë (a.s.), u përgjigjej: **"A të mos bëhem një rob falënderues?"** (Buhari, Tefsiru Sure, 48.) Ai i nxiste shokët e tij për namazin e natës, duke i thirrur emër për emër dhe thoshte: **"Mos u bëni si filanë që nuk e vazhdon namazin e natës!"** (Buhari, Tehexhahud, 19.)

Pra, siç lajmërohem prej ajeteve dhe haditheve fisnike, rruga që shkon në krye të burimeve të Xhenetit, hapet me ata që qëndrojnë zgjuar natën para agimit dhe ata që janë bujarë gjatë ditës.

Përgëzuar qofshin ata që bartin dritë prej netëve dhe ata që mbledhin mirësi që në këtë botë për botën tjetër!



Rinia dhe xhamia



— Prof. dr. Mehmet Gërmez —

Allahu çdo njeriu i ka dhënë një afat të caktuar jete në këtë botë. Në gjuhën arabe fjala “jetë” dhe “ndërtim” vijnë prej së njëjtës rrënjë. Prandaj një jetë e cila nuk është e mbushur me ndërtim nuk konsiderohet jetë. Allahu e ka krijuar njeriun prej toke dhe i ka dhënë atij detyrën e ndërtimit në tokë. Në këtë proces ndërtimi, parësor është ndërtimi i zemrës dhe shpirtit, sepse njeriu pa ndërtuar shpirtin dhe zemrën nuk mund të ndërtojë qytete, fshatra, kulturë dhe qytetërim. Çdo njeri për të ndërtuar vetveten ka nevojë për besim dhe për një faltore. Në Ditën e Gjykimit njeriu, pasi të pyetet se ku dhe si e ka kaluar jetën e tij, do të pyetet veçanërisht për periudhën e rinisë e cila në vetvete është pjesa më e rëndësishme e gjithë jetës së tij. (Trimidhi, Sifatu'l Kijame, 1.) Pejgamberi (a.s.), të riun ideal e ka përkufizuar si personin i cili e kërkon lumturinë dhe gëzimin në ibadetin ndaj Allahut. Nga ana tjetër, ka lajmëruar se i riu që mbron nderin dhe zemrën e ka të lidhur me xhaminë në Ditën e Gjykimit do të jetë nën hijen e Allahut. (Buhari, Ezan, 36.) Pejgamberi (a.s.), të riun në rrugë të drejtë dhe të vetëdijshëm për përgjegjësinë që mbart e ka konsideruar si një pengesë të fortë përballë dënimit hyjnor. Sipas Pejgamberit (a.s.), për ndërtimin e një shoqërie të shëndoshë është i një rëndësie jetësore kalimi i periudhës së rinisë në ibadet dhe larg ndalesave hyjnore. Në jetën e Profetit (a.s.), të rinjtë kanë pasur një vend të veçantë. Pejgamberi (a.s.), ndërtonte një komunikim shumë të shpejtë dhe të sigurt me të rinjtë dhe interesohet personalisht për edukimin dhe arsimimin e tyre. Të gjithë të rinjtë që kaluan përmes edukimit të Pejgamberit (a.s.), u bënë gjithsecili nga një pishtar i cili ndriçonte njerëzimin. Ishte ky besim që kishte Pejgamberi (a.s.), tek rinia që e shtyu atë t'u jepte atyre detyra të rëndësishme, duke filluar nga drejtimi tek komandant ushtrie, nga mësimdhënia në tregti. Sahabët e rinj, të edukuar nga Pejgamberi (a.s.), si Ebu Hurejre, Abdullah ibn Omer, Abdullah ibn Mesud,

Abdullah ibn Abbas, Muadh ibn Xhebel, Enes ibn Malik etj., të cilët kanë kontribute të veçanta në ndërtimin e qytetërimit islam. Në qytetërimin islam janë dalluar shumë të rinj të cilët me diturinë, urtësinë, shkencën, poezinë, letërsinë, kulturën, artin, dashurinë i kanë dhënë tonin qytetërimit islam. Në qytetërimin islam të rinjtë gjithmonë janë konsideruar si personalitetet e së ardhmes.

Natyrisht që periudha e rinisë ka edhe vështirësitë e veta. Së pari periudha e rinisë është periudha ku forca, fuqia, entuziazmi dhe dëshira janë në kulmin e tyre. Të rinjtë janë të gatshëm të përqafojnë kulturë të ndryshme, pa i situatuar vlerat e tyre dhe kanë aftësi t'u përshtaten menjëherë gjendjeve të reja. Kjo sjell tëhuajzimin e tyre me shoqërinë, përplasjen e brezave dhe krizë identiteti. Dhe si përfundim, një rini e shkëputur nga familja, nga vlerat fetaroshpirtërore, një rini e cila vrapon mbas përmbushjes së dëshirave momentale krejtësisht larg idealeve, normalisht që e ka shumë të vështirë për të përballuar dhe luftuar sëmundjet e kohës.

Rinia e sotme e konsideron botën e paraardhësve të ngushtë dhe të papranueshme. Prandaj është e rëndësishme që në komunikim me rininë të ndërtojmë një mënyrë të re. Rinia e sotme i jep rëndësi të madhe individualitetit, prandaj ne nuk duhet të ndërhyjmë në çështjet individuale të tyre, por duhet të krijojmë ura komunikimi me zemrën dhe botën e tyre të mendimeve, të bisedojmë dhe t'u paraqesim atyre një model përmes të cilit të zbulojnë veten e tyre. Është e vërtetë që të rriturit kanë probleme të theksuara në krijimin e një komunikimi normal me brezin e ri, por kjo vjen edhe nga fakti që ne jemi mësuar vetëm t'u flasim atyre, por në të vërtetë ne më tepër se t'u flasim duhet t'i dëgjojmë ata. Kjo është një domosdoshmëri për t'i kuptuar dhe hyrë në botën e zemrës së tyre.

Lutja jonë është rritja e një rinie e cila mbron vlerat shpirtërore dhe merr përsipër përgjegjësitë për të ardhmen!

Pasuria që vlente sa dy gota ujë

— Ferudun Ozdemir —

Një herë e një kohë jetonte një mbret që posedonte një pasuri përrallore. Në çdo udhëtim ai merrte me vete një pjesë të pasurisë dhe ndjente kënaqësi të madhe duke e ekspozuar atë në mesin e njerëzve. Mbreti kishte shumë këshilltarë dhe shërbëtorë, por nuk u besonte asnjërit prej tyre. Mirëpo kur i nevojitej të këshillohej për ndonjë çështje, përherë trokiste në derën e një plakut të urtë të cilin e vlerësonte për diturinë dhe maturinë prej dijetari. Një ditë mbreti e pyeti:

“O njeri i urtë! Ti a ke arritur majat më të larta të diturisë, ti që je më i pasur se mbretërit dhe më i fortë se ushtarët! Lejomë të të pyes: Çfarë mendimi ke për pasurinë dhe fuqinë time?”

I urti vështroi thellë në sytë e mbretit dhe pa hezitim foli:

“Mbreti im! Mendo sikur gjendesh në mes të një shkretëtire të paanë dhe po vdes nga etja! Nëse do

të të ofroja një gotë ujë, a do më jepje në këmbim gjysmën e pasurisë tënde?”

“Natyrisht që po” - u përgjigj mbreti.

“Tani mendo sikur kaluam edhe një ditë tjetër në mes të shkretëtirës dhe ti përsëri je i pashpresë dhe i etur. Nëse do të të ofroja gotën me ujë, a do ma jepje edhe gjysmën tjetër të pasurisë?”

Mbreti mendoi pak dhe përsëri tha:

“Po do ta jepja, kjo do ishte e vetmja shpresë për të shpëtuar nga vdekja.”

Pas kësaj duke buzëqeshur i urti tha:

“Atëherë nuk ka vend për fjalë të tepërta. Madhëri! Pasuria juaj vlen sa dy gota ujë!”

Pasuria, pushteti, posti, fuqia, fama, paraja... Sa tërheqëse janë për egon e njeriut... Por e vërteta është se për të mos vdekur të gjitha këto vlejné vetëm pak ujë...

Përktheu dhe përshtati: Elona SYTARI





“Ky (Kuran) është një libër i bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (Muhamed), për të përsiatur mbi vargjet e tij dhe për t’u këshilluar me të mendarët..”

(Sad, 29)

TË KUPTOSH KURANIN, NATYRËN DHE HISTORINË

Mendja e shëndoshë nuk është vetëm një kusht për të qenë përgjegjës në aspektin fetar. Mendja duhet përdorur edhe për bërë një jetë me parime islame, prej së cilës do të jetë i kënaqur edhe Allahu. Siç kuptohet edhe nga ajeti që kemi dhënë në hyrje, një nga shkaqet e zbritjes së Kuranit na bëhet e ditur në atë formë.

Kurani, si një thesar i dijes dhe i urtësisë, i fton ata të cilëve u drejtohet të mendojnë mbi të dhe këtë, e përsërit vazhdimisht në raste të ndryshme. Për shembull, në një ajet tjetër, çështja trajtohet në këtë formë: **“Ne e zbritëm këtë Kuran në gjuhën arabe, me qëllim që të kuptoni!”** (Jusuf, 2.)

Meditimi fetar kërkon aktivizimin e të gjitha mënyrave të kuptimit, me qëllim që tek njeriu të sigurohet uniteti mendje-zemër. Kurani e përdor këtë si një metodë, sepse njerëzit që nuk e kanë të gjallë botën e mendimit dhe meditimit, edhe jeta e tyre fetare do të mbetet e dobët. Për rrjedhojë, me qëllim që të fitohen disa vlera dhe sjellje të caktuara, është shumë e rëndësishme që ajetet të bëhen temë e mendimit. Por për fat të keq, nëse sot shohim marrëdhënien e myslimanëve me Kuranin, vëmë re se kjo marrëdhënie nuk ka në qendër të kuptuarit. Në thelb, kjo marrëdhënie nuk bazohet në mendim, por në ndjenja. Pra, nuk ka të bëjë me mendjen, por me adhurimet. Gjithashtu, kjo marrëdhënie synon më tepër fitimin e sevapeve dhe shpërblimeve në botën tjetër, sesa ndërtimin e një personaliteti islam dhe të kësaj bote. Si rezultat i këtij botëkuptimi për të cilin bëhet fjalë, respekti ndaj Kuranit është kthyer prej respektit ndaj urdhrave hyjnore që përmban, në respektin ndaj Librit si objekt fizik dhe në shpresimin e begatisë prej tij.

Nga një anë, Kurani u shenjtërua, por nga ana tjetër u largua nga jeta reale. Sot myslimanët nuk po ndajnë kohën e duhur për të kuptuar këtë fjalë hyjnore. Tashmë, ata duhet t’i ndryshojnë këto

zakone dhe çdo ditë duhet të qëndrojnë për një farë kohe duke medituar mbi të. Përndryshe, urdhrat dhe mësimet e tij në lidhje me besimin, adhurimin, moralin, historinë dhe shoqërinë, do të vazhdojnë të neglizhohen.

Në fakt, a nuk ka qenë kultura e shpalljes burim i frymëzimit për myslimanët e parë dhe qytetërimin Islam? A nuk duhet të jetë edhe sot kështu? Për shkak se shumica e myslimanëve e kanë neglizhuar të kuptuarit e Kuranit, ata nuk i kanë dhënë rëndësi as kuptimit të ajeteve në lidhje me natyrën. Mirëpo, këto ajete na ftojnë të kuptojmë argumentet e krijimit.¹

Qëllimi kryesor i Kuranit në këto ajete, është të ndërtojë përfytyrimin e teuhidit, pra, të konceptit të një Zoti të vetëm. Është e qartë se kjo formon një prapaskenë të rëndësishme në formimin e mendimit të studimit të gjithësisë e për rrjedhojë edhe të zhvillimit të shkencave natyrore. Në Kuran, funksionimi normal dhe i rregullt i natyrës cilësohet si një argument hyjnor. Po në të njëjtën mënyrë, edhe mrekullia që e tejkalon këtë normalitet apo rregullsi, cilësohet si argument hyjnor. Dhe kjo përbën një situatë të çuditshme. Mbase me këtë, kërkohet të na kujtohet fakti se, “Ashtu siç interesoheni për mrekullitë, ashtu duhet të interesoheni edhe për misteret dhe urtësitë e ajeteve të Kurani në lidhje me natyrën, të cilat to t’ju mahnitin. Pra, përse nuk meditonin mbi to?”

Në botëkuptimin e Kuranit, i gjithë krijimi është i mbushur me argumente të panumërta që e thërrasin njeriun tek Zoti i tij. I gjithë krijimi me çdo lloj forme të tij, vërteton dijen e pakufishme të Krijuesit, forcën e Tij të pashoqe dhe fuqinë e Tij të krijimit. Të gjitha krijesat, që prej kafshëve, deri tek bimët, gjallesat mikroskopike etj., janë krijuar

1. shih. Xhathije, 3-6.

me një përsosmëri që e mahnit njeriun. Në këtë pikëpamje, i gjithë krijimi qëndron para njeriut si një libër plot me mistere që presin të kuptohen. Por për fat të keq, shoqëritë myslimane të ditëve tona nuk bëjnë përpjekje të mjaftueshme për të kuptuar natyrën dhe për të deshifruar sistemin dhe mënyrën se si funksionon gjithësia. Përkundër këtyre, atyre u tërheqin më shumë vëmendje tregimet në lidhje me mrekullitë dhe kerametet, duke treguar një interes të jashtëzakonshëm për ndodhitë e jashtëzakonshme.

Me sa po shohim, sot, me studimin e madhështisë së mënyrës së funksionimit të natyrës, po interesohen më tepër perëndimorët me qytetërimin e tyre modern. Ata, mrekullinë (!) po e kërkojnë në zbulimin e mënyrës së funksionimit të gjithësisë dhe në shndërrimin e saj në teknologji. Mirëpo, duhet theksuar se në botëkuptimin perëndimor natyra është një tërësi mundësish prej të cilave njeriu mund të përfitojë vetëm në aspektin material. Ajo nuk ka asnjë kuptim metafizik dhe shpirtëror. Për ta, natyra merr vlerë vetëm kur zbulohen ligjet e saj, të cilat pasi aplikohen në teknologji, i ofrohen përdorimit njerëzor.

Sot njeriu ka arritur në një nivel të jashtëzakonshëm në zbulimin e mistereve të gjithësisë. Mirëpo, gjithë ato dije të akumuluar në fushën e shkencës, nuk shprehin ndonjë gjë të veçantë në lidhje me falënderimin ndaj Krijuesit. Ata nuk po nxjerrin ndonjë mësim prej librit të gjithësisë. Dijet e fituara në lidhje me mrekullitë në krijimin e natyrës dhe të njeriut, nuk po i hapin rrugë një botëkuptimi shpirtëror dhe konceptit të Zotit. Këto evidentime, nuk janë vetëm për botën jomyslimane, por kryesisht vlejnë edhe për shoqëritë islame, sepse në librat e lëndëve të shkencave natyrore që jepen sot në shkollat tona, vazhdon të ndikojë botëkuptimi për të cilin po flasim. Dhe kjo nuk është asgjë tjetër përveçse struktura e një mentalitetit të copëtuar.

Kuptimi i Kuranit, natyrës dhe historisë (shoqërisë), përbëjnë tri pikat kryesore ku mbështetet qytetërimi islam. Për sa kohë që myslimanët nuk i bëjnë këto tri fusha tema të dijes dhe të botëkuptimit, nuk do të jetë e mundur të ndërtojnë një kulturë dhe një qytetërim që do t'i japë shpresë njerëzimit. Kuptimi dhe interpretimi i Kuranit nuk është konsumuar

në të shkuarën dhe nuk do të konsumohet as në të ardhmen. Përkundrazi, myslimanët duhet të kuptojnë dhe ta interpretojnë Kuranin çdo shekull brenda metodave të përcaktuara.

Nga ana tjetër, botëkuptimi i myslimanëve në lidhje me natyrën dhe historinë nuk duhet të bazohet në atë të qytetërimeve të tjera. Prej tyre duhet të përfitojnë, por këto fusha duhet t'i bëjnë vetë personalisht objekt studimi brenda kuadrit të parimeve themelore islame.

Një nga pasojat që ka shkaktuar mostregimi i interesit të duhur të myslimanëve në kuptimin e Kuranit, është edhe fakti se një pjesë e rëndësishme e Kuranit përbëhet nga tregime, ku flitet për ligjet që kanë shkaktuar ngritjen dhe rrënimin e shoqërive të ndryshme. Nisur nga kjo, myslimanët duhet të zhvillojnë doktrina në lidhje me shkencat shoqërore të frymëzuara prej Kuranit. Por për fat të keq, kërkimet në këtë fushë janë ende në gjendje të pamjaftueshme.

Kurani Fisnik pret të kuptohet dhe të studiohet me kujdes të madh në këtë aspekt. Studimet që do të bëhen në këtë fushë, nuk duhet të jenë vetëm teorike, por në të njëjtën kohë, duhet të synojnë edhe zbatimin e tyre në jetën reale. Këtë aludon edhe Allahu në Kuran, kur thotë: **"...Vallë! A nuk kanë udhëtuar ata nëpër botë për të parë se si ka qenë fundi i popujve, që kanë jetuar para tyre?..."** (Jusuf, 109; shih. En'am, 11.)

Çështja që prek ajeti i mësipërm, nuk nënkupton konfirmimin e historisë së popujve të shkuar prej librave të historisë, por duke shkuar vetë personalisht në vendbanimet e tyre të vjetra. Pra, është e domosdoshme të bëhet një interpretim i ri i historisë duke u nisur prej zbulimeve arkeologjike dhe argumenteve konkrete. Mirëpo, është e vështirë të thuhet se myslimanët po bëjnë studimet e nevojshme edhe në këtë fushë, sepse shkenca e arkeologjisë që jepet ende në universitetet tona, bazohet kryesisht në kërkimet e bëra nga të huajt, e për rrjedhojë edhe në gjykimet dhe studimet e tyre.

Si përfundim, për arritjen e një rigjallërimi dhe rindërtimi duhet të pohojmë se kultura e shpalljes, duhet të bëhet burimi i dijes dhe jetës sonë.



Profeti (a.s.), ka thënë:

“Nëse do të mbështeteshit ashtu siç duhet tek Allahu, do të furnizoheshit ashtu siç furnizohen zogjtë të cilët në mëngjes dalin të uritur, e në mbrëmje kthehen të ngopur!”

(Tirmidhi, Birr, 3)

MBËSHTETJA TEK ZOTI... SI ZOGJTË!

Sa i përket zogjve që dalin të uritur nga foletë në agim dhe kthehen të ngopur në mbrëmje... Si çdo mëngjes, edhe këtë herë çdonjëri prej tyre u ngrit në fluturim i uritur... I qetë, me shpresë e me dëshirë... Më pas, pa qëndruar në pritje, përqafoi qiellin me flatrat e tij. Besnik, i përzemërt dhe i singhtë... Fluturuan me kënaqësi mes reve të bardha, vallëzuan me hare duke lëshuar krahët mbi erë dhe shpuan qiellin për të zbritur në thellësitë e tij... Kush i shihte, pandehte se ishin sundimtarë të qiellit, por ata vetëm sa po kalonin përmes qiellit pa kërkuar ta posedojnë atë.

Ajo që i bënte ata të fluturonin dhe të ishin optimistë pa i mbajtur shpresat tek qielli, ishte se ata furnizimin nuk e prisnin prej qiellit, por prej Sunduesit të qiellit... Ndërkohë që ne ecnim, prej qiellit tonë kalonin zogj. Ngritëm kokën dhe ata ishin gjithmonë në lartësi... qielli blu është shtëpia e tyre. Me sa duket, na kaploi dëshira dhe zilia... filluam të vraponim, aq sa mbetëm pa frymë. Mirëpo, nuk e dinim se të vraposh, nuk ishte e njëjtë sikur të fluturosh... E çfarë na pengonte neve të fluturonim me dy krahë, kur ata fluturonin me dy flatra? Po, edhe neve duhet të kishim flatra... jo vetëm dy, por tre, katër, pesë, e madje edhe më shumë... Duhej të bënim llogari e plane për të garantuar edhe çështjen e fluturimit si çdo gjë tjetër! U llogaritën të gjitha mundësitë deri në detajet më të imta, u bënë statistikë dhe u eliminuan të gjitha rreziqet.

Çdo gjë ishte në rregull, por nuk u bë!.. Nuk arritëm ta shijonim dot atë kënaqësi. Flatra kemi, apo jo? Po, dhe me tepricë! Mirë, por pse nuk mund të fluturojmë? Sepse flatrat e shpirtit tonë janë të thyera! Po çfarë është ajo që e bën me flatra shpirtin tonë? Mbështetja tek Zoti! Këtë e thoshte Profeti që njihje qiejt dhe sillte lajme prej andej. Ai na ka bërë të ditur se ne mund të rrihnim flatrat së

bashku me zogjtë e të ndiheshim të lirë si ata duke u mbështetur tek Allahu... E nëse do të ndiqnim gjurmët e zogjve, këmbët tona do të lëshonin tokën. Ai na tregon se për të shpëtuar prej peshave që na tërheqin drejt tokës dhe të ngrihemi lart, na duhet të mësojmë shumë prej zogjve. Prandaj ai na jep shembull zogjtë dhe thotë: “Nëse do të mbështeteshit ashtu siç duhet tek Allahu, do të furnizoheshit ashtu siç furnizohen zogjtë të cilët në mëngjes dalin të uritur, e në mbrëmje kthehen të ngopur!” (Tirmidhi, Zuhd, 33.)

Zogjve mund t’u ngajjnë vetëm ata që mbështeten plotësisht tek Allahu... Dhe këtë mund ta bëjnë vetëm ata që kanë hall qiellin dhe dëshirojnë të fluturojnë... Të mbështetesh tek Allahu nuk do të thotë të rrih në vend, por të fluturosh. Kjo është vepër e atyre që i kanë sytë në lartësitë qiellore. Vepër e atyre që kanë ëndrra, ideale dhe synime të mëdha dhe mbështeten tek “Ekberi”, tek më i Larti...

Ai që furnizon milingonat, peshqit, e zogjtë, Ai na furnizon edhe ne. Për këtë duhet të jemi të vetëdijshëm, sepse shpirtat që nuk kanë besuar, nuk janë mbështetur dhe nuk janë përkushtuar, nuk mund ta ndjejnë këtë kënaqësi... Ata që përfetojnë mjerimin e mosbesimit dhe ata që mbështetjen tek Allahu e konsiderojnë dembelizëm, nuk mund ta dinë se si mbështetja në Allahun e vë në lëvizje njeriun me gjithë qenien e vet... Vetëm ata që i hapin duart drejt qiellit mund ta shijojnë mbështetjen tek Allahu... Ata që ndoqën të dërguarit që sillnin lajme prej qiellit e dinë shijen e saj... Vetëm ata që njohin Sunduesin e vetëm të shtatë qiejve mund të ngrihen deri tek mbështetja në Allahun. Prandaj, mbështetja tek Allahu është vepër e njerëzve të qiellit, jo të “esfel-i safilin”-ëve (më të ulët të të ulëtëve)...

Ata që nuk arrijnë t’i shkëpusin këmbët prej tokës,



si mund ta dinë çdo të thotë të fluturosh? Ata që janë lidhur në tokë me njëmijë e një lloj prangash, si mund të lëvizin? Ata që merren me lloj-lloj hallësh të tokës, si mund të marrin hise prej qiejve? E si mund t'i lejojë ata egoizmi i vet, lakmitë dhe luftërat e pambarim t'i besojnë një qenieje tjetër përveç vetes së tyre? Nuk i lejon! Në këtë situatë, për ta, edhe dita, edhe nata është një... Njeriu bëhet peng i dyshimeve dhe frikës. Ai harron se çdo gjë e ka një Sundues dhe përpiqet vazhdimisht të sundojë gjithçka. Qetësia e braktis atë qetësisht dhe zhurmat plaçkitin brendësinë e tij. Ndërsa pyetjeve pa përgjigje nuk u vjen fundi.

Shqetësimi i furnizimit, ankthi i jetesës dhe angazhimi me këtë botë nuk e lënë asnjëherë rehat. Dyshimet, ankthet, pritshmëritë, probabilitet, vallë-t, sikur-et, mbase-t nuk kanë fund për të. Ai humbet në vorbullën e skenarëve të fatkeqësive...

Pa besuar Atë, nuk mund të arrijë paqen zemra e njeriut. Pa u mbështetur tek Ai, nuk mund ta dijë ç'është qetësia. Pa i zënë besë Atij, nuk mund ta ndjejë veten të sigurt. Kemi nevojë të zëmë besë, të besojmë e të strehohemi, sepse jemi të dobët. Jeta jonë, vdekja jonë, madje edhe furnizimi i ynë është në dorën e Tij. Kur i besojmë kësaj dhe mbasemi tek Ai, atëherë mund të shijojmë ëmbëlsinë e mbështetjes tek Ai. Atëherë mund të shpëtojmë prej hamallëkut të peshave të panevojshme, e të lehtësohemi. Prej peshave që kërrusin belin tonë dhe prej tepricave që nuk jemi të detyruar të bartim, mund të shpëtojmë vetëm atëherë kur punët tona t'ia besojmë Atij. Ne nuk mund të jemi sundimtarët e gjithçkaje, nuk mund të mbajmë gjithçka nën kontroll, nuk mund t'i llogaritim të gjitha mundësitë dhe nuk mund të harrojmë dobësinë dhe të qenit njeri, e të hymë në rolin e Zotit. Jemi të detyruar të

kuptojmë se peshoret nuk peshojnë vetëm materien, llogaria nuk mund t'i lihet vetëm numrave dhe ajo nuk mund të bëhet vetëm me matematikë.

Ne përpiqemi ta nxjerrim qiellin nga bota jonë dhe synojmë të ndërtojmë një botë për veten tonë vetëm në tokë. Dhe, as që jemi të vetëdijshëm se po e burgosim veten në tokë, ndërkohë që sipër kemi qiejt pakufi. Madje as që e ngremë kokën të shohim zogjtë që fluturojnë në paqe. Fakti që nuk ngopemi, nuk dimë të ngopemi dhe nuk jemi të kënaqur me atë që meritojmë, na ndan prej zogjve dhe nuk mund të fluturojmë. Ne nuk arrijmë të shpëtojmë prej ngushtësisë së shpirtit pavarësisht gjithçkaje që kemi. Nuk arrijmë ta kuptojmë se boshllëkun brenda vetes nuk mund ta mbushim me materialen.

Por, a ka më të qetë se ai që thotë: **"...Më mjafton Allahu, s'ka zot tjetër përveç Tij. Unë mbështetem tek Ai që është Zot i Fronit të Madh!"** (Teube, 129.) E çfarë tjetër mund ta bëjë njeriun të përjetojë lehtësinë që i jep ajeti: **"...Allahu i mjafton kujtdo që mbështetet tek Ai!..."** (Talak, 3.)? E çfarë mund ta pengojë njeriun nga ngritja pasi të ketë thënë: **"Allahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë!..."** (Nisa, 132.) dhe **"O Allah, Zotëruesi i gjithë Pushtetit! Ti ia jep pushtetin kujt të duash dhe ia heq kujt të duash; Ti lartëson kë të duash dhe poshtëron kë të duash. Çdo e mirë është në Dorën Tënde!"** (Al-i Imran, 26.)? Mjafton që ai të ngrejë kokën e të shohë zogjtë. Një harabel i vogël, një pëllumb, ose një pupëz mund t'i tregojë rrugën...

Profeti ynë (a.s.), na dha shembull zogjtë, por a ka ndonjë prej nesh që mund t'u bëhet shembull zogjve?..



UDHËTIMI I PËRJETËSISË

- P J E S A X -

VEPRAT QË DUHEN BËRË PAS VDEKJES SË DIKUJT

Siç theksohet hapur edhe në Kuranin Fisnik, besimtarët janë vëllezër.¹ Dhe një prej detyrave më të rëndësishme që kjo vëllazëri i ka ngarkuar besimtarëve, është kryerja e detyrës së fundit ndaj vëllezërve të fesë që ndërrojnë jetë. Pra, larja, qefinosja dhe varrosja e tyre me etikë dhe kujdes të madh, ashtu siç i ka hije dinjitetit të njeriut, krijesës që Allahu i Madhëruar e ka krijuar në formën më të bukur (ahseni takuim) dhe e ka bërë më të nderuarën ndër të gjitha krijesat.

Lidhur me këtë çështje, i Dërguari i Allahut, (a.s.), na bën të ditur disa të drejta që myslimanët kanë ndaj njëri-tjetrit:

“Të drejtat e myslimanit ndaj myslimanit, janë pesë:

T’i përgjigjet selamit, të vizitojë të sëmurin, të përcjellë xhenazen nga pas (duke i falur namazin e xhenazes dhe duke u marrë me çështjet e varrimit), t’i përgjigjet ftesës dhe atij që psherëtin t’i thotë: «Allahu të mëshiroftë!»” (Buhari, Xhenaiz, 2; Muslim, Selam, 4.)

“Të drejtat e myslimanit ndaj myslimanit, janë gjashtë:

T’i japë selam kur të takohet me të, t’i përgjigjet ftesës nëse ftohet, ta këshillojë nëse kërkohet këshilla e tij, nëse vëllai psherëtin dhe falënderon Allahun (thotë elhamdulillah), t’i thotë “jerhamukellah”, ta vizitojë nëse sëmuret dhe t’i përcjellë xhenazen kur të ndërrojë jetë.” (Muslim, Selam, 5.)

1. PËRGATITJA, QEFINOSJA DHE PËRCJELLJA

Falja e namazit të xhenazes së një vëllai mysliman që ka ndërruar jetë dhe varrosja e tij në varr, është farz kifaje,² ndërsa shërbimet e tjera ndaj tij janë sunnet ose mustehab (të pëlqyeshme). Por nëse këto detyra neglizhohen, të gjithë myslimanët që jetojnë në atë zonë, konsiderohen se kanë braktisur farzin (obligimin) dhe marrin gjynah.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i ka dhënë rëndësi të madhe përgatitjes së xhenazes. Ai ka kërkuar prej atyre që merren me punët e xhenazes, që ta lajnë mirë, ta parfumosin dhe ta qefinosin ashtu siç duhet. Për të theksuar më tepër rëndësinë e kësaj detyre, Profeti (a.s.) ka thënë:

“Allahu i Madhëruar e fal dyzet herë personin, i cili e lan një të vdekur dhe i fsheh gjërat e papëlqyeshme që sheh tek ai. Atij që qefinos të vdekurit, i vesh rroba të Xhenetit të punuara me mëndafsh. Ndërsa atij që hap varrin dhe varros të vdekurin, i jep shpërblim sikur të kishte akomoduar një të varfër në një shtëpi ku do të qëndrojë deri në ditën e Kiametit.” (Hakim, I, 506/1307.)

Një çështje tjetër mbi të cilën duhet bërë kujdes gjatë qefinosjes së xhenazes, është që të mos bëhet asnjë veprim ndaj të cilit i vdekuri do të mërziej po të ishte gjallë. Për shembull, të mos e lash xhenazen me ujë shumë të ftohtë ose shumë të nxehtë. Përveç kësaj, është mirë që gjatë përgatitjes dhe qefinosjes së të vdekurit, të mos shpenzohet tepër por edhe të mos tregohet koprraci.

Xhabiri (r.a.), tregon:

2. **-Farz kifaje:** Obligim fetar, i cili nëse kryhet nga një ose më shumë persona, shpëtojnë nga përgjegjësia të gjithë myslimanët e tjerë.

1. shih. Huxhurat, 10.



“Një ditë i Dërguari i Allahut, (a.s.), mbajti një hutbe në lidhje me njërin prej sahabëve, i cili kishte vdekur dhe ishte varrosur natën i mbështjellë me një qefin të pamjaftueshëm. Më pas, me qëllim që atij t’i falej namazi i xhenazes, ai e ndaloi varrosjen e të vdekurit natën pa qenë nevoja. Pastaj tha: «*Kur dikush prej jush qefinosë vëllain e vet, le ta qefinosë sa më mirë!*»” (Muslim, Xhenaiz, 49; Ebu Daud, Xhenaiz, 29-30/3148; Nesai, Xhenaiz, 37.)

Gjithashtu, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“*Vishuni me rroba të bardha, sepse rroba e bardhë duket më e pastër dhe më e bukur! Po ashtu edhe të vdekurit tuaj qefinosini me të bardha!*” (Tirmidhi, Edeb, 46/2810.)

Përveç këtyre i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka këshilluar që xhenazja të mos pritët shumë gjatë, por të varroset sa më parë:

“*Xhenazen barteni me shpejtësi! Nëse ai është njeri i mirë, kjo është mirësi për të, sepse do të mundësoni që ai të takohet sa më shpejt me të mirat dhe shpërblimet e tij në varr. Por nëse nuk është njeri i mirë, kjo do të jetë një tjetër e keqe për të, sepse do ta hidhni shumë shpejt prej supeve tuaja!*” (Buhari, Xhenaiz, 51; Muslim, Xhenaiz, 50, 51.)

Me gjithë porosinë e Profetit tonë (a.s.) në lidhje me këtë çështje, vihet re se në disa vende xhenazja pritët më tepër se ç’duhet me qëllim që njerëzit të arrijnë në namazin e xhenazes. E në fakt, e rëndësishme është që i vdekuri të mos presë shumë, por të varroset menjëherë, sepse siç thamë edhe më sipër namazi i xhenazes është farz kifaje. Xhemati që është i pranishëm mund ta fali xhenazen. Ndërsa ata që nuk e arrijnë dot, mund ta falin përsëri më vonë nëse dëshirojnë.³ Përveç kësaj, ata që

nuk kanë mundur të jenë prezent, mund të falin namazin e xhenazes në mungesë, në vendin ku ndodhen vetë.

Mirëpo nëse është e nevojshme që xhenazja të pritët për shkak të procesit të autopsisë apo diçka tjetër të ngjashme me këtë, atëherë mund të vendoset në morg. Por vendosja në morg pa qenë e nevojshme, konsiderohet si torturë për xhenazen.

Është e lejuar vendosja e një guri tek koka e varrit, me qëllim të njohjes së varrit. Muttalib ibn Ebi Uedaa tregon:

“Kur ndërroi jetë Osman ibn Madh’uni (r.a.), xhenazja e tij u varros jashtë Medinës. Osmani (r.a.), ishte prej muhaxhirëve të parë që ndërruan jetë. I Dërguari i Allahut, (a.s.), urdhëroi një person që të sillt një gur. Ai gjeti një gur, por nuk mundi ta ngrejë. Për këtë arsye, Profeti (a.s.) përveshi mëngët dhe shkoi ta barte vetë.”

Transmetuesi thotë:

“Më duket sikur e kam para syve bardhësinë e krahëve të Profetit (a.s.), kur ai përveshi mëngët. Më pas ai e solli gurin, e vendosi tek koka e Osmanit (r.a.) dhe tha:

«*Kështu mund ta njoh dhe ta gjej varrin e vëllait tim. Kështu që edhe ata që do të vdesin prej familjes sime do t’i vendos pranë tij.*»” (Ebu Daud, Xhenaiz, 57-59/3206. Shih. Ibn-i Maxhe, Xhenaiz, 42.)

Gjatë udhëtimit për në Mekë (për umren e Hudejbijes), i Dërguari i Allahut, (a.s.), u kthye në Ebua dhe tha:

“*Padyshim që Allahu i Madhëruar e lejoi Muhammedin të vizitojë varrin e nënës së tij!*”

Shkoi tek varri, e rregulloi dhe qau pranë tij. Për shkak të lotëve të Profetit, qanë edhe myslimanët e tjerë. Më vonë, kur u pyet se pse veproi në atë mënyrë, ai tha:

“*Mu kujtua dhembshuria dhe mëshira e nënës ndaj meje, prandaj qava.*” (Ibn-i Sa’d, I, 116-117. Shih. Muslim, Xhenaiz, 105-108.)



“*Xhenazen barteni me shpejtësi! Nëse ai është njeri i mirë, kjo është mirësi për të, sepse do të mundësoni që ai të takohet sa më shpejt me të mirat dhe shpërblimet e tij në varr. Por nëse nuk është njeri i mirë, kjo do të jetë një tjetër e keqe për të, sepse do ta hidhni shumë shpejt prej supeve tuaja!*” (Buhari, Xhenaiz, 51; Muslim, Xhenaiz, 50, 51.)

3. Sipas Hanefive dhe Malikive, falja e namazit të xhenazes për herë të dytë, është mekruh (e papëlqyeshme). Ndërsa sipas Shafiive dhe Hanbelive, ata që nuk e arrijnë xhenazen, mund ta falin namazin e xhenazes qoftë edhe pasi i vdekuri të jetë varrosur. Madje sipas Shafiive kjo është sunnet.

Rregullimi i varrit vjen si domosdoshmëri e etikës dhe punës së përsosur që ka urdhëruar Islami. Kur u mbulua varri i djalit të tij Ibrahimit, i Dërguari i Allahut, (a.s.), vuri re se vendi pranë varrit nuk ishte aspak i rregullt. Ndërkohë që po rregullonte vendin me duart e tij të bekuara, tha:

“Kur dikush prej jush të bëjë një punë, le ta bëjë mirë, sepse kështu ngushëlloni zemrën e atyre që i ka goditur dhimbja!” (Ibn-i Sa’d, Tabakat, I, 141-142.)

Sipas një transmetimi tjetër, kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), po qëndronte në anë të varrit të djalit të tij Ibrahimit, pa një të çarë tek pllakat e varrit. Ai i dha pak baltë atij që kishte hapur varrin, me qëllim që ta rregullonte dhe tha:

“Kjo nuk ka as dëm e as dobi për të vdekurin. Mirëpo kjo (varri i rregullt) ia ndriçon sytë të gjallit, e gëzon dhe e kënaq atë!” (Ibn-i Sa’d, Tabakat, I, 142, 143; Belazuri, Ensabu’l-Eshraf, I, 451.)

Po ashtu, nuk ka asnjë problem edhe nëse varri spërkatet me ujë për të forcuar dheun. Kur u varros djali i tij Ibrahimit, i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

“A mund të më sjellë dikush një kacek me ujë?” Menjëherë, njëri prej ensarëve solli një kacek me ujë dhe i Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha:

“Spërkate varrin e Ibrahimit me të!” (Ibn-i Sa’d, Tabakat, I, 141.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), urdhëroi të sillej një gur, i cili u vendos tek koka e varrit të Ibrahimit.⁴ Po ashtu, ai qe i pari që iu spërkat ujë mbi varr.⁵

Edhe mbjellja e pemëve, në një vend të përshtatshëm të varrit dhe gjelbërimi përreth tij, është konsideruar diçka e preferuar. Siç bëhet e ditur edhe në një hadith fisnik, kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), po kalonte pranë dy varreve, ai tha se të vdekurit në ato varre po vuanin. E më pas, ai kërkoi një degë të njomë hurme, të cilën e ndau në dy pjesë dhe secilën prej tyre e nguli në krye të varrit. Pas kësaj tha:

“Shpresohet t’u lehtësohet ndëshkimi derisa sa të thahen!” (Muslim, Taharet, 111)

Imam Kurtubiu, i cili ka qenë dijetar i tefsirit, hadithit dhe i jurispruencës Islame, në shpjegimin e këtij hadithi fisnik shpreh:

4. Ibn-i Sa’d, Tabakat, I, 144; Belazuri, Ensabu’l-Eshraf, I, 451.

5. Ibn-i Abdiberr, Istab, I, 59; Ibn-i Esir, Usdu’l-Gabe, I, 51; Kastalani, Meuahibu’l-Ledunnijje, I, 269.

“Shprehja “derisa të mos thahen” tregon se sa të jenë të njoma, degët do të bëjnë tesbih e do të përmendin Zotin duke e madhëruar. Dijetarët tanë kanë thënë: «Të vdekurit përfitojnë nga mbjellja e pemëve në varre dhe nga leximi i Kuranit atje. Po qe se edhe mbjellja e një peme ua lehtëson mundimin të vdekurve, kush e di se sa përfiton besimtari nga këndimi i Kuranit! Tek i vdekuri arrin edhe mirësia (sevabi) e çdo gjëje që dhurohet për të vdekurin.»” (Kurtubi, Tefsir, X, 267).

Ulja dhe shkelja mbi varre është mekruh (e papëlqyeshme). Lidhur me këtë çështje, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Është më mirë të uleni mbi prush, t’ju digjet rroba dhe prej saj t’ju arrijë trupin, sesa të uleni mbi një varr.” (Muslim, Xhenaiz, 96; Ebu Daud, Xhenaiz, 77; Nesai, Xhenaiz, 105.)

Xhabiri (r.a.) transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), e ka ndaluar lyerjen e varreve me gëlqere, uljen dhe ndërtimin e binave mbi ta.⁶

Në lidhje me “fjalimin” që mbahet pas varrosjes së të vdekurit, ka pasur mendime të ndryshme. Ka prej atyre që thonë se një gjë e tillë është e dobishme.

Këshilla e të Dërguarit të Allahut, (a.s.): *“Lexoni JaSin për të vdekurit tuaj!”*⁷, kuptohet që të vdekurit duhet t’i lexohet shpesh surja JaSin, si para vdekjes, ashtu edhe pas saj.

2. PAGIMI I BORXHEVE

Myslimani jeton gjithmonë me ndjenjën e mirësi-së, duke qenë i vetëdijshëm se ndodhet vazhdimisht nën vëzhgimin e kamerave hyjnore dhe ka frikë të dalë borxhli përpara Allahut të Madhëruar.


Nëse dikush ndërron jetë pa paguar borxhet, të afërmit duhet të mbyllin të gjitha borxhet që ai ka lënë, përpara se të çojnë në vend amanetet e tij dhe të ndajnë trashëgiminë. Në hadithet fisnike, na bëhet e ditur se as shehidi nuk do të hyjë në Xhenet pa i paguar borxhet.⁸

Më konkretisht, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

6. shih. Muslim, Xhenaiz, 94; Ebu Daud, Xhenaiz, 76; Tirmidhi, Xh - naiz, 58.

7. Ebu Daud, Xhenaiz, 19-20; Ahmed ibn-i Hanbel, Musned, V, 26, 27; Ibn-i Hibban, Sahih, V, 3.

8. shih. Muslim, Imare, 119, 120; Nesai, Buju, 98; Ahmed, V, 289.



“Shpirti i besimtarit mbetet i lidhur pas borxhit të vet derisa ta shlyejë.” (Tirmidhi, Xhenaiz, 74, shih. Ibn-i Maxhe, Sadakat, 12.)

Kjo do të thotë se borxhi është burg, i cili e pengon robin të ngrihet në pozita të larta. Përveç kësaj, për borxhliun nuk mund të jepet as gjykimi nëse do të shpëtojë apo do të shkatërrohet. E për këtë arsye ai vazhdon pritjen i shqetësuar.

Ebu Hurejre (r.a.), transmeton:

“Kur të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i sillej një xhenaze me borxhe të palara, ai pyeste:

«A ka lënë ndonjë pasuri për të paguar borxhin?»

Nëse i thuhej se ka lënë pasuri të mjaftueshme për të paguar borxhin (ose nëse dikush nga myslimanët jepte garanci të fortë se do t’ia shlyente

“Është më mirë të uleni mbi prush, t’ju digjet rroba dhe prej saj t’ju arrijë trupin, sesa të uleni mbi një varr.”

(Muslim, Xhenaiz, 96; Ebu Daud, Xhenaiz, 77; Nesai, Xhenaiz, 105.)

borxhin⁹), ai ia falte namazin. Në të kundërt, u thoshte myslimanëve:

«Faljani ju namazin (e xhenazes) shokut tuaj!»

Mirëpo me kalimin e kohës, kur Allahu i Madhëruar ia zgjeroi mundësitë materiale Profetit tonë (a.s.), ai ia ka falur namazin e xhenazes edhe besimtarëve që nuk kanë pasur pasuri për të paguar borxhin (duke ia paguar vet).¹⁰ Pas kësaj, ai thoshte:

“Unë jam njeriu më i afërt për çdo besimtar, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër. Në qoftë se dëshironi, mund të lexoni këtë ajet: «I Dërguari është më i afërt për besimtarët, sesa ata për njëritjetrin.» (Ahzab, 6)

“Çdo pasuri të lënë pas nga ndonjë besimtar që vdes, le ta marrin trashëgimtarët e tij. Në qoftë se ka lënë pas ndonjë borxh apo njeri që ka nevojë për kujdes, le të vijë tek unë, sepse unë do të bëhem kujdestari i tyre.” (Buhari, Tefsir, 33/1, Kefalet 5, Feraidh, 4, 15, 25, Muslim, Feraidh, 14.)

Sa’d ibn Atual (r.a.) tregon:

“Vëllai im ndërroi jetë dhe la treqind dërrhem dhe familjen që kishte nevojë për përkujdesje. Paratë që la, doja t’i shpenzoja për familjen e tij, por i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

«Vëllai yt gjendet i burgosur për shkak të borxhit, prandaj paguaj borxhin!» Thashë:

«O i Dërguari i Allahut! Unë i lava borxhet e tij. Kanë mbetur vetëm dy dinarë tek një grua që pretendonte (se i kishte dhënë borxh) por që nuk solli asnjë provë.»

I Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:


«Jepja asaj gruas dy dinarët që ka pretenduar, sepse ajo po thotë të vërtetën!» (Ibn-i Maxhe, Sadakat, 2.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), në një hadith fisnik, i ka porositur besimtarët që në ditën e Kiametit të mos dalin me borxhe:

“Kush i ka bërë vëllait të fesë ndonjë padrejtësi në nder apo në pasuri, të hallallohet me përpara se të vijë dita e Kiametit, ku nuk do të ketë flori dhe

9. shih. Tirmidhi, Xhenaiz, 69/1069; Nesai, Xhenaiz, 67.

10. shih. Buhari, Nefekat, 15; Muslim, Feraidh, 14.



argjend. Në të kundërt, nëse ka vepra të mira, do t'i merren prej sevapeve të tij aq sa ka bërë padrejtësi (dhe do i jepen atij që i është bërë padrejtësia). Por nëse nuk ka vepra të mira, do të merren prej gjynaheve të vëllait që i ka bërë padrejtësi dhe do t'i ngarkohen atij.” (Buhari, Medhalim, 10, Rikak, 48.)

3. RESPEKTIMI I TESTAMENTIT

Pas përgatitjes, qefinosjes dhe larjes së borxheve, çohet në vend testamenti i të vdekurit për “një të tretën” e pasurisë së mbetur. Ndërsa dy të tretat ndahen ndër trashëgimtarët.

Lidhur me këtë çështje, një prej sahabëve të përgëzuar me Xhenet, Sa'd ibn Ebi Uakkas (r.a.) transmeton:

“Në vitin e Haxhit të Lamtumirës (në Mekë) më zuri një sëmundje e rëndë. Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.) më erdhi për vizitë, e pyeta:

«O i Dërguar i Allahut! Siç e sheh jam shumë i sëmurë. Unë jam njeri i pasur dhe nuk kam trashëgues tjetër përveç një vajze. A ta ndaj si sadaka dy të tretën e pasurisë sime?»

«Jo!» - tha Profeti (a.s.).

«Të ndaj gjysmën?» - thashë unë.

«Jo!» - tha ai përsëri.

«Si thua për një të tretën o i Dërguar i Allahut?» - pyeta unë.

«Ndaj një të tretën! Madje edhe ajo është shumë! Është më mirë t'i lësh trashëgimtarët e tu të pasur, sesa nevojtarë që t'u shtrijnë dorën të tjerëve. Për çdo shpenzim që bën duke menduar (synuar) kënaqësinë e Allahut, do të marrësh shpërblim. Madje edhe për kafshatat që vendos në gojën e gruas gjatë ushqimit.»

Sa'd ibn Ebi Uakkas vazhdoi:

«O i Dërguari i Allahut! A do të mbetem (vdes) këtu e shokët e mi do të ikin?» - pyeta unë. Por i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

«Jo, ti nuk do të mbetesh këtu! Ti do të ngrihesh dhe do të bësh gjëra të mira për Allahun. Shpresoj prej Allahut që duke jetuar shumë, disa (besimtarët) të kenë dobi prej teje, e disa të tjerë (mohuesit) të dëmtohen.

O Allah! Plotësoje hixhretin (emigrimin) e shokëve të mi (nga Meka në Medinë)! Mos i kthe ata pas, e mos ja lër në gjysmë hixhretin! Sa'd ibn-i Haule, është në gjendje të keqe!»

Me këto fjalë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka shprehur keqardhjen e tij për Sa'd ibn Haulen, që vdiq në Mekë.” (Buhari, Xhenaiz, 36, Uesaja, 2, Nefekati, 1, Merda 16, Deauat, 43, Feraidh, 6; Muslim, Uasijjet, 5.)

4. LUTJET DHE KËRKIMI I FALJES

Lutja e parë për një mysliman që ndërron jetë është falja e namazit të xhenazes. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Cilitdo mysliman, që nuk i ka bërë shirk Allahut, dhe që i shkojnë dyzetë persona e i falin namazin, Allahu patjetër do ta pranojë shefaatin (ndërmjetësimin në ditën e gjykimit) e tyre për personin e vdekur.” (Muslim, Xhenaiz, 59.)

Numri “dyzetë” në këtë hadith është cekur për të shprehur një grup të madh njerëzish, sepse në një hadith tjetër ky numër është “njëqind”¹¹, në një transmetim tjetër thuhet se mjafton të jetë një xhemat me tre safa/rreshta¹². Madje, Malik ibn Hubejbe (r.a.), që përcjell transmetimin e fundit, kur shihte një xhenaze me pak njerëz, menjëherë i vendoste ata në tre safa në përputhje me hadithin që kishte dëgjuar.

Për të vdekurin është një arritje e madhe kur ai gëzon dëshminë pozitive të myslimanëve. Lidhur me këtë, Enesi (r.a.), tregon:

“Kur Profeti (a.s.) po rrinte me disa sahabë, pranë kaloi një xhenaze. Disa nga sahabët e përmendën të vdekurin për mirë dhe Profeti (a.s.) tha:

«U vendos!»

Pastaj kaloi një xhenaze tjetër, të cilin të pranishmit e përmendën për keq. Ndërsa Profeti (a.s.) përsëri tha:

«U vendos!»

Pas kësaj, Omer ibn Hattabi (r.a.) pyeti:

«O i Dërguari i Allahut, çfarë u vendos?»

Profeti (a.s.) u përgjigj:

«Të vdekurin e parë e përmendët për të mirë, prandaj u vendos që ai të shkojë në Xhenet. Pastaj të vdekurin tjetër e përmendët për të keq, prandaj u vendos që ai të shkojë në Xhehenem. Kjo, sepse ju besimtarët, jeni dëshmitarët e Allahut mbi tokë!» (Buhari, Xhenaiz, 86; Muslim, Xhenaiz, 60.)

Pjesëmarrja në xhenazen e vëllait të fesë, duke i falur namazin dhe duke e përcjellë atë deri në varr, i sjellë shpërblime të mëdha besimtarit. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Kushdo që shkon në xhenazen e një myslimani dhe pret gjersa t'i falet namazi e të varroset, duke besuar në shpërblimin e kësaj vepre dhe duke e pritur atë vetëm nga Allahu, kthehet me dy sasi sevapesh, secila prej tyre sa mali i Uhudit. Kurse ai që merr pjesë në faljen e namazit të të vdekurit dhe largohet pa pritur varrosjen e tij, kthehet me një sasi sevapesh!” (Buhari, Iman, 35)

11. shih. Muslim, Xhenaiz, 58.

12. shih. Ebu Daud, Xhenaiz, 39/3166; Tirmidhi, Xhenaiz, 40.

Një ditë, kur Abdullah ibn Omeri po rrinte së bashku me Sa'd ibn Ebi Uakkas-in, vjen Habbab ibn Eret dhe u thotë:

“O Abdullah! Pa shih se ç’thotë Ebu Hurejre!” Dhe përmend hadithin e mësipërm. Atëherë Ibni Omeri dërgoi Habbabin tek Aisheja (r.anha) për të hetuar mbi këtë hadith, duke i thënë: “Pyete atë dhe kthehu!”.

Pasi u largua Habbabi, Ibni Omeri mori një grusht guralecë dhe filloi t’i vërtisë nëpër duar i nxehur. Kur u kthye Habbabi me lajmin e Aishes (r.a.), e cila kishte thënë se Ebu Hurejre thotë të vërtetën, i hodhi tutje gurët që mbante në duar dhe shprehu hidhërimin e vet me këto fjalë:

“Pse s’thua se ne paskemi humbur shumë sasi sevapesh?” (Muslim, Xhenaiz, 56)

Sasia e sevapeve që premtohen këtu, Allahu e di më mirë, më tepër se përcaktimi i një kufiri, duhet të jetë përmendur për të theksuar vlerën e përcjelljes së xhenazes, sepse Allahu i Madhëruar veprat i shpërblen në bazë të nivelit të qëllimit dhe sinqeritetit të zemrës.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili shprehet: “kur të falni namazin e xhenazes, lutuni me sinqeritet për të vdekurin”¹³, ka qenë shembulli më i mirë për ummetin e tij në këtë çështje. Ja disa shembuj të lutjeve që ai ka bërë me rastin e xhenazeve:

“Allahu im! Fale atë, mëshiroje, shpëtoje nga mundimet dhe shqetësimet! Fali të metat dhe gabimet! Fali pjesë nga Xheneti dhe bëja të gjerë vendin (varrin) ku do të hyjë! Laje atë me ujë, dëborë dhe akull! Pastroje atë nga mëkatet siç pastrohen rrobat e bardha nga papastërtitë!.. Vendose atë në Xhenet dhe mbroje nga dënimi i varrit dhe i Xhehenemit!” (Muslim, Xhenaiz, 85)

Ebu Hurejre (r.a.) transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), është lutur kështu në namazet e xhenazes:

“O Allah! Fali të gjallët dhe të vdekurit tanë, të vegjlit dhe të mëdhenjtë tanë, burrat dhe gratë tona, ata prej nesh që janë prezent dhe ata që nuk janë prezent këtu!

O Allah! Bëji të jetojnë në Islam ata që do t’i lejojnë të jetojnë, e merrua jetën me besim, atyre që do t’i bësh të vdesin!

Mos na privo nga sevapet e pjesëmarrjes në këtë xhenaze dhe mos na fut në sprovë pas saj!” (Tirmidhi, Xhenaiz, 38.)

“O Allah! Ti Je Zoti i kësaj xhenazeje (i të vdekurit), Ti e krijove atë dhe Ti e udhëzove në Islam. E tani, Ti e more edhe shpirtin e tij. Ti ia di më mirë çka ka bërë fshehtas dhe haptazi. Ndërsa ne po të drejtohem Ty si ndërmjetës për të, prandaj fale atë!” (Ebu Daud, Xhenaiz, 56.)

Ibn-i Abbasi (r.a.), tregon:

“Një natë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), shkoi tek një varr. Atij iu ndez një kandil. Pasi e ktheu nga kibla xhenazen e shtrirë, iu drejtua duke u lutur me këto fjalë:

«Padyshim se ti ishte një njeri që luteshe dhe lexoje shumë Kuran. Allahu të mëshiroftë!» Më pas bëri katër tekbir (Allahu Ekber).” (Tirmidhi, Xhenaiz, 62/1057.)

Po ashtu edhe Allahu i Madhëruar na bën të ditur se besimtarët lutën kështu për paraardhësit e tyre:

“...«O Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve! O Zoti ynë, Ti je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë!»” (Hashr, 10.)

Një nga gjërat më të rëndësishme që të vdekurit presin prej të gjallëve është lutja për faljen e tyre. Njëherë, kur u varros një xhenaze, i Dërguari i Allahut, (a.s.), i këshilloi myslimanët të kërkonin falje për të vdekurin, me shpresën që llogaria e tij në varr të kalonte lehtë.

Po ashtu, i Dërguari i Allahut, (a.s.), i vizitonte shpesh shokët e tij në varrezën Baki dhe dëshmorët e Uhudit. Siç shprehet edhe nëna jonë Aishe (r.anha): “Profeti (a.s.), në pjesën e fundit të çdo nate që ka qëndruar tek unë, shkonte tek varrezat Baki, i përshëndeste me selam (banorët e varreve) dhe lutej për ta”.¹⁴

Një natë Xhibrili (a.s.) i kishte ardhur të Dërguarit të Allahut, (a.s.), dhe i kishte thënë:

“Cilitdo mysliman, që nuk i ka bërë shirk Allahut, dhe që i shkojnë dyzetë persona e i falin namazin, Allahu patjetër do ta pranojë shefaatin (ndërmjetësimin në ditën e gjykimit) e tyre për personin e vdekur.”

(Muslim, Xhenaiz, 59.)



13. shih. Ebu Daud, Xhenaiz, 54-56/3199.

14. shih. Muslim, Xhenaiz, 102.

“Zoti yt ka urdhëruar të shkosh tek banorët në Baki e të lutesh për faljen e tyre!” I Dërguari i Allahut, (a.s.), e zbatoi menjëherë këtë urdhër dhe shkoi për vizitë tek varrezat Xhenetu'l-Baki. (shih. Muslim, Xhenaiz, 103.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Kur biri i njeriut vdes, atij i priten të gjitha veprat, përveç këtyre të triave: Sadakaja xharije¹⁵, dija e dobishme dhe fëmija i mirë që lutet për të.” (Muslim, Vasijjet, 14.)

Ndërsa në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Pas vdekjes (një) rob i ngrihet grada, e ai pyet:

«O Zoti im! Nga erdhi ky shpërblim?» Allahu i Madhëruar përgjigjet:

«Fëmija i mirë e i devotshëm (që ke lënë pas), u lut dhe kërkoi falje për ty.» (Ibn-i Maxhe, Edeb, 1; Ahmed, II, 509.)

Në këtë botë, fëmijët kanë nevojë për prindërit e tyre gjatë rritjes. Mirëpo nga fundi i jetës së tyre, prindërit kanë nevojë për fëmijët. Ndërsa pas vdekjes, prindërit kanë përsëri nevojë për lutjet e fëmijëve të tyre dhe që ata të jenë sadaka xharije për ta.

Siç u cek edhe në hadithin fisnik, fëmijët e mirë e të devotshëm bëhen sadaka xharije dhe shkak mëshire ndaj prindërve dhe të parëve të tyre të vdekur. E kundërta ndodhë me fëmijët që nuk kanë marrë edukatë Islame, të cilët bëhen një sejjie xharije (pra një gjynah i vazhdueshëm) për prindërit e tyre -Allahu na ruajt!-. Prindër të tillë mbeten pa vizitorë dhe të vetmuar në varret e tyre, edhe pse kanë shumë nevojë.

Mbi të gjitha:

Kur fëmijët lihen në qejf të tyre, duke thënë: “S’ka gjë, ai është ende i vogël, me kalimin e kohës do të rregullohet...” dhe nuk edukohen në vijën e Kuranit dhe Sunnetit, në ditën e Kiametit ata do t’i padisin prindërit e tyre duke thënë:

“Prindërit e mi më lanë pas dore dhe nuk më edukuan si mysliman të mirë...”

15. Sadaka xharije: Një vepër e mirë, prej së cilës përfitojnë krijesat edhe pas vdekjes së atij që e ka bërë. P.sh, mbjellja e një peme frutore, prej së cilës do të hanë njerëzit dhe krijesat e tjera edhe pas vdekjes së atij që e ka mbjellë.

Të mos harrojmë se fëmijët vijnë në këtë botë me një pastërti që meriton Xhenetin. Mirëpo nëse prindërit e neglizhojnë edukimin shpirtëror të fëmijëve të tyre, që janë një amanet hyjnor për ta, këta zogj të Xhenetit -Allahu na ruajt!- mund të fluturojnë në vende të gabuara. Për rrjedhojë, prindërit që nuk kanë shijuar asgjë prej burimit të gjerë shpirtëror të Kuranit dhe Sunnetit, e që për këtë arsye nuk i ndihmojnë dot as fëmijët që të shijojnë diçka, ndodhen përballë një gjynahu të madh që do ndikojë Ahiretin e tyre.

Në këtë botë, prindërit, fëmijët, shokët-miq të afërmit, etj., jetojnë në bashkësi. Mirëpo në botën tjetër do të ketë një “jeumu’l-fasl”, një “ditë ndarjeje”, pra dita kur ndahen rrugët, për të cilën Allahu i Madhëruar na njofton në Kuranin Fisnik. Duke folur për banorët e Xhenetit thuhet:

“«Page!», do të jetë fjala prej një Zoti Mëshirëplotë!” (JaSin, 58.)

Allahu i Madhëruar bën të ditur se Ai do t’i ftojë robërit e mirë në Xhenetin e Tij, me mirësi dhe lavde të shumta. Mirëpo, edhe nëse janë prej së njëjtës familje apo bashkësi, gjynahqarëve do t’u thuhet:

“Veçohuni sot ju, o kriminelë!” (JaSin, 59.)

Në këtë mënyrë, atje do të marrë fund miqësia apo afërsia që kishin në këtë botë dhe gjynahqarëve do t’u tregohet rruga e Xhehenemit.

Mbase atje do të ndahen me mijëra bashkëshortë. E me mijëra fëmijë e prindër do të jenë udhëtarë të rrugëve të ndryshme. Të afërmit e fqinjët, që në dynja jetonin së bashku, por që në fakt busullën e zemrave e kishin në drejtime të ndryshme, do të ndahen një pjesë nga një anë e një pjesë në anën tjetër. Ajo do të jetë një ditë e tmerrshme ndarjeje!..

Me qëllim që atë ditë të mos hidhërohem, duhet të bëjmë që sot kujdes edhe në drejtimin personal, edhe në edukimin në mënyrën më të bukur të fëmijëve tanë që në moshë të njomë, duke i konsideruar ata si amanet i Zotit.

Prindërit më të mëshirshëm janë ata që e përgatisin fëmijën e tyre për të ardhmen e tyre të vërtetë, që është Ahireti, duke e edukuar nën udhëzimin e Kuranit dhe Sunnetit. Trashëgimia më e vlefshme që mund t’i lërë njeriu fëmijës së tij është një personalitet dhe karakter i bukur Islam.

Butësia dhe mëshira që duhet t'u tregohet fëmijëve, nuk konsiston thjesht në ushqyerjen e tyre, veshjen bukur, argëtimin dhe sigurimin e rehatisë së tyre trupore, sepse kjo i shtyn ata të mendojnë se jeta është vetëm në këtë botë. Butësia dhe mëshira e vërtetë ndaj fëmijëve tregohet duke ushqyer në radhë të parë shpirtat e tyre. Në këtë mënyrë e ardhmja e tyre shpëtohet prej dënimit dhe personalitetit të tyre i jepen vlerat shpirtërore që do ta kthejnë të ardhmen e tyre në një pranverë lumturie të pafundme.

Prindërit e mëshirshëm, të cilët besojnë në Allahun dhe në botën tjetër, kur kanë përballë lumturinë e dynjasë dhe atë të Ahiretit të fëmijëve të tyre, refuzojnë dynjanë pa ngurruar aspak dhe zgjedhin Ahiretin. Pra, ata preferojnë për të bijtë oqeanin në vend të disa pikave ujë.

Ai nuk mund të zgjedhi që fëmija të hajë këtu në këtë botë, pa në botën tjetër le të hajë ç'të dojë! Le të ketë një të ardhme të ndritur në këtë botë, pa në botën tjetër le të bëhet edhe prej faqezinjve!..

Ndërkohë, në ditët tona, arsimimit të dynjasë i jepet një rëndësi e veçantë për sigurimin e një të ardhme më të ndritur të fëmijëve, duke shpenzuar me tepri kohë, pasuri dhe mund. Për fat të keq, në lidhje me edukimin fetar, i cili do të garantojë lumturinë e tyre në Ahiret, nuk bëhen përpjekje të mjaftueshme. Përkrah diplomave të dynjasë, nuk bëhet kujdes edhe për diplomat e botës tjetër. Dërgimi i fëmijëve dy a tre muaj në kurset e xhamive, gjatë kohës së verës, konsiderohet e mjaftueshme. Mirëpo, ta parit të edukimin fetar në mënyrë kaq të thjeshtuar, është tregues i hidhur i dobësisë së besimit në zemër.

Veçanërisht në ditët e sotme, prindërit fetarë duhet ta vendosin kokën midis duarve dhe të mendojnë:

- Kush e siguron të ardhmen? A është e ardhmja e vërtetë në këtë botë apo në botën tjetër?..

- Vallë, a dëshirojmë që fëmijët tanë të kenë pozita të larta edhe në vendin e përjetësisë në botën tjetër, po aq sa dëshirojmë që ata të marrin edukim të mirë në këtë botë e të arrijnë pozita të larta në tregun e kësaj jete të përkohshme?

- Vallë a po edukohen fëmijët tanë, sikur me të vërtetë janë tanët? Kush ua formon personalitetin dhe karakterin? Me botëkuptimin dhe orientimin e kujt edukohen? Çfarë shembujsh dhe cilët personalitete ndodhen në zemrat, idealet dhe synimet e fëmijëve tanë? Fëmijët tanë përdorin televizionin, internetin dhe telefonin, apo këto aparate po i komandojnë fëmijët tanë?!

- Sigurisht, çdo prind dëshiron ta shohë fëmijën e tij të veshur me rrobat më të bukura. Mirëpo

një prind që ka të instaluar mirë besimin në botën tjetër, mendon dhe shqetësohet më tepër se a do ta mbështjellë fëmijën e tij me mëndafshin dhe atllasin e Xhenetit, apo me zjarrin flakërues të Xhehenemit në botën tjetër. Me qëllim që fëmijët të përvetësojnë kujdesin ndaj mbulesës, ata duhen mësuar që në moshë të vogël të vishen në një mënyrë me të cilën do të jetë i kënaqur Allahu i Madhëruar. Por a e tregojmë ne shqetësimin për gjendjen e fëmijëve tanë duke menduar për ditën që ata do të dalin para Allahut të Madhëruar, aq sa bëjmë kujdes ndaj veshjes së fëmijëve tanë me qëllim që të mos shihen si të papërshtatshëm kur të dalin midis shoqërisë?

- A i japim më tepër rëndësi përpjekjeve që bëjmë për të zbuluar pamjen e jashtme të fëmijëve tanë, apo përpjekjeve që bëjmë për të gjelbëruar botën e zemrës së tyre në atmosferën e Kuranit dhe Sunnetit? Çka Allahu i Madhëruar vlerëson më tepër tek robërit e Tij, shprehet qartë në këtë ajet fisnik:

"...Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij!.." (Huxhurat, 13.)

Ndërsa në një hadith fisnik thuhet:

"Padyshim se Allahu i Madhëruar nuk sheh trupat dhe pamjet tuaja, por vetëm zemrat tuaja!" (Muslim, Birr, 33.)

Në udhëtimin tonë të përjetësisë, ajo që do të na bëjë dobi neve dhe fëmijëve tanë, nuk është as fuqia trupore e as bukuria e jashtme, por vetëm devotshmëria dhe punët e mira e të sinqerta...

Shkurtimisht, që nesër të mos mbetemi fillikatisht me një pendesë të thellë në varrin e shkretuar dhe të sigurojmë lutjet e fëmijëve tanë për ne, duhet të përpiqemi sot sa kemi mundësi t'i edukojmë fëmijët tanë me frymëzimin shpirtëror të Kuranit. Ne duhet të interesohemi nga afër me edukimin e fëmijëve, duke u përpjekur të injektojmë në zemrat e tyre të pastra dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, (a.s.), dhe kulturën e Kuranit e Sunnetit. Duke u nisur nga fakti se motivimi është një nga mënyrat më të mira të edukimit, ne duhet t'i motivojmë ata me dhurata dhe fjalë inkurajuese me qëllim që tek fëmijët tanë të gjallërohen më lehtë bukuritë dhe mirësitë shpirtërore.

I nderuari Imam Maliku ka thënë:

"Sa herë që unë mësoja përmendësh një hadith, babai më jepte një dhuratë. Por erdhi një kohë që edhe nëse babai im nuk më jepte dhuratë, mësimi përmendësh i haditheve u kthye në kënaqësi për mua."

Të mos harrojmë se çfarëdo lloj fare të mbjellim në tokën e zemrës së fëmijëve tanë, atë prodhim do të marrim. Pra çfarë kemi dhënë, duhet të presim!..



Së harrojmë? Gjë që s'bëhet!

— Idris Arpat —

“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç’ka përgatitur për të nesërmen! Kijeni frikë Allahun, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju! Mos u bëni si ata që e harruan Allahun, kështu që Ai i bëri të harronin vetveten! Pikërisht ata janë të pabindurit (ndaj Allahut).” (Hashr, 18-19)

Allahu i madhëruar është në qendër të jetës sonë. Ne i takojmë Atij dhe tek Ai do të kthehemi. Ne jemi të detyruar që qëllimin tonë, punën që bëjmë dhe fjalët që themi, t’ia paraqesim kënaqësisë së Tij. Ai do të na vlerësojë dhe do të na shpërblejë. Por mund të bëjë edhe të kundërtën.

Ai është Krijuesi ynë i Madhërishëm, i Cili na do gjithmonë të mirën. Ai është Miku, Kujdestari, Ndihmësi dhe Mbrojtësi ynë. Ai është i Zoti i shtëpisë sonë. Ai është Gjykatësi absolut, para të Cilit do të dalim në botën tjetër dhe do të japim llogari. Ai është Sunduesi i vendit të shpërblimit pa fund dhe të pashoq.

Ai është Zoti ynë që na do dhe pret dashuri prej nesh. Ta harrosh Atë, do të thotë të jesh i pakujdesshëm dhe të mos ia dish vlerën, sepse, “kush harron

nuk ka dashur, e kush ka dashur nuk harron.”

Plotësimi i detyrave dhe përgjegjësiave tona ndaj Allahut, varet nga sa vend zë Ai në përditshmërinë tonë. Kur kryejmë detyrat tona, qëllimi ynë është kënaqësia e Allahut. E kur puna është kështu, atëherë harresa ndaj Tij, do të thotë se detyrat tona nuk mund të realizohen me një entuziazëm të lartë. Dhe kjo, tregon “mungesën e cilësisë në devotshmërinë tonë”.

Allahu i Madhëruar, si një fuqi të Cilit i kemi borxh çdo gjë, nuk dëshiron të harrohet. Të mos e harrosh Atë, është shpëtim prej mërzisë së shpirtit dhe gëzimi i zemrës. Ai është më afër nesh se damari i qafës sonë, hyn midis nesh dhe zemrës dhe di gjithçka që kemi në zemër. Ndërsa ne, si robër të Tij, duhet të marrim gjithmonë për bazë pëlqimin e Tij në çfarëdo pune që bëjmë dhe në çfarëdo mirësie që arrijmë.

Kur flet për nxjerrjen e Ademit dhe Havasë nga Xheneti, Allahu i Madhëruar shprehet:

“... «Zbritni prej Xhenetit që të dy! Do të jeni armiq të njëri-tjetrit. Kur t’ju vijë udhëzimi nga ana Ime, kush do ta pasojë udhëzimin Tim, as nuk do të humbë, as nuk do të bjerë në mjerim. Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër.» E ai do të thotë: «O Zoti im, përse më ringjalle të verbër, kur unë kisha shikuar më parë?» (Allahu) do t’i thotë: «Kështu të erdhën shenjat Tona dhe ti i harrove ato e po kështu sot do të jesh i harruar. Kështu e ndëshkujmë Ne atë që e tepron (me gjynahe) dhe nuk beson shenjat e Zotit të tij; e dënimi në jetën tjetër, në të vërtetë, është më i ashpër dhe më i qëndrueshëm.» (Ta-Ha, 123-127)

Udhëzimi i vërtetë është ai i Allahut të Madhëruar, prandaj ne nuk duhet ta lëshojmë kurrë nga duart hartën e rrugës (Kuranin) që Ai na ka ofruar. Nëse njeriu, i cili me kapacitetin dhe vlerën që ka, është më superior se shumë krijesa të tjera, merr drejtimin e gabuar, do të humbasë si një përrua i vogël që rrjedh drejt shkretëtirës. Mënyra për t’u bërë i nderuar në të dyja botët, është të ndjekësh drejtimin e duhur që përcaktohet në hartë. Kjo do të thotë se Kurani Fisnik duhet lexuar bashkë me përkthimin e tij dhe të meditohej mbi të. Kjo lidhje e ngrohtë dhe e dashur, duhet të kthehet në zakon. Herë pas here duhen hapur edhe tefsirët e njohur. Duhet dëgjuar edhe dijetarët që ia kanë kushtuar jetën Kuranit Fisnik. Madje, ata duhen dëgjuar me veshët e zemrës, jo me veshët e trupit.

Marrja e mesazhit prej Kuranit dhe përpjekja për ta kuptuar atë, duhet të jetë e vazhdueshme. Kjo përpjekje nuk duhet të jetë dy apo tre vjeçare, por për gjatë gjithë jetës. Nga kjo varet edhe saktësia e kriterëve tona dhe gjallëria e shpirtit tonë. Duhet të lexojmë për të kuptuar, të kuptojmë për të jetuar dhe të jetojmë për të arritur kënaqësinë e Allahut. Ndërsa për njeriun që ka arritur kënaqësinë e Allahut, edhe kjo botë, edhe bota tjetër bëhen Xhenet.

Kushdo dhe çfarëdo të ketë shkruar, e ka shkruar për t’u kuptuar. Pra, edhe Kurani Fisnik është një letër e shkruar nga Allahu i Madhëruar për robërit e Tij. Kjo letër duhet lexuar patjetër dhe duhet vepruar ashtu siç porositet në të.

Kuptimi i Kuranit dhe përpjekja për ta vënë atë në jetë, duhet të jetë synimi ynë më kryesor. Pa përjashtim, asnjë libër nuk duhet vënë para Kuranit. Myslimani nuk mund të pranojë si udhëzues asnjë njeri dhe asnjë grup përveç Allahut. Kushdo që dëshiron të thotë diçka, është i detyruar ta thotë

në përputhje me kriteret e Kuranit. Pra, në boshtin kryesor vendoset gjithmonë Kurani.

Në fakt, nuk ka asnjë dallim ndërmjet harresës së Kuranit për shkak të mosbesimit dhe të harresës (mosinteresimit) së tij edhe pse e beson. Mospërpjekja për të kuptuar Kuranin, do të thotë, “mua s’më intereson se çfarë thotë Allahu i Madhëruar”. Dhe, nëse neve nuk na intereson se çfarë thotë Krijuesi ynë, atëherë cila është ajo fjalë që do të na interesojë? Ata që i harrojnë fjalët e Allahut, do të harrohen nga Ai në Ditën e Kiametit. Për këtë na ka paralajmëruar Allahu në Kuran:


“Banorët e zjarrit do t’u thërrasin banorëve të Xhenetit: “Derdhni pak ujë te ne ose diçka nga ajo që ju ka dhuruar Allahu!” Ata thonë: “Në të vërtetë, Allahu këto i ka ndaluar për mohuesit, të cilët e morën fenë për lojë dhe argëtim dhe u mashtruan nga jeta e kësaj bote”. Ne sot do t’i harrojmë ata, ashtu siç e patën harruar ata takimin e kësaj Dite dhe siç mohuan shpalljet Tona. Ne u kemi zbritur atyre një Libër, të cilin e kemi shpjeguar gjerësisht, që të jetë udhërrëfyes dhe mëshirë për njerëzit që besojnë.” (A’raf, 50-52)

Bota tjetër është e nesërmja e jetës sonë dhe, për të nesërmen duhet të përgatitemi që sot. Ai është vendi ku do të përjetohen mirësitë dhe lumturia e pasosur. Kjo botë, është një vend pune dhe përpjekjeje, ndërsa bota tjetër është bota e pafundme ku do të bëhen llogaritë dhe do të shpërblehemi sipas qëllimeve dhe veprave tona.

Nëse mohohet bota tjetër, automatikisht edhe kjo botë do ta humbasë kuptimin e vet. Nëse nuk presim gjë prej të nesërmes, atëherë edhe përpjekjet shkrihen edhe duart na lidhen. Nëse e përngjasojmë këtë botë me një trup, bota tjetër është shpirti i tij. Kjo botë, edhe ngrohtësinë, edhe lezetin e merr prej besimit në botën tjetër. Trupi pa shpirt do të ngurtësohet dhe do të kalbet.

Njerëzit punojnë dhe përgatiten në një vend për të shkruar në një vend tjetër. Në shkollën fillore mësojnë për të shkruar në shkollë të mesme, në shkollë të mesme mësojnë për në universitet, e në universitet mësojnë për të dalë në jetë. Në mënyrë të njëjtë, ata punojnë dhe përgatiten në këtë botë për të shkruar në botën tjetër. Për këtë arsye, është thënë: “Kjo botë, është ara e botës tjetër”.

Si përfundim, ne nuk mund të harrojmë as Allahun dhe as botën tjetër. Madje, nuk mund të lëshojmë prej dorës as udhëzuesin e jetës sonë. Përndryshe? Përndryshe jemi të humbur në të dyja botët!



KOMANDANTI I SHIGJETARËVE NË UHUD

ABDULLAH IBN XHUBEJR

- R A D I J A L L A H U A N H U -

— Mustafa Erish —

Abdullah ibn Xhubejri (r.a.), ishte një besimtar i devotshëm, i cili u nderua me Islam menjëherë pas Besëlidhjes së Parë të Akabes... Po ashtu, ai ishte një prej fatlumëve që u takua me Profetin (a.s.) në Besëlidhjen e Dytë të Akabes, ku edhe i dha besën atij... Ndërsa në betejën e Uhudit, ai ishte komandanti që i Dërguari i Allahut (a.s.), vendosi në kodrën e Ajnejnit në krye të shigjetarëve...

Ai lindi dhe u rrit në Medinë. Aty dëgjoi për ardhjen e një feje të re dhe daljen e një Profeti. Pa humbur shumë kohë, ai u ndriçua me dritën e Islamit. Emri i tij i plotë, ishte Ebu'l-Mundhir Abdullah b. Xhubejr b. en-Nu'man el-Ensari.

Ai, së bashku me shtatëdhjetë myslimanë të Medinës, shkoi në Mekë për Besëlidhjen e Dytë të Akabes. Para Besëlidhjes ai dëshiroi të takohej personalisht me të Dërguarin e Allahut (a.s.). Për këtë arsye, bashkë me disa shokë të tij, ai pyeti se ku mund ta gjente Profetin (a.s.). Kur e mori vesh se ndodhej në shtëpinë e xhaxhait të tij, Abbasit (r.a.), shkoi drejt e atje.

Kur arriti, Abdullah ibn Xhubejri kërkoi të takohej me të Dërguarin e Allahut (a.s.). Mirëpo, Abbasi (r.a.), ishte i mendimit që i Dërguari i Allahut (a.s.), duhej ta mbante të fshehtë prej kurejshëve marrëdhënien e tij me medinasit. Për këtë arsye, ai i tha atyre se me Profetin do të mund të takoheshin vetëm në vendin e quajtur Akabe. Pas kësaj, ai së bashku me shokët e tij u larguan prej aty dhe ditën tjetër, u takuan me të Dërguarin e Allahut (a.s.), në Akabe, ku edhe u besatuan.

Abdullah ibn Xhubejri (r.a.), ka marrë pjesë në betejën e Bedrit dhe në atë të Uhudit. Në betejën e Uhudit, i Dërguari i Allahut (a.s.), e vendosi atë si komandant të shigjetarëve në vendin strategjik të quajtur kodra e Ajnejnit, ku nën urdhrat e tij la afërsisht pesëdhjetë shigjetarë, duke dashur të pengojë sulmin pas shpinës së ushtrisë Islame nga ana e armikut. Urdhri i tij ishte që askush të mos e lëshonte vendin e tij në atë pozicion, duke i dhënë këtë porosi të rëndësishme historike:

“O Abdullah!.. Mbaj larg prej nesh kalorësit e

armikut (duke i goditur) me shigjeta! Pengoji ata që të mos na sulmojnë! O Abdullah!.. Sido që të shkojë puna, qoftë në favorin tonë, qoftë kundra nesh, qëndro pa lëvizur në vendin tënd, me qëllim që kalorësit e armikut të mos na vijnë nga pas shpine prej vendit ku ndodhesh ti! O Abdullah!.. Edhe nëse sheh që ne po fitojmë dhe fillojmë të mbledhim plaçkën e luftës, bëni kujdes mos ejani pranë nesh (e të lëshoni vendin)! Madje, edhe nëse shihni se ne po na hanë zogjtë, mos u largoni prej vendit tuaj pa marr lajm nga unë!” (Buhari,V, 29; Musned IV, 293; Ebu Daud, Sunen III, 51.)

Në bazë të këtij urdhri, shigjetarët nuk do të lejonin askënd të sulmonte ushtrinë Islame pas shpine. Ata do të sulmonin me shigjeta këdo që do të provonte të kalonte prej aty. Pasi i Dërguari i Allahut (a.s.), u dha urdhrat dhe porositë shigjetarëve, tha:

“Kur kalorësit e armikut të vijnë drejt jush, gjuajini me shigjeta, sepse kuajt e kalorësve nuk mund të vijnë drejt shigjetave!” Më pas, vazhdoi duke thënë:

“O Allah! Ty të kam dëshmitar për këto që po ua them!” (Ibni Sa’d, II, 47; Uakidi, Megazi I, 274; M. Asim Koksall, Islam Tarihi 4/133-134.)

Beteja e Uhudit ishte e vështirë dhe e ashpër. Një pjesë e madhe e shigjetarëve, të cilët panë se vëllezërit e tyre po triumfonin, kishin filluar të largoheshin prej vendit të tyre me qëllim që të mos mbeteshin pa plaçkë lufte.

Abdullah ibn Xhubejri (r.a.), si komandat që ishte, u kujtoi atyre urdhrin dhe porositë e të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili tha: “Edhe nëse na shihni të pësojmë disfatë dhe kuajt tanë t’i hanë zogjtë, pa ju ardhur lajm nga unë mos u largoni prej vendit!”

A e harruat se çfarë ju tha i Dërguari i Allahut (a.s.)? Ai ju tha të mos e braktisni vendin tuaj! Mirëpo, pavarësisht të gjitha përpjekjeve të mëdha që bëri, nuk arriti t’i pengojë ata.

Bera Ibn Adhib (r.a.), i cili atë ditë ndodhej në të njëjtin vend, e tregon kështu gjithçka që ndodhi:

“Atë ditë, kur u përballëm me idhujtarët, Allahu i dërmoi dhe ata ikën. Madje, unë pashë që gratë të cilat ikën drejt kodrës me shpejtësi, përveshën fustanet e tyre, aq sa iu dukën edhe rrathët që kishin vendosur në kyçet e këmbëve. Atë moment, të tanët filluan të thoshin: “Plaçkë, plaçkë!..”

Abdullah ibn Xhubejri (r.a.), vazhdoi luftën bashkë

me dhjetë veta që qëndruan me të. Ai luftoi kundër kalorësve mekas që ishin nën komandën e Halid ibn Uelidit, i cili sapo pa që shigjetarët myslimanë lanë vendin e tyre, i rrethoi nga pas me kalorësinë e tij.

Abdullahu (r.a.), e filloi luftën me shigjeta dhe, kur i mbaruan ato filloi të luftonte me heshtën e tij. Por, edhe pasi iu thye ajo, ai vazhdoi të luftonte. Në fund të luftës së tij heroike, ai ra dëshmor prej dorës së Ikrime ibn Ebu Xhehlit dhe shokëve të tij. Mirëpo, idhujtarët nuk u mjaftuan me vrasjen e Abdullah ibn Xhubejrit (r.a.), por të gjithë urrejtjen, arrogancën, zullumin dhe egërsinë e tyre e shfaqën duke e bërë copa copa trupin e këtij dëshmori.

Allahu i Madhëruar, këtë ndodhi në betejën e Uhudit e tregon kështu në Kuranin Fisnik:

“Vërtet Allahu e plotësoi premtimin e Vet, kur ju me vullnetin e Tij e thyet armikun. Por, kur ju u frikësuat, u grindët midis jush dhe kundërshtuat (Profetin a.s.), pasi Ai ju tregoi atë që pëlqenit, (Allahu e tërhoqi ndihmën e Vet). Disa nga ju dëshirojnë këtë botë, ndërsa të tjerë nga ju dëshirojnë botën tjetër. Pastaj Ai, për t’ju provuar, bëri që të zmbropseni para armikut dhe pastaj, sigurisht që jua fali atë gabim. Allahu ka mirësi të madhe për besimtarët.” (Al-i Imran, 152)

Abdullah ibn Xhubejri (r.a.), e transmeton kështu një kujtim të vetin:

“Një ditë, kur i Dërguari i Allahut (a.s.), ishte duke ecur në rrugë me një grup prej sahabëve të tij, erdhi një prej tyre dhe deshi ta mbronte Profetin prej diellit me një mbulesë. Sapo i Dërguari i Allahut (a.s.), pa hijen e mbulesës ngriti kokën dhe vuri re se atij po i bëhej hije me një çarçaf. Atë moment, i Dërguari i Allahut (a.s.), i tha atij që mbante çarçafin që ta lëshonte atë. Më pas, ai e mori çarçafin, e vuri në tokë dhe tha: «Edhe unë jam njeri si ju!»” (Hejthemi, IX, 21.)

Allahu qoftë i kënaqur me Abdullah ibn Xhubejrin!..

Allahu na bëftë të gjithëve si Abdullah ibn Xhubejri (r.a.), që edhe nëse mbetemi të vetëm, ta zbatojmë urdhrin e Profetit (a.s.), të kapemi fort pas Sunetit të tij dhe të kemi forcën ta sakrifikojmë pasurinë, jetën dhe gjithçka që kemi në rrugën e Allahut të Madhëruar! Amin!



PROJEKTI QË PRET BOTA: RINA E DEDIKUAR NDAJ ZOTIT

— Mehmet Lutfi Arslan —

Në çdo mizori, një farë bie në tokë. Në çdo padrejtësi, një thirrje lëshohet drejt Zotit. Në syrin e të shtypurve që ulet në tokë në mënyrë të pashpresë, një lutje prej shpirtit hap krahët drejt qiellit. Malli për drejtësi, për të vërtetën dhe besnikërinë, është bërë fidan dhe po e rrit atë që pritet në barkun e vet. Dhe ajo që pritet, është rina e dedikuar ndaj Zotit.

Merjemja, bija e Imranit ishte një fëmijë i dedikuar për Zotin. Ajo u pranua në mënyrën më të bukur prej Zotit. U rrit si një bimë e bukur dhe vendi i saj ishte mihrabi¹, që për të u bë simboli i dedikimit. Ai ishte një vendstrehim ku janë dhënë lloj-lloj mirësish dhe ku është manifestuar pastërtia/ruajtja prej gjynaheve. Merjemja ka qëndruar gjithmonë aty, gjithmonë e pastër, gjithmonë e papërlyer. Erdhi një ditë dhe u bë shkak i “Fjalës” së Allahut. Ajo “Fjalë” u bë profet dhe u quajt Isa, i Dërguar i Allahut (a.s.).

Edhe të rinjtë e shpellës (As’habu’l-Kehf), ishin djem të dedikuar ndaj Zotit. Dedikimi i tyre, i takoi me shpellën. Allahu i tërhoqi ata prej vendit të të këqijave dhe gjynaheve të cilat ata nuk i pranonin dhe shpellën e bëri vendin e tyre, ku u mbrojtën dhe mbetën të papërlyer. Erdhi një ditë, kur duhej të dilnin dhe e gjetën botën të ndryshuar. Ata kishin mbetur pa lëvizur, të papërlyer dhe të pastër, ndërsa bota e pistë, duke u rrotulluar (për vite me radhë) kishte ardhur në pozitën e tyre. Por këtë herë, të pastrit i kishte vënë në krye.

Edhe Mus’abi ishte një djalë i dedikuar. Ai nuk u mashtrua nga pozita dhe pasuria e madhe që kishte, por iu përgjigj ftesës së bekuar të Resulullahut (a.s.) dhe me atë ftesë u bë tjetër njeri. Në fakt, ai ishte bebjja e syrit të familjes së tij dhe ëndrra e vajzave të Mekës. Dedikimi i tij, e bëri të takohet me dashurinë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.). Me këtë

dashuri, ai mbeti i pastër dhe i papërlyer. Dashuria i mjaftoi atij. Me këtë dashuri pa jetën, me këtë dashuri bëri sakrifica dhe me këtë dashuri emigroi (në Medinë). Erdhi dita që u bë shkak i Islamit të Medinës dhe e përgatiti atë qytet për të Dërguarin e Allahut (a.s.).

Na duhen Merjeme të reja, As’habi Kehf dhe Mus’abë të rinj. Bota po pret ardhjen e një stine të re dedikimi. Dimri zgjati shumë. Zemrat janë ngrirë, janë bërë gurë për shkak të akullit të mohimit dhe idhujtarisë. Pritet një pranverë dedikimi që do t’i zbusë dhe do t’i shkrijë zemrat. Këtë pranverë do ta sjellin të rinjtë që e jetojnë pranverën e jetës e tyre, si Merjemja, si të rinjtë e shpellës dhe si Mus’abi.

Bota po pret të rinjtë që i janë dedikuar Allahut, sepse tashmë nuk i ka mbetur më durim. Në një kohë kur të gjithë rendin kaq shumë pas “unit”, të rinjtë e dashuruar marrëzisht pas Allahut do t’i japin frymë botës. Dhe të jeni të sigurt, se kjo frymë do të jetë me garancinë e përjetësisë. Bota po digjet nga malli për të rinjtë që e kanë të qëndisur në ballë vulën e përjetësisë. Bota po pret të rinjtë që e kanë bërë stil jetese pastërtinë dhe devocionin.

Të jesh i dedikuar ndaj Allahut, do të thotë të mos heqësh dorë prej vullnetit për të mbetur i pastër dhe të rezistosh ndaj përlyerjes. Dedikim ndaj Allahut do të thotë të dëshirosh të mbetesh i pafajshëm. Për këdo që dëshiron të mbetet i pafajshëm, patjetër që ka një mënyrë. Dedikimi ndaj Allahu e bën të mundur edhe të pamundurën. Bën të rrjedhin në të kundërtën e ujërat.

A lind fëmija pa baba? Në fakt, ai shpirt i pastër, shembull i ndershmërisë dhe i dedikuar ndaj Allahut, e lind! Dhe fëmija e asaj krijese të dedikuar, bëhet “fjala” e Allahut, i jep jetë të gjallëve dhe lajmëron Ahmedin që do të vijë pas tij!..

A mund të flihet për treqind vite në shpellë? Në fakt,

1. Vend i posaçëm adhurimi, dhomë ose altar.



kur bëhet fjalë për të rinj të dedikuar ndaj Allahut, flihet! Ndërkohë që ata flenë, bota jashtë ndryshon. Dhe kur zgjohen, e gjejnë botën tek koka. Bota, brenda së cilës nuk deshën të jetonin dhe për këtë ikën dhe u strehuan në shpellë, ka rendur pas tyre dhe i ka arritur, duke u bërë si ata.

Poseduesi i veshjeve më të shtrenjta, bebja e syrit të familjes së vet dhe më i pashmi i Mekës, bie dëshmor dhe ikën nga kjo botë pa gjetur edhe një qefin për ta mbuluar, por pas tij shkruhen legjenda: Ai tashmë është një prej më të mirëve të njerëzimit. Ai tashmë është një mësues shembullor deri në pafundësi për çdo të ri që do të ulet para tij i gatshëm për sakrificën e dedikimit ndaj Allahut.

Dedikimi është dashuria për të natyrshmen. Është kërkimi i sigurisë së vendit të parë ku është jetuar, malli për zërin e parë të dëgjuar dhe i aromës së ajrit të parë që është thithur. Për këtë arsye të dedikuarit dalin gjithmonë midis të rinjve, sepse freskia e tyre është sikur kanë ardhur tani prej atdheut tonë të vërtetë. Rini, do të thotë të ndjesh fort mallin e vendit që ke lënë pas dhe mos mësimi me kurbetin. Rini, do të thotë të kthehesh e të besosh përsëri. Do të thotë të tronditësh ekzistencën e të thuash, “po sikur baballarët tanë të besojnë gabim”. Do të thotë të ftosh duke thirrur, “ejani të besojmë përsëri!”.

Të dedikuarit janë gjithmonë të rinj, sepse të rinjtë e tërheqin botën pas. Bota ata do më shumë... energjia, entuziazmi, sakrifica dhe guximi i tyre e magjeps atë. Bota përpiqet t’i marrojë ata me të gjitha joshjet e saja. Aty ku ia arrin, i bën robër të saj. Sapo i tërheq pas vetes, nuk i jep më asnjë vlerë. E në fakt, ajo është e dashuruar marrëzisht pas atyre që nuk i tërheq dot pas vetes. Ja pra, pikërisht këta janë të rinjtë e dedikuar ndaj Zotit. Bota do të rinjtë e dedikuar, i vëzhgon ata, rrotullohet rreth tyre dhe vullnetin e vet e lidh pas vullnetit të tyre.

Të dedikuarit janë gjithmonë të rinj, ndërsa të rinjtë janë shumë entuziastë. Kjo, sepse vullneti për të mbetur të pastër, bart një moral kryengritjeje. Të ngresh krye, do të thotë të rezistosh. Dhe ata që mbeten të pastër, janë vetëm ata që rezistojnë. Nuk mund të mbetesh i pastër pa rezistuar. E, atyre që rezistojnë, Allahu u jep një rrugëdalje prej andej nga nuk e presin. Ata që tregojnë vullnetin për të ruajtur pafajësinë e tyre, Allahu u tregon një vend. Ai vend është një fidanishte ku rritet dhe jep filiza dedikimi i tyre. Aty shtohet dedikimi dhe vjen dita që bëhet shembull për njerëzit. Kur dedikimi përballet me botën, ai bëhet model për të, e tërheq atë dhe e bën të rrotullohet rreth vetes. Kështu ka ndodhur dhe do të ndodhë gjithmonë!

Vëllai im, ti, unë, ai dhe të gjithë ata që i lexojnë këto rreshta dhe ndjejnë entuziazmin e dedikimit ndaj Zotit!.. Ne nuk mund të jemi dokudo. Neve na takon ta tërheqim botën pas, ta sjellim vërdallë dhe ta lëvizim si rruaat e tespiheve. Prandaj, e vetmja rrugë është dedikimi ndaj Zotit. Neve na ka hije vetëm të qëndrojmë të pastër, të ruajmë pafajësinë tonë dhe të

kthehemi tek Zoti ynë të pastër njësoj ashtu siç kemi ardhur në këtë botë.

Neve na ka hije të jemi të rinj të dedikuar ndaj Zotit. Ai që na ka dërguar në këtë botë, ka një dëshirë. Detyra jonë e vërtetë, është të kuptojmë këtë dëshirë. Prandaj, neve duhet të zbulojmë dëshirën e Allahut në lidhje me ne dhe të jetojmë në përputhje me të.

Ai që na ka dërguar në këtë botë, na ka dërguar të pastër. Nuk ishim të pistë. Ishim të papërllyer dhe të pafajshëm. Prandaj jemi të detyruar që tek Ai të kthehemi përsëri të pastër. Duhet të pastrohemi dhe të kthehemi të pastër në atdheun tonë të vërtetë.

Ai që na ka dërguar në këtë botë, ka vënë para nesh edhe modele të bukura. Në sajë të këtyre modeleve ka treguar se si duhet të jetë dedikimi ndaj Tij. Pra, ose duhet të bëhemi ato modele, ose duhet t’u ngjajmë. Dhe mundësia për të zbuluar dëshirën e Tij në lidhje me ne, për të qëndruar të pastër dhe për t’u ngritur lart si ato modele të bukura, arrihet në sajë të dedikimit. Ajo që na është dhënë, duhet të shpenzohet përsëri në rrugë të Tij, duhet të jetojmë si ata që kanë pasur fatin të jenë robër të Tij të devotshëm dhe çdo gjë duhet t’ia kushtojmë/dedikojmë Atij.

Njerëzimi po pret daljen e të rinjve të dedikuar ndaj Zotit. Koha po afrohet. Po vjen një stinë dedikimi. Nëse errësitat kanë hipur njëra mbi tjetrën, nëse e drejta është përzierë me të shtrembëtën, nëse klithmat e të shtypurve janë bërë të padëgjueshme, do të thotë se ka ardhur stina e dedikimit. Të jemi të sigurt se shpirtat e dedikuar ndaj Zotit po qëndrojnë diku si fidanë. Tashmë ata po numërojnë ditët. Po ti ku je, çfarë po bën?

Mos harro se në fillim, u shfaq ëndrra për të rinjtë e dedikuar ndaj Zotit. Më pas në zemra u shfaq dëshira për ta. Dhe kjo do të thotë se koha e ardhjes së tyre është e afërt. Hija e asaj që është shfaqur në zemrat tona, së shpejti do të bjerë edhe mbi ne. Prandaj mund të shpresojmë se kjo botë do të bëhet një vend më i jetueshëm. Mund të shpresojmë se lotët e të shtypurve do të fshihen dhe mizorët do të marrin atë që meritojnë. Atëherë aroma e Xhenetit do të përhapet në të katër anët, sepse të katër anët dhe klimat do të kenë arritur pjekurinë e duhur që do t’i marrë e do t’i çojë në Xhenet.

Po vijnë të rinj që e kanë orientuar shqetësimin, ambicien dhe hallin e tyre drejt së vërtetës, mirësisë dhe devotshmërisë. Të rinj që nuk tërhiqen, por përkundrazi që e tërheqin pas gjithë botën dhe e sjellin tek dera e atdheut të gëzimit... Të pastër sa Merjemja, vigilent ndaj papastërtive sa të rinjtë e shpellës dhe flijues e modestë sa Mus’abi...

Po, po vijnë të rinj të dedikuar ndaj Zotit. Ëndrra dhe dëshira për ta ekziston, tani e ka radhën projekti... Po ti ku je?



Rinia

E SAHABËVE FISNIKË

— Dr. Murat Kaja —

Rinia është një nga mirësitë që Allahu i Madhëruar u ka falur robërve të Tij. Në periudhën e rinisë, të gjitha aftësitë e njeriut, si trupi, mendja, zgjuarsia, memoria, të kuptuarit etj., janë në formën e tyre më të mirë. Për këtë arsye, një i ri që punon me ndershmëri, do të jetë gjithmonë i suksesshëm me lejen e Allahut.

Që prej ditëve të para të Islamit, të rinjtë e ndoqën të Dërguarin e Allahut (a.s.), me përkushtim. Feja jonë e bekuar, u zhvillua në atmosferën shpirtërore të këtyre të rinjve. Sahabët fisnikë, shumica e të cilëve ishin aq të rinj sa mund të quheshin edhe fëmijë, bënë shumë sakrifica për hir të fesë së tyre që në moshë të vogël. Në sajë të shërbimeve që ata i kryen me pasion dhe vetëmohim, u ndriçuan me udhëzim shumë qytete, duke arritur paqen me moralin islam. Në fillim, të rinjtë e Mekës, e më pas ata të Medinës u bënë legjenda në historinë islame.

Kur Abasi (r.a.), pa fytirat e delegacionit që erdhën prej Medinës në Besëlidhjen e dytë të Akabes, vuri re se ishin njerëz të cilët nuk i njihte fare dhe i shqetësuar, i thotë Profetit (a.s.):

“O biri vëllait tim! Unë nuk e di se kush janë këta njerëz që kanë ardhur, megjithëse unë e njoh shumë mirë popullin e Jethribit (Medinës)... Këta janë njerëz të cilët nuk i njoh. Këta janë të gjithë të rinj!” (Ahmed, III, 339.)

Gjatë hixhretit (emigrimit) për në Medinë, Profeti (a.s.), bashkë me Ebu Bekrin (r.a.), u fshehën për tre net në një shpellë në malin Seur. Djali i Ebu Bekrit (r.a.), vinte tek ata sapo binte nata dhe e kalonte gjithë natën me ta. (Në mëngjes pa gdhirë dita, ai kthehej përsëri në Mekë) Abdullahu, ishte një i ri i aftë dhe i zgjuar. (shih. Buhari, Menakibu'l-Ensar, 45.)

Enesi (r.a.), ka thënë:

“I Dërguari i Allahut erdhi në Medinë. Midis të gjithë sahabëve të tij, nuk kishe asnjë tjetër me flokë dhe mjekër të thinjur si Ebu Bekri (r.a.). Por edhe ai i kishte lyer flokët me këna dhe bimë liri.” (Buhari, Menakibu'l-Ensar, 45.)

Kur Rasulullahu (a.s.), emigroi në Medinë, Zejd bin Sabit (r.a.), ishte një jetim 11- vjeçar. Ai tregon:

“Kur Rasulullahu (a.s.), erdhi në Medinë, mua më

çuan para tij dhe ai më përkëdheli. Të pranishmit i thanë:

«O Rasulallah! Ky është një i ri prej Bijve të Nexharit. Ai di përmendsh shtatëmbëdhjetë sure që të kanë zbritur nga Allahu.»

Kjo i pëlqeu shumë Profetit (a.s.), i cili më tha:

«O Zejd! Mëso për mua të shkruash në gjuhën e hebrejve. Për Allahun, unë nuk i besoj hebrejve në lidhje me shkrimin.»

Pa kaluar mirë pesëmbëdhjetë ditë, unë e mësova shkrimin e tyre. Madje, u aftësova shumë në këtë çështje. Tashmë, kur hebrejtë i shkruanin ndonjë letër Rasulullahut (a.s.), unë ia lexoja atij. Kur Profeti (a.s.), dëshironte t'u përgjigjej këtyre letrave, atëherë unë i shkruaja në emër të tij." (Ahmed, V, 186. shih. Buhari, Ahkam, 40; Ebu Daud, Ilim, 3/3645; Tirmidhi, Istizan, 22/2715.)

Kur Profeti (a.s.), ishte ende gjallë, ai u ka dhënë të drejtë për fetva edhe sahabëve të rinj, si Aliut, Abdurrahman bin Aufit, Abdullah bin Mes'udit, Zejd bin Sabitit etj., (r.anhum). Po ashtu, edhe shkruesit e shpalljes që zbriste nga Allahu, shkruesit e letrave të ftesave islame dhe dërguesit e tyre te personat e rëndësishëm, në përgjithësi i kishte zgjedhur prej të rinjve.

Për shembull, marrëveshjet që bënte Rasulallahu (a.s.), në shumicën e rasteve i shkruante Aliu (r.a.). Përveç kësaj, ai shkruante edhe shkresat në lidhje me personat dhe fermanët e pronësive.¹

Një ditë, i Dërguari i Allahut së bashku me disa persona prej muhaxhirëve dhe ensarëve dhe disa të rinjve prej kurejshëve dhe jashtë tyre, dolën për të përcjellë Muadh bin Xhebelin (r.a.), si vali në Jemen. Muadhi (r.a.), ecte hipur mbi një kafshë, ndërsa Rasulallahu (a.s.), ecte në këmbë përbri tij, duke e këshilluar. Muadhi (r.a.), tha:

«O Rasulallah! Unë jam hipur, ndërsa ti ecën në këmbë. A nuk bën sikur të zbres edhe unë e të eci në këmbë bashkë me ty dhe sahabët e tu?» Profeti (a.s.), tha:

«O Muadh! Unë shpresoj shpërblim prej Allahut për këta hapa që po hedh në rrugën e Tij.» (Dijarbekri, Hamis, II, 142.)

Enesi (r.a.), tregon:

«Ishin shtatëdhjetë të rinj prej ensarëve, që njëhe-

shin me emrin kurra/lexues Kurani. Ata qëndronin vazhdimisht në xhami. Mirëpo, kur binte mbrëmja, ata tërhiqeshin në një vend që kishin caktuar në një cep të Medinës dhe aty lexonin dhe mësonin Kuran deri në mëngjes. Gjatë kësaj kohe, diskutonin gjatë për ta kuptuar më mirë Kuranin dhe falnin namaz. Familjet e tyre mendonin se ata ndodheshin në xhami, ndërsa myslimanët që jetonin në xhami (ehl-i suffice), mendonin se të rinjtë kishin shkuar në shtëpi. Në mëngjes, të rinjtë e fuqishëm mbushnin ujë në pusët përreth dhe e çonin në xhami. Po ashtu, ata bënë dru në kodrat përreth dhe i mbështetnin në murin e shtëpisë së Rasulullahut (a.s.). (Profeti mbante aq dru sa i duheshin dhe pjesën tjetër e shiste për t'i siguruar ushqim ehl-i suffice.) Ndërsa të rinjtë që kishin mundësi të mira ekonomike, mbledheshin bashkë, blinin një dele, e piqnin dhe e varnin në murin e shtëpisë së Rasulullahut (a.s.). (Në këtë mënyrë, ata dhuronin sipas mundësive, duke ndihmuar edhe besimtarët nevojtarë.)

Profeti (a.s.), këta të rinj i dërgoi të gjithë si mësues nëpër fiset arabe, ku edhe u tradhtuan në vendin e quajtur Bi'r-i Maune. Aty u ndeshën me tradhtarët dhe ranë të gjithë dëshmorë. Nuk e kam parë të Dërguarin e Allahut (a.s.), të hidhërohet për asgjë tjetër më shumë se sa u hidhërua për humbjen e tyre. Kjo e tronditi aq shumë Profetin (a.s.), sa që i mallkoi vrasësit e kurrave për një muaj të tërë pas namazit të sabahut."²

Pranë Rasulullahut (a.s.), gjendeshin rreth njëzet të rinj prej ensarëve. (Ata ishin gjithmonë gati për çdo gjë që nevojitej) Kur vrasësit prej Urejnes bënë një krim, Profeti (a.s.), i dërgoi këta të rinj për t'i kapur. (Muslim, Kasame, 13.)

Abdurrahman bin Auf (r.a.), thotë:

«Katër apo pesë prej sahabëve të Rasulullahut (a.s.), qëndronim me turne natë e ditë pranë tij me qëllim që të plotësonim çdo nevojë që ai kishte.» (Ebu Ja'lâ, Musned, II, 164/858.)

Sahabët fisnikë e konsideruan rininë si stinën e fitimeve materiale dhe shpirtërore, ndërsa të rinjtë si diamante që duhen ruajtur. Për shkak se rinia është një thesar i vlefshëm dhe një xhevahir i çmuar, ata e kanë ruajtur atë me kujdesin më të madh. Përndryshe, shejtanët prej njerëzve dhe xhindëve mund ta grabitin këtë thesar dhe ta shpenzojnë në punët e tyre të fëlliqura.

1. Ibn Sa'd, I, 267, 268, 272, 274, 285; Ibn Abdilberr, Istiâb, I, 69, Ibn Esîr, Usdu'l-Gabe, I, 62.

2. shih. Ahmed, III, 235, 137; Buhari, xhenaiz, 41, xhihad 9, Vitri 7, Megazi 28; Muslim, Imare, 147.



Gjuha ËSHTË PASQYRA E ZEMRËS SË NJERIUT

— Naim Drijaj —

Gjuha është një nga mirësitë e shumta me të cilat na ka nderuar Allahu (xh.sh) me qëllim që ajo t'i shërbejë siç duhet misionit për të cilin është krijuar. Nëse ajo përdoret siç duhet, e shpie njeriun në xhenet, por nëse ajo përdoret për të mbjellë grindje dhe intriga, sjell fatkeqësi dhe e shpie njeriun në xhehenem.

Besimi në Allahun (xh.sh) dhe botën tjetër janë gjëra që i përkasin zemrës, por që tregues kanë gjuhën. Është gjuha ajo që e vërteton besimin e vërtetë në Zotin dhe botën tjetër. Gjuha është pasqyra e zemrës së njeriut.

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kur biri i Ademit zgjohet nga gjumi, të gjitha pjesët e trupit kërkojnë të jenë të mbrojtura nga gjuha duke i thënë asaj: “Kije frike Allahun në lidhje me ne, sepse ne jemi pjesë e jotja. Nëse ti i përmbahesh rrugës së drejtë, i përmbahemi edhe ne. Por nëse ti devijon, kemi devijuar edhe ne.”¹

Çdo njeri duhet ta dijë se çdo fjalë e tij përcillet nga melekët dhe shkruhet. Allahu (xh.sh) thotë: “Për çdo fjalë që njeriu thotë, ka pranë vetës një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë).”²

Sa marrëdhënie mes njerëzve janë shkatërruar për shkak të gjuhës! Sa shumë zemra janë përçarë për shkak të saj!

Ukbe ibn Amri (r.a) e ka pyetur Pejgamberin (a.s) si të veprojmë që të shpëtojmë kur të dalim para Allahut, Ai tha: “Mbaje gjuhën tënde! Le të të mjaftojë shtëpia jote...”, d.m.th. mos u intereso shumë se çfarë bëjnë të tjerët, por le të të mjaftojë shtëpia jote, veprat e tua dhe të familjes tënde, “...dhe qaj për gjynahet e tua .” Kështu është shpëtimi.³

Imam Shafiu ka thënë: “Kur dikush dëshiron të flas, le të mendohet mirë para se ta thotë atë që ka ndërmend. Në qoftë se ajo që dëshiron të thotë është e dobishme, le ta flasë, në qoftë se nuk është e dobishme më mirë le të heshtë.”

1. Tirmidhiu

2. Kaf, 18

3. Ahmedi, Tirmidhiu



Sufjan bin Abdilahu (r.a) e ka pyetur Pejgamberin (a.s): “O i Dërguar i Allahut! Më trego diçka që duhet t’i përmbahem fort!” Ai i tha: “Thuaj: “Zoti im është Allahu dhe pastaj bëhu i qëndrueshëm në këtë besim.” E pyeti: “Cila është vepra që i’a ke frikën më shumë se mund të më sjellë dëme të ndryshme?” Ai (a.s) e kapi gjuhën e tij dhe tha: “Kësaj frikësoju më së shumti!”⁴

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Muslimani më i mirë është Ai, nga gjuha dhe dora e të cilit janë të sigurtë muslimanët e tjerë”.⁵

Abdullah ibn Mesudi (r.a) ka thënë: “Nuk ka asgjë që e meriton të mbahet nën kujdes më shumë sesa gjuha”.

DISA GJYNAHE QË BUROJNË NGA GJUHA:

1. Të folurit për fenë e Allahut pa dituri. Gjynahin më të madh që e bën gjuha është të mohuarit e Allahut e pastaj të folurit në fenë e Allahut pa dituri.

2. Shpifja. Shpifja konsiderohet prej gjynaheve të mëdha.

3. Përgojimi. Allahu (xh.sh) thotë: “Mos e spiunoni njëri-tjetrin! (Mos i zbuloni të metat e njëri-tjetrit) mos e përgojoni njëri-tjetrin! Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?! Sigurisht që ju do ta urrenit këtë! Kijeni frikë Allahun! Me të vërtetë, Allahu është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë.”⁶

“Mbaje
gjuhën tënde!
Le të të mjaftojë
shtëpia
jote...”

4. Nënçmimi dhe përbuzja. Aisheja (r.anha) një ditë e përmendi Safijen dhe bëri me dorë duke pasur për qëllim ajo e shkurtëra, e Profeti (a.s) i tha: “Pasha Allahun ke folur një fjalë e cila po të hidhej në ujë do ta ndryshonte shijen e tij”.⁷

5. Fyerja dhe ofendimi. Fyerja është një ndër gabimet më të dukshme të gjuhës. Njeriu nuk e analizon fjalën që e nxjerr nga goja ku shpesh me të ofendon dhe fyen të tjerët.

SITTA RUAJMË GJUHËN?

1. Duke ndier përgjegjësinë e llogarisë para Allahut. Trasmetohej se Omeri (r.a) e pa një ditë Ebu Bekrin (r.a) i cili e kishte kapur gjuhën e tij me dorë. E Omeri i tha: “çfarë po bën o prijësi i besimtarëve? Ebu Bekri i tha: “Kjo është shkak për çdo të keqe që më vjen”.

2. Duke u preokupuar për përmirësimin e vetes. Ai që merret me veten e tij nuk ka kohë t’i marrë nëpër gojë të tjerët. Njeriu ka aq gjynahe dhe preokupime sa sikur të merrej me to nuk do t’i mbetej kohë për asgjë tjetër.

3. Duke j’u lutur Allahut. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Besimi i njeriut nuk mund të jete i drejtë derisa të drejtohet (përmirësohet) zemra e tij. Zemra e tij nuk përmirësohet derisa të drejtohet (përmirësohet) gjuha e tij.”⁸

4. Tirmidhiu

5. Buhariu, Muslimi

6. Huxhurat, 12

7. Ebu Davudi, nr. 4875

8. Ahmedi, 3/198



Përgatitja e disa ushqimeve themelore

— Betyl Nefise Inall —

Në kohën kur foshnjat arrijnë në muajin e 4-6 nënat fillojnë të bëjnë këto pyetje:

- Cilat janë produktet me të cilat duhet ta filloj ushqimin e fëmijës tim?
- Sa herë në ditë duhet ta ushqej?
- Si duhet ta përgatis ushqimin e fëmijës tim dhe sa duhet t'i jap?
- Çfarë duhet të bëj, në qoftë se ushqimi i shkaktonte alergji fëmijës etj.

Një pjese të këtyre pyetjeve jam përpjekur

t'u jap përgjigje në shkrimet e mia, kurse në këtë material do të flas për përgatitjen e disa ushqimeve themelore.

Lëng dhe pure frutash

Fruta si molla, pjeshka dhe dardha lahen dhe u hiqet lëkura. Grihen në grirëse xhami, pastaj kullohen në një shami të hollë. Në fillim jepet nga 1 ose 2 lugë ëmbëlsire nga lëngu i frutave dhe me kalimin e kohës kjo sasi rritet.

Për të bërë pure frutash nuk e kullojmë





lëngun e frutave të grira. Banania mund të jepet pasi është shtypur me pirun. Në kohët e para i jepet 1/3 e bananeve të mëdha. Fëmijës mund t'i jepet edhe përzierje: mollë- dardhë ose dardhë- banane. Këto përzierje janë të këndshme dhe fëmija juaj do t'i pëlqejë ato. Brenda lëngut të frutave dhe puresë nuk duhet hedhur sheqer.

Supë dhe pure me perime

Përbërësit: një karotë e vogël, një patate, dy gota ujë.

Në fillim karota dhe patatja lahen. Pasi u pastrojmë lëkurën e karotës dhe patates, i ndajmë ato në pjesë të vogla dhe i vendosim në një tenxhere të cilës i hedhim dy gota ujë; presim sa të zbuten. I kalojmë nga një sitë metalike. Si fillim, fëmijës i jepet një ose dy lugë pastaj dalëngadalë rritet sasia.

Fëmija, që në javën e parë ushqehet me supë perimesh, javën e dytë mund të ushqehet edhe me pure perimesh.

Supa me perime fillon me patate dhe me karota. Në javët në vazhdim mund t'i shtoni spinaq, majdanoz, lakra, rrepë dhe pak oriz,



makarona ose gjëra të ngjashme.

Në fundin e një muaji supës mund t'i shtoni dhe një lugë të vogël vaj ulliri dhe një lugë gjelle mish të grirë viçi. Me anë të mishit të grirë ju e pasuroni atë me proteina dhe me kalori. Mishi i grirë mund të jepet edhe në formë qofteje.

Muhalebi

Përbërësit: një gotë qumësht, tri lugë të vogla miell orizi, tri lugë të vogla sheqer ose muhalebi e përgatitur në një gotë uji dhe gjashtë masa pluhur.

Para moshës një-vjeçare nuk është e mirë që të përdoret qumësht lope. Le të përshkruajmë përgatitjen e muhalebisë:

Përzieni një gotë qumësht dhe miellin e orizit dhe vendosini në zjarr derisa të bëhet një masë kremi. Pak para se ta largoni nga zjarri shtoni sheqerin. Muhalebia mund të bëhet edhe nga ushqim pluhur i gatshëm. Ngrohni muhalebinë e bërë nga një gotë ujë dhe hidhni brenda 6 masa pluhur. Jepet nga mosha 5-6 muajshe.

Kosi

Përbërësit: 100 ml ushqim i gatshëm, një lugë çaji kos.

Për fëmijët më të mëdhenj se një vjeç: 200 ml qumësht, një lugë ëmbëlsire kos.

Për fëmijët deri në një vjeç ushqimi duhet përgatitet për një ditë. 100 ml qumështi të gatshëm i shtojmë 1 lugë çaji kos dhe e lëmë që të vijë për 3-4 orë. E lini në frigorifer për 2-3 orë.

Kur fëmija kalon moshën një-vjeçare përgatitet me qumësht lope. Vloni 200 ml qumësht. Prisni që të arrijë një nxehtësi që e duron dora juaj. Shtoni një lugë ëmbëlsire kos.

Foshnjat që ushqehen në mënyrë natyrale mund të konsumojnë kos që nga mosha 5 ose 6 muajshe. Kosi është më i dobishëm në qoftë se e lini të presë një ditë dhe pastaj e konsumoni.

Pureja e frutave dhe përzierjet e kosit do të jenë një vakt shumë i këndshëm për foshnjën tuaj. Mënyra më e lehtë për ta përgatitur një ushqim të tillë është të shtypni bananen dhe ta përzieni me kos. Fëmijës suaj do t'i pëlqejë shumë kjo shije.



Jetimi im, i mjeri im, i vetmi im

— Aishenur Vural —

Sa emër me vlerë është emri “Fatime” për myslimanët. Ai ishte emri i bijës së Pejgamberit, (a.s.) dhe emri i bashkëshortes së Ebu Talibit, që u kujdes për të Dërguarin e Allahut (a.s.), pas vdekjes së nënës së Tij, Emines. Ne duhet të diskutojmë shumë rreth kësaj zonje, sepse ajo është një zonjë shembullore për njerëzit, në mënyrë që ta kalojmë me sukses njërin prej sprovave më të mëdha... Ajo i shërbeu një fëmije jetim, e ushqeu dhe e rriti atë. Këtë e bëri në një mënyrë aq të përsosur, sa që kur ndërroi jetë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), hyri në varrin e saj, u shtri aty për një kohë dhe këmishën e tij ia dha asaj për qefin, në mënyrë që të mos ndëshkohej në varr... E kujtoi atë gjithmonë me mirësi. Sa fat i madh!..

Edhe sot ka ngjarje që i dëgjoj vazhdimisht dhe që më kujtojnë nënën Fatime... Kam dëgjuar nga vetë jetimët apo nga shumë njerëz që nuk kanë nënë ose nëpërmjet disa të tjerëve se ç’heqin jetimët. Edhe pse shumë zonja që kanë zemër të butë e të mëshirshme prej nëne, tolerancën dhe dhembshurinë që shfaqin ndaj fëmijëve të tyre, nuk mund ta shfaqin ndaj fëmijëve të të tjerëve kur ata ngelin nën përkujdesjen e tyre, nëna Fatime, e sfidoi drejtësinë. Ajo nuk ulej në sofër pa ardhur Pejgamberi dhe nuk i lejonte fëmijët të hanin derisa të vinte Ai. Ajo së pari i jepte Atij për të ngrënë, pastaj fëmijëve të saj...

Në ajetin e 6 të sures Duha, thuhet: “A nuk ishte nevojtar dhe të strehoi?”. Fjala “strehim” që shprehet këtu, nuk është një strehim i rëndomtë... Ka shumë ajete në Kuranin Famëlartë që urdhërojnë mbikëqyrjen e të drejtave të jetimëve, duke filluar nga ajetin 8 i sures Insan, ku thuhet: “...Kujdesen për jetimin.”

Qendra e energjisë së zemrës sime, burimi i shëndetit thotë:

“Të kujdesesh për jetimin nuk do të thotë t’i blesh dy palë rroba për Bajram. Do të thotë t’i heqësh barrën, rëndesën e problemeve të tij psikologjike...” Kjo gjendje në popull ka zënë vend duke u shprehur në këtë mënyrë: “Jetimi u dhimbset shumë njerëzve, por janë të paktë ata që e ushqejnë.”

O Allah, falu mëshirë atyre që kanë nën përkujdesje jetimë!

Fal mëshirë në zemrat e tyre, në mënyrë që të kujdesen për jetimët dhe Emineve e Abdullahëve të mos u ngelet koka pas...

Bëji ata të mëshirshëm, zgjerojua të ardhurat, që të mos u vijë rëndë gjendja e jetimëve, t’u duken të këndshëm dhe t’u pëlqejnë...

Lësho mëshirë rreth tyre që fjalët përreth të mos ua rëndojnë barrën, por përkundrazi t’u lehtësohet...

Jetimi i Amine... Kur po i vdiste nëna, ai i qëndronte te koka. Sa tablo e paharrueshme dhe e dhimbshme që është kjo për një fëmijë gjashtë vjeç!.. Ç’dramë e madhe!.. Sa gjendje të vështirë përjetojnë dhe do të përjetojnë jetimët, çfarëdo moshe qofshin deri në Kiamet!

Poeti thotë: “A ju ka vdekur juve babai? Mua më vdiq dhe u verbova.”

Kushedi sa vjeç ishte, por me sa duket ishte burrë i madh... Sado që të jetë, kur vdesin prindërit fëmija ngel jetim... Ka edhe shembuj të këndshëm, siç është ky:

Një mikeshë tregon se kur i vdiq nëna e burrit, ajo tregohet e mëshirshme ndaj tij duke thënë me respekt ndaj Pejgamberit (a.s.): “Tashmë u bërë si Ai...”

Anadolli është vendi i grave të kulturuar, qofshin ato të ditura ose jo... Çfarë perlash fshihen në kraharorin e saj... Në njërin anë jetimët, të cilëve u plaçkitet prona e pasuria, vajza që shtypen në punë të rënda, ndërkohë që djemtë rrinë, në anën tjetër ka gjyshër fisnikë si Abdulmuttalibi, zonja si Fatma dhe xhaxhallarë si Ebu Talibi, të cilët sillen më të mëshirshëm me ta duke thënë: “Është jetim dhe e ka zemrën të brishtë”, që u bëjnë mirësi më shumë se fëmijëve të tyre...

O Zot, lehtësojua sprovën dhe qetësojua zemrat!.. Ti je streha dhe mbështetja e vetme për jetimët të cilët shtypen, ngaqë nuk kanë njerëz që përkujdesen për ta...

O Zot që në ditën e gjykimit do të marrësh në llogari secilin prej nesh, mëshiroji jetimët dhe ata të cilët përkujdesen për ta... Amin!..



Lumturia në familje

— Zahide Topçu —

Lumturia në familje është një temë shumë rëndësishme. Nuk ka rëndësi gjinia, sepse çdo burrë apo grua që është i/e lumtur në familje përhap lumturi në çdo ambient që e rrethon. Ndërsa njeriu që nuk ka lumturi në familje është gjithmonë i mërzhitur dhe i shqetësuar.

Allahu (xh.sh.), i ka krijuar të gjitha gjallesat në çift dhe secili ka nevojë për tjetrin. Edhe njerëzit janë krijuar në çift, dhe partneri është gjithmonë pjesë e pandarë dhe plotësuese e partnerit tjetër.

Mendja e një njeri mund të kuptohet duke vëzhguar gjërat që ai dëshiron të arrijë. Një grua e zgjuar nuk është e dhënë pas rehatisë të kësaj bote dhe pas të mirave që ajo mund të ofrojë, prandaj ajo do të jetë e lumtur edhe në qoftë se jeton në pallate mbretërore, edhe në qoftë se jeton në kasolle. Sado të bukura të jenë të mirat e kësaj bote një ditë do t'u vijë fundi dhe gjithsesi ato kanë të meta, prandaj nuk mund ta kënaqin kurrë zemrën e një njeriu. Gjëja e vetme që të jep qetësi është besimi në Allah dhe nënshtrimi para Tij. Asnjë gjë tjetër nuk mund ta lumturojë shpirtin.

Burrat gjithashtu nuk duhet ta kërkojnë lumturinë tek puna dhe karriera. Të dyja këto sjellin me vete shumë ankth dhe vështirësi.

Lumturia në familje vjen në çastin kur bashkëshortët e degjojnë njëri-tjetrin dhe përpiqen të kuptojnë se çfarë janë gjërat që mund ta bëjnë tjetrin të lumtur. Gruaja duhet të kuptojë dëshirat e burrit të vet dhe me aq sa ka mundësi duhet t'i plotësojë ato; kurse burri duhet të gjejë rrugë për të arritur tek zemra e gruas së vet.

Gruaja e mirë është si një lule që përhap aromë të këndshme rreth e rrotull. Gruaja duhet të tregohet e zgjuar dhe ta bëjë për vete burrin dhe familjen e tij. Mënyra më e mirë për ta arritur këtë gjë, është duke qenë e bindur ndaj burrit dhe e kujdesshme me fëmijët. Krenaria dhe kokëfortësia nuk të sjellin asnjë gjë të mirë.

Gruaja e mirë dhe e zgjuar është një thesar i

paçmuar. Burri duhet ta dijë vlerën e një gruaje që i njeh Allahun dhe Resulallahun, që e bën më së miri detyrën e vet ndaj fesë, që ka respekt ndaj burrit të vet dhe që e mbështet burrin në punët e tij. Në qoftë se burri nuk ia di vlerën, le të frikësohet se mund të mbesë pa të, sepse gjërat që nuk ua din vlerën, të merren.

Në martesë burri dhe grua duhet të jenë si një mbulesë që fsheh mangësitë dhe problemet e tjetrit. Ata duhet ta mirëkuptojnë njëri-tjetrin dhe të mundohen që t'i falin gabimet. Edhe problemi më i vogël në qoftë se diskutohet shumë, zmadhohet dhe ne jemi dëshmitarë se si janë shkatërruar familje nga një zënkë krejt e vogël. E kundërta ndodh tek familjet e zgjuara, të cilat edhe problemet më të mëdha i zvogëlojnë aq shumë derisa të zhduken krejtësisht.

Fëmijët të cilët rriten në familje në të cilat mbizotëron paqja dhe dashuria janë të lumtur. Ata nuk janë njerëz të stresuar dhe nuk kanë mllef apo urrejtje për njerëzit.

Prindërit në fillim duhet të kenë kujdes sjelljet e tyre, sepse në atë mënyrë do të bëhen shembull i mirë për fëmijët e tyre. Fëmija e mëson në familje dashurinë për nënën dhe babanë, mirësjelljen dhe edukatën ndaj njerëzve të tjerë, respektin ndaj më të mëdhenjve dhe mëshirën ndaj më të vegjëlve.

Shtëpitë tona duhet të bëhen çerdhe në të cilat të mësohet feja jonë. Në to duhet të flitet për Allahun dhe të Dërguarin e Tij në çdo moment. Nëna dhe babai, që janë mësuesit më të rëndësishëm, nuk duhet të harrojnë që t'u mësojnë fëmijëve të tyre shembullin më të mirë të njerëzimit.

Shkurtimisht mund të themi se lumturia që ndodhet brenda zemrës duhet të përçohet në familje, kurse lumturia në familje duhet të kalojë edhe në rrugë e kudo. Zemra e myslimanëve duhet të jetë e mbushur me mëshirë, dashuri dhe paqe. Allahu i begatofte edhe shtëpitë tona me këto të mira. Amin.



Cilat **FIRMA** duhet të zgjedhim për **VESHJET** tona?

— Shefika Kaja Meriç —

Islami ka vendosur ligje universale. Feja jonë nuk ka vendosur ligje dhe rregulla të veçanta për individët. Jeta e jetuar sipas ligjeve të Islamit është shpëtim për të gjithë njerëzimin. Ajo na tregon rrugën për të fituar të mira në këtë botë dhe në tjetrën.

Islami ka rregullat e veta rigoroze për femrat dhe meshkujt, rregulla këto që duhen ndjekur. Në fund të fundit besimtar quhet një person i cili i ndjek rregullat e fesë.

LE T'U HEDHIM NJË SY KËTYRE PYETJEVE:

Cila duhet të jetë lidhja e një myslimani me modën?

Çfarë duhet të bëjë një mysliman për të qenë në modë?

Cilat duhet të jenë rregullat që duhet të ndjekë një mysliman në veshjen e vet?

Në fakt, përgjigja e këtyre pyetjeve ka shumë kohë që është dhënë në një mënyrë të prerë, por ne do t'i kujtojmë ato gjëra edhe një herë.

SI FILLIM TË SHOHIM SHPJEGIMIN E KËTYRE DY TERMAVE:

Çfarë do të thotë veshje firme dhe modë?

Firma është një term që përdoret për të dalluar produktet e ngjashme të prodhuara nga kompani të ndryshme.

Moda përfshin koncepte si veshje, art, muzikë, teatro, ushqim, arkitekturë etj.

Myslimanët nuk duhet të kenë dëshirë ose fiksion për të ndjekur modën. Në qoftë se keni nevojë për një shembull të cilin do e imitoni, ai duhet të jetë shembulli i të gjitha kohërave dhe

që nuk vjetrohet kurrë: shembulli i Pejgamberit të nderuar salallahu alejhi ve selem. Ne duhet të duam, të veshim dhe të pëlqejmë gjërat që Ai ka dashur, veshur dhe pëlqyer.

Moda që ndjek një grua myslimane duhet të shkojë paralelisht me rregullat e Islamit. Asnjë modë nuk duhet të dalë nga rregullat që ka vendosur feja jonë. Në pikën ku moda i bie ndesh veshjes islame, gruaja myslimane duhet të ndjekë fenë e vet pa asnjë dyshim.

Në fakt, ajo që quhet modë është një lloj jetese e cila ndiqet nga ne dhe që del nga rregullat morale. Gratë dhe vajzat e reja duhet të jenë shumë të kujdesshme në këto tema. Ne duhet të jemi të kujdesshëm në momentin që përpiqemi të imitojmë njerëzit e famshëm, duhet të shikojmë edhe vlerat njerëzore të atij personi.

Ajeti kuranor i ka përcaktuar rregullat që duhet të ndjekë një femër myslimane:

Thuaju besimtareve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara), ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme) dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme. Le t'i mbulojnë kraharoret me mbulesat e tyre (të kokës) dhe të mos ua shfaqin stolitë e tyre, përveçse bashkëshortëve të tyre ose baballarëve të tyre, ose vjehërrve të tyre, ose bijve të tyre, ose djemve të bashkëshortëve të tyre, ose vëllezërve apo djemve të vëllezërve të tyre, ose djemve të motrave a grave të tyre, ose atyre që i kanë nën zotërim (si skllave), ose shërbëtorëve që nuk kanë epsh ndaj femrave apo fëmijëve që nuk i dinë ngacmimet e femrave. Dhe të mos i rrahin këmbët (për tokë), në mënyrë që të mos duken stolitë

e tyre të fshehta. Të gjithë ju, o besimtarë, kthehuni tek Allahu të penduar, që të arrini shpëtimin! (Nur, 31)

Allahu (xh.sh.), i ka dhënë shumë rëndësi kësaj teme, këtë e shohim nga mënyra e detajuar në të cilën është shpjeguar kjo gjë, sepse në Kuran në përgjithësi gjejmë të dhënat kryesore dhe nuk ka thellime në detaje. Në momentin kur tema është karakteri dhe personaliteti i femrës myslimane shfaqet një shpjegim i detajuar.

Nuk ka rëndësi se çfarë veshim, veshje firme apo jo, ato duhet të jenë të gjitha sipas rregullave të fesë sonë!.. Të gjitha mendimet e tjera janë gjëra tona personale që nuk kanë të bëjnë me fenë islame.

Diçka tjetër të cilën duhet të kemi kujdes është edhe fakti që nganjëherë termi i të veshurit në modë me termin e të veshurit bukur ngatërrohen. Në fillim duhet të marrim parasysh rregullat e fesë sonë dhe pastaj duhet të kujdesemi për të veshur gjërat të cilat na shkojnë. Bukuria apo siguria që fiton një njeri nga veshjet e modës që përdor shuhet në momentin që ajo modë e humb suksesin e vet. Besimtarja duhet të ketë një stil të vetin dhe një qëndrim origjinal.

Veshja e një rrobe firmato duke e treguar atë, duke i bërë reklamë nuk i shkon një besimtareje. Për më tepër që ky qëndrim tregon krenari dhe arrogancë. Pejgamberi yen i nderuar i ka dënuar ato që krenohen me veshjet e tyre.

Le ta përfundojmë këtë shkrim me ajetet që flasin në lidhje me rregullat që duhen ndjekur në fenë tonë:

“O i Dërguar! Thuaju grave tua: ‘Nëse dëshironi jetën e kësaj bote dhe shkëlqimin e saj, ejani, unë do t’ju lë të kënaqeni për ca kohë dhe do t’ju lëshoj si është më mirë.’” (Ahzab, 28)

“O gratë e të Dërguarit! Ju nuk jeni si gratë e tjera. Nëse i frikësoheni Allahut, mos flisni me përkëdheli, që të mos ju dëshirojë ai që ka zemër epshore, por flisni drejt dhe në mënyrë të ndershme!” (Ahzab, 32)

“O Profet, thuaju grave dhe vajzave të tua, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë mbulesën e tyre (të kokës) përreth trupit. Kjo është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët. Me të vërtetë, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.” (Ahzab, 59)

DUAJA JONË:

*O Allah! Strehohemi tek Ti
për të na mbrojtur nga mëkatet e kësaj
kohe të shthurur që na duken të bukur
e tërheqës! Përsërisim fjalët e Jusufit
(a.s.): “Padysim egoja të çon në rrugë
të gabuar. Vetëm në qoftë se Allahu
të mëshiron...”*

*O Allah, na mbro edhe ne ashtu siç e ke
mbrojtur Jusufin (a.s.), nga ai mëkat
i keq, por në dukje tërheqës. Na bëj
prej atyre që pendohen me singeritet të
thellë. Na i fal gabimet e të kaluarës.
Mos na ndaj nga Resulallahu dhe shokët
e Tij, bëj që gjithmonë të ecim
në gjurmët e tyre... Amin.*



STUDIMI I ADN-SË

udhëzues drejt shërimit TË KANCERIT

Kurat për kancerin po bëhen më të sakta dhe më pak të rënda për t'u përballuar. Tashmë ato janë shpesh më të shkurtra dhe mund të prodhojnë rezultate më të mira se terapitë tradicionale të kancerit.

Kimioterapia, rrezatimi dhe kirurgjia janë trajtime standarte për të luftuar kancerin. Por, kimioterapia dhe rrezatimi vrasin bashkë me qelizat malinjë edhe qelizat e shëndetshme, dhe shoqërohen me efekte të rënda anësore.

Trajtimi i kancerit po zhvendoset tani drejt mjekimit preciz dhe terapive që godasin vetëm kancerin, por jo qeliza të tjera. Për shembull, radiacioni i përqëndruar mund të përdoret tek gratë që kanë kancer të fazës fillestare, pasi kirurgjia ka hequr tumorin malinj. Efektet anësore janë minimale dhe kërkon shumë më pak kohë se terapia me rrezatim në gjoks.

“Kura e shkurtër 5-ditore është e barazvlefshme me të gjithë rrezatimin që zgjat katër deri në gjashtë javë”. Kura të tjera shfrytëzojnë vetë sistemin imunitar të trupit.

“Është tashmë shumë e qartë se sistemi imunitar i pikas qelizat kancerogjene dhe i percepton si jo-

normale. Nëse hidhet në sulm sistemi imunitar, ai mundet t'i sulmojë dhe shkatërrojë qelizat kancerogjene në një mënyrë shumë efikase.

Një kurë tjetër teston qelizat e kancerit për të përcaktuar përbërjen e tyre gjenetike, në mënyrë që në vazhdim të përdoret ilaçi i krijuar posaçërisht për të vrarë vetëm ato qeliza. Bëhet fjalë për të goditur në zemër të qelizave që u shndërruan në kancer. Ky është thelbi i mjekësisë preçize.

Kanceri i secilit pacient është unik, ashtu siç është ADN-ja. Kjo përcakton edhe se çfarë ilaçi do të funksionojë më mirë. Qelizat e shëndetshme nuk preken dhe gjithashtu mund të eliminohen efektet anësore tek pacienti.

Për momentin, impakti më i madh ndjehet nga pacientët, të cilëve nuk u është kuruar dot më parë kanceri, apo atyre që u rikthehet, ose u përhapet në pjesë të tjera të trupit.

Rezultatet janë shumë premtuese. Këto terapi janë ende të reja, por specialistët e kancerit thonë se terapia e përqëndruar, qoftë rrezatimi i fokusuar, imunoterapia apo testimi i genomeve, të pasuar nga mjekimi preçiz, janë e ardhmja e trajtimit të kancerit.



Frutat më të mira

DHE ATO QË DUHET TË SHMANGIN DIABETIKËT

Ka spekulime sipas të cilave diabetikët nuk mund të hanë fruta për shkak të përmbajtjes së lartë të sheqerit. Këto spekulime nuk janë të vërteta për faktin se frutat nuk ofrojnë vetëm sheqer.

Frutat ofrojnë shumë vlera shëndetësore dhe jo vetëm për diabetikët. Ato janë shumë të pasura me vitamina, minerale, fibër dhe antioksidantë.

Të dhënat thonë se frutat mund tu bëjnë mirë diabetikëve nëse këta të fundit kujdesen për racionet dhe nuk e teprojnë.

Sic e thamë edhe më lart, frutat përmbajnë fibër, e cila pengon rritjen e nivelit të sheqerit që ndodh rëndom pas ushqyerjes. Ajo rrit ndjesinë e ngopjes dhe pengon ushqyerjen e tepërt.

Për më tepër, frutat janë një burim i shkëlqyer vitaminash dhe mineralesh siç është kaliumi, i cili ndihmon në uljen e tensionit të gjakut.

KARBOHIDRATET PËR DIABETIKËT

Një aspekt negativ i frutave është se ato konsiderohen si karbohidrat dhe përmbajnë sheqerna natyralë të quajtura fruktozë. Karbohidratet, edhe nëse përthithen nga buka, kosi, patatja apo fruti, shpërbëhen dhe transformohen në glukozë.

Kjo është arsyeja përse diabetikët duhet të jenë të vëmendshëm ndaj sasisë së karbohidrateve që konsumojnë, përfshirë këtu edhe frutat.

Frutat me nivel të ulët glicemie janë të përshtatshme për diabetikët. Niveli i glicemisë në një ushqim të caktuar tregon shpejtësinë e organizmit për të përthithur glukozën nga ky ushqim.

Ky matës nuk ka të bëjë me përmbajtjen specifike të sheqerit në një ushqim por sasinë e glukozës që do të futet në organizëm gjatë ngrënies së një racioni.

Glukoza përthithet më shumë dhe më shpejtë nga ushqimet me një nivel të lartë glicemie.

Frutat me nivel të ulët glicemie janë: mollët, dardhat, boronicat, luleshtrydhet, kivi, qitro, nektarinat dhe portokalli. Frutat me nivel mesatar glicemie janë qershitë, mango dhe rrushi. Frutat me nivel të lartë glicemie janë shalqini dhe ananasi.



KOMBINONI FRUTAT ME PROTEINË

Ekspertët thonë se kombinimi i frutave me një proteinë ngadalëson rritjen e nivelit të sheqerit në gjak. Për shembull, ju mund të hani një filxhan mjedër me një filxhan të vogël çaji me kos.

Një dardhë të vogël mund ta kombinoni ose me djathë ose me gjizë. Shmangni Frutat e Thata dhe Lëngjet e Frutave. Frutat e thata përmbajnë shumë karbohidrate dhe janë të dëmshme. Për shembull, dy lugë gjelle me rrush të thatë ofrojnë 23 gramë karbohidrate dhe 18 gramë sheqer.

Diabetikët duhet të shmangin gjithashtu edhe lëngjet e frutave të cilat rrisin sheqerin në gjak menjëherë për shkak të mungesës së fibrës.



BAKTERET QË “USHQEHEN” ME METAN, KARBURANTI I SË ARDHMES

Bakteret që “ushqehen” me metan premtojnë të jenë çelësi i karburanteve të së ardhmes, sipas një grup studiuesish të Universitetit të Northwesternit, që ka identifikuar pikën e saktë ku enzima përgjegjëse për konvertimin e metanit në etanol hyn në veprim.

Është një pikë ku ka vetëm një jon të bakrit.

Zbulimi, i botuar në revistën “Science”, mund të çojë në projektimin e katalizatorëve të rinj, të aftë për konvertimin e metanit (një gaz i fuqishëm serrë) në metanol (që përdoret në lëndë djegëse), që mund të ripërdoren shpejt duke përdorur të njëjtin

mekanizëm si bakteret.

“Identiteti dhe struktura e joneve metalike përgjegjës për katalizimet kanë mbetur të pakapshme prej vitesh, por ne kemi bërë një hap të rëndësishëm përpara për të kuptuar se si funksionojnë këto baktere”, vuri në dukje Amy Rosenzweig, bashkautore e studimit.

Proceset industriale aktuale për të shkaktuar një reaksion methane-metanol kërkojnë presione shumë të larta dhe temperatura ekstreme, të cilat mund të kalojnë 1 300 gradë Celsius.

TELETRANSPORTIMI I MUNDËSON ATOMEVE TË KOMUNIKOJNË NË DISTANCË

Realizohet në laborator teletransportimi i informacioneve mes dy atomeve në distancë me njëri tjetrin dhe ky rezultat mundëson që të bëjë edhe më të shpejtë kompjuterët kuantik në të ardhmen, sipas studimit të publikuar në revistën “Science” nga fizikanët e “National Institute of Standards and Technology” (NIST), agjencia e qeverisë amerikane që merret me teknologjinë.

Studiuesit e NIST, të koordinuar nga Dietrich Leibfried, kanë arritur të transferojnë informacione mes joneve të beriliumit duke i mbajtur të ndarë në një distancë minimale prej 340 të mijtat e milimetrit.

“Transferimi i informacionit shfrytëzon një karak-

teristikë të veçantë në mekanikën kuantike. Aftësinë e grimcave që të qëndrojnë të lidhura në distancë, e ashtuquajtura korkolepsja kuantike”, shpjegon Leibfried.

Kompjuterët kuantikë bazohen në ligjet e çuditshme të botës së grimcave për të përpunuar shpjete përlllogaritje që kompjuterëve aktualë do u duhej një kohë e barabartë me moshën e universit.

Këta kompjuterë do i bëjnë shumë më të shpejtë mekanizmat e të mësuarit të sistemeve të inteligjencës artificiale dhe do të mundësojnë të përpunohen ilaçe të reja në pak orë.



PAJISJE PËR TË ZBULUAR BRENDË PAK MINUTASH BAKTERET NË ORGANIZËM

Epoka e mjekëve që përshkruajnë antibiotikë të fuqishëm në pritje të rezultateve nga laboratoritë shpejti do të marrë fund, kjo vetëm në sajë të një pajisje të re që mundëson marrjen e rezultateve brenda pak minutash.

Kjo pajisje u shpik nga një ekip i “Pennsylvania State University”. Mjeti u përshkrua të hënën në revistën shkencore “Proceedings of the National Academy of Sciences”.

Në bashkëpunim me Pak Kin Wong, pedagog i

inxhinierisë biomjekësore dhe mekanike, ky mjet përdor një mikro-teknologji për të kapur qelizat bakteriale, të cilat mund të vëzhgohen më pas në sajë të një mikroskopi elektronik.

Kjo teknikë bën të mundur përcaktimin në vetëm 30 minuta nëse një bakter është i pranishëm në mostrën e studiuar, si dhe ndjeshmërinë e tij ndaj trajtimeve mjekësore. Nëse është rezistent ndaj disa medikamenteve, atëherë antibiotikët nuk do të kenë aspak ndikim.


SHKENCËTARËT KAPIN NJË SERI VALËSH GRAVITACIONALE

Receptorët “Ligo” dhe “Virgo” të ndezur më 1 prill deri tani kanë regjistruar pesë lloje valësh gravitacionale, tre prej të cilave janë gjeneruar nga përplasja e vrimave të zeza, një e katërt u kap më 25 prill dhe mund të jetë krijuar nga përplasja mes dy yjesh prej neutrones, ndërsa e pesta u regjistrua më 26 prill dhe mund të jetë krijuar nga përplasja mes një vrimë të zezë dhe një ylli prej neutroni.

“Universi po na mban mbi gjemba”, tha zëdhënësi

i këtij projekti, Patrick Brady në lidhje me ngjarjen e 26 prillit.

“Me shumë mundësi kjo është gjëja më e vështirë që na pret”, tha koordinatori i analizimit të dhënave, Giovanni Prodi i Universitetit të Trentos, duke iu referuar analizimit të valëve gravitacionale të krijuara nga përplasja mes një vrimë të zezë dhe një ylli prej neutrones që është një fenomen shumë i rrallë.





Ju ofron:
Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!



Lagja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër

+355 67 47 39389

1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive

4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar

5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR

(djem dhe vajza)

NGA KLASA E **1**-RË
DERI NË KLASËN E **5**-TË

“...Ata
ishin djelmosha
që besonin
në Zotin e tyre
dhe Ne i forcua në
rrugën e drejtë.”

(Kehf, 13)